Direktiva 2008/98/KE (Tabelë përputhshmërie)

Direktiva 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”, e cila shfuqizon disa direktiva		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) "Projekt – ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Projektligji) *Përputhshmëri e pjesshme*				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 1 ***Objekti dhe fusha e veprimit***	Kjo Direktivë përcakton masa për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut duke parandaluar ose reduktuar krijimin e mbetjeve, ndikimet negative të krijimit dhe menaxhimit të mbetjeve dhe duke reduktuar ndikimet e përgjithshme të përdorimit të burimeve dhe përmirësuar efikasitetin e këtij përdorimi, që janë thelbësore për kalimin në një ekonomi qarkulluese dhe për garantimin e konkurrueshmërisë afatgjatë të Bashkimit.	*Projektligji*	*1,2*	**Neni 1** **Qëllimi** Ky ligj ka si qëllim të krijojë një sistem të menaxhimit të integruar të mbetjeve, për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut, si dhe të sigurojë përdorimin e burimeve me efikasitet,duke krijuar kushtet e domosdoshme për kalimin në modelin e ekonomisë qarkulluese. **Neni 2** **Objekti dhe fusha e veprimit** Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe zbatimi i hierarkisë së mbetjeve të masave për arritjen e objektivave të mëposhtme: a) parandalimin ose pakësimin e mbetjeve; b) parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i mbetjeve;	E plotë	Nenet 1 dhe 2 të projekt-ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të lexuara sëbashku janë në përputhje të plotë me nenin 1 të ‘Direktivës 2008/98/KE për mbetjet.

				c) zvogëlimin e ndikimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimin e efiçencës së përdorimit të tyre. Dispozitat e këtij ligji mbulojnë të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe zbatohen nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që kanë të drejta dhe detyrime në përputhje me parashikimet e këtij ligji		
Neni 2 ***Përjashtimet nga fusha e veprimit*** *(1)*	1. Përjashtohen nga objekti i kësaj Direktive fushat e mëposhtme:	*Projektligji*	*3 (1)*	*Neni 3* **Përjashtime nga fusha e veprimit** 1. Përjashtohen nga objekti i këtij ligji fushat e mëposhtme, të cilat rregullohen me legjislacion të posaçëm:	E plotë	Ashtu si direktiva e mbetjeve, edhe projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve përjashton nga fusha e zbatimit të gjitha elementet e mbuluara nga neni 2 (1) i Direktivës. Ndryshe nga direktiva në projekt ligj përjashtohn edhe anijet e dala jashtë përdorimit (neni 3 (1) (e) sepse rregullohen gjithashtu nga një ligj i posaçëm. Ky ndryshim i projekt-ligjit nuk ndikon në nivelin e përputhshmërisë së kësaj dispozite, që mbetet e plotë.
2 (1) (a)	a) shkarkimet e gazta në atmosferë;	*Projektligji*	*3 (1) (a)*	shkarkimet e gazta në atmosferë;	E plotë	Neni 3 (1) (a) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (1) (a) të Direktivës 2008/98/KE
2 (1) (b)	b) tokat in situ (në pozicionin origjinal dhe të paprekura), që përfshijnë dherat e ndotura të pagërmuara dhe ndërtesat që janë të lidhura në mënyrë të përhershme me tokën;	*Projektligji*	*3 (1) (b)*	tokat in situ (në pozicionin origjinal dhe të paprekura), që përfshijnë dherat e ndotura të pagërmuara dhe ndërtesat që janë të lidhura në mënyrë të përhershme me tokën;	E plotë	Neni 3 (1) (b) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (1) (b) të Direktivës 2008/98/KE
2 (1) (c)	c) dherat që nuk janë të ndotura dhe materialet e tjera natyrore, të gërmuara si pasojë e veprimtarive të ndërtimit, në rastet kur është e sigurtë që materiali do të përdoret për qëllime ndërtimi në gjendjen e tij natyrore në territorin nga ku është gërmuar;	*Projektligji*	*3 (1) (c)*	dherat që nuk janë të ndotura dhe materialet e tjera natyrore, të gërmuara si pasojë e veprimtarive të ndërtimit, në rastet kur është e sigurt që materiali do të përdoret për qëllime ndërtimi në gjendjen e tij natyrore në territorin nga ku është gërmuar;	E plotë	Neni 3 (1) (c) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (1) (c) të Direktivës 2008/98/KE
2 (1) (d)	d) mbetjet radioaktive;	*Projektligji*	*3 (1) (ç)*	mbetjet radioaktive;	E plotë	Neni 3 (1) (ç) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (1) (d) të Direktivës 2008/98/KE

2 (1) (e)	e) lëndët plasëse të çaktivizuara ;	*Projektligji*	*3 (1) (d)*	lëndët plasëse të çaktivizuara	E plotë	Neni 3 (1) (d) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (1) (e) të Direktivës 2008/98/KE
2 (1) (f)	f) lëndët fekale, në rast se nuk përmenden në shkronjën "b" të këtij neni, kashta dhe materiale të tjera natyrore, bujqësore ose pyjore jo të rrezikshme, që përdoren në bujqësi, pylltari ose për prodhimin e energjisë nga biomasa të tilla, përmes procesesh ose metodash që nuk dëmtojnë mjedisin dhe nuk vënë në rrezik shëndetin e njeriut;	*Projektligji*	*3 (1) (dh)*	lëndët fekale, në rast se nuk përmenden në shkronjën "b" të këtij neni, kashta dhe materiale të tjera natyrore, bujqësore ose pyjore jo të rrezikshme, që përdoren në bujqësi, pylltari ose për prodhimin e energjisë nga biomasa të tilla, përmes procesesh ose metodash që nuk dëmtojnë mjedisin dhe nuk vënë në rrezik shëndetin e njeriut;	E plotë	Neni 3 (1) (dh) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (1) (f) të Direktivës 2008/98/KE.
2 (2)	2. Përjashtohen nga objekti i kësaj Direktive fushat e mëposhtme, për pjesët që rregullohen me legjislacion tjetër të Komunitetit:	*Projektligji*	*3 (2)*	2. Përjashtohen nga objekti i këtij ligji fushat e mëposhtme, për pjesët që rregullohen me legjislacion të posaçëm:	E plotë	Ashtu si direkta e mbetjeve, edhe projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve përjashton nga fusha e zbatimit të gjitha elementet e mbuluara nga neni 2 (2) i Direktivës, për pjesën që rregullohen nga ligje të posaçme sektoriale.
2 (2) (a)	a) ujërat e përdorura;	*Projektligji*	*3 (2) (a)*	a) ujërat e përdorura;	E plotë	Neni 3 (2) (a) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (2) (a) të Direktivës 2008/98/KE.
2 (2) (b	b) nënproduktet shtazore përfshirë produktet e përpunuara, përveç atyre që destinohen për incinerim, për në lendfill ose për përdorim në një impiant kompostimi ose biogazi;	*Projektligji*	*3 (2) (b)*	b) nënproduktet shtazore përfshirë produktet e përpunuara, përveç atyre që destinohen për incinerim, për në lendfill ose për përdorim në një impiant kompostimi ose biogazi;	E plotë	Neni 3 (2) (b) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (2) (b) të Direktivës 2008/98/KE.
2 (2) (c)	c) skeletet e kafshëve të ngordhura kur janë therur në thertore apo janë vrarë për të eliminuar sëmundjet epizotike dhe që asgjësohen në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1774/2002;	*Projektligji*	*3 (2) (c)*	c) skeletet e kafshëve të ngordhura, përfshirë rastet kur janë therur në thertore apo janë vrarë për të eliminuar sëmundjet epizotike;	E plotë	Neni 3 (2) (c) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (2) (c) të Direktivës 2008/98/KE.
2 (2) (d)	d) mbetjet që dalin nga kërkim-zbulimi, nxjerrjet, trajtimi dhe ruajtja e burimeve minerare dhe nga punimet në gurore që mbulohen nga Direktiva 2006/21/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Marsit 2006 për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse[1];	*Projektligji*	*3 (1) (ë)*	ë) mbetjet që dalin nga kërkim-zbulimi, shfrytëzimi, përpunimi dhe depozitimi i burimeve minerare dhe nga punimet në gurore;	E plotë	Neni 3 (1) (ë) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (2) (d) të Direktivës 2008/98/KE.

[1] OJ L 102, 11.4.2006, p. 15.

2 (2) (e)	e) Substancat të cilat janë të paracaktuara të përdoren si materiale ushqyese për kafshët sipas përcaktimit në pikën (g) të Nenit 3(2) të Rregullores (KE) Nr. 767/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[2] dhe që nuk konsistojnë në ose nuk përmbajnë nën-produkte shtazore.	*Projektligji*	*3 (2) (d)*	ç) substancat të cilat janë të paracaktuara të përdoren si materiale ushqyese për kafshët dhe që nuk përmbajnë ose nuk rrjedhin nga nën-produktet shtazore	E plotë	Neni 3 (2) (d) i projektligjit është në përputhje të plotë me nenin 2 (2) (e) të Direktivës 2008/98/KE. .
2 (3)	3. Pa cënuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacione të tjera të Komunitetit, sedimentet që rikthehen në ujërat sipërfaqësore për qëllime të menaxhimit të ujërave dhe rrugë kalimeve ujore, ose për parandalimin ose zbutjen e efekteve të përmbytjeve dhe thatësirave ose për bonifikimin e tokave, përjashtohen nga objekti i kësaj Direktive kur provohet që këto sedimente janë jo të rrezikshme.	*Projektligji*	*3 (3)*	3. Pa cënuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i posaçëm, sedimentet që rikthehen në ujërat sipërfaqësore për qëllime të menaxhimit të ujërave dhe rrugë kalimeve ujore, ose për parandalimin ose zbutjen e efekteve të përmbytjeve dhe thatësirave ose për bonifikimin e tokave, përjashtohen nga objekti i këtij ligji kur provohet që këto sedimente janë jo të rrezikshme..	E plotë	Neni 3 (3) është në përputhje të plotë me nenin 2 (3) të Direktivës 2008/98/KE për mbetjet.
2 (4)	4. Rregulla specifike për raste të veçanta, ose që plotësojnë ato të kësaj Direktive, mbi menaxhimin e kategorive të veçanta të mbetjeve, mund të përcaktohen përmes Direktivave individuale.	*Projektligji*	-	-	E plotë	Neni 2 (4) i Direktivës 2008/98/KE për mbetjet ka të bëjë me legjislacionin e BE-së, nuk është i zbatueshëm për shqipërinë. Megjithatë, edhe projek-ligji shqiptar ndjek modelin e legjislacionit të BE-së dhe lejon që aspekte specifike mbi menaxhimin e mbetjeve mund të rregullohen me legjislacion të posaçëm.
Neni 3 ***Përkufizime***	Për qëllimet e kësaj Direktive, do të përdoren këto përkufizime:	*Projektligji*	*4*	**Neni 4** **Përkufizime** Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:	E pjesshme	Gati të gjitha përkufizimet e Direktivës 2008/98/KE janë pasqyruar në legjislacionin shqiptar duke përdorur të njëjtat terma dhe koncepte si direktiva. Analiza e hollësishme jepet më poshtë.
3 (1)	1. 'mbetje' është çdo substancë ose objekt që mbajtësi hedh ose ka për qëllim ose është i detyruar ta hedhë;	*Projektligji*	*4 (17)*	17. "Mbetje" është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (17) të projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve është në përputhje me Nenin 3 (1) të Direktivës 2008/98/KE.

2 Rregullore (KE) Nr. 767/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 13 korrik 2009 mbi vënien në treg dhe përdorimin e ushqimeve për kafshët, duke ndryshuar Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (KE) Nr. 1831/2003 dhe duke abroguar Direktivën e Këshillit 79/373/KEE, Direktivën e Komisionit 80/511/KEE, Direktivat e Këshillit 82/471/KEE, 83/228/KEE, 93/74/KEE, 93/113/KE dhe 96/25/KE dhe Vendimin e Komisionit 2004/217/EC (OJ L 229, 1.9.2009, f. 1).

3 (2)	2. 'mbetje e rrezikshme' është mbetja që shfaq një ose më shumë nga karakteristikat e rrezikshme të listuara në Shtojcën III;	*Projektligji*	*4 (25)*	25. "Mbetje të rrezikshme" janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij ligji.	E pjesshme	Përkufizimi i nenit 4 (25) të projektligjit është përafruar me nenin 3 (2) të Direktivës 2008/98/KE për mbetjet por për shkak se Shtojca 3 e projektligjit nuk është plotësisht e përafruar me Aneksin 3 të direktivës, përafrimi është i pjesshëm.
3 (2a.)	2a. 'mbetje jo e rrezikshme' është cdo mbetje që nuk mbulohet nga pika 2;	*Projektligji*	*4 (27)*	27. "Mbetje jo të rrezikshme" janë mbetjet të cilat nuk shfaqin vetitë e mbetjeve të parashikuara në pikën 25 të këtij neni.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (27) të projektligjit është përafruar plotësisht me nenin 3 (2a.) të Direktivës 2008/98/KE për mbetjet
3 (2b.)	2b. 'mbetje bashkiake' janë: (a) mbetje shtëpiake të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet e baterive dhe akumulatorëve, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë dyshekët dhe mobiljet; (b) mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake; Mbetjet bashkiake nuk përfshijnë mbetjet nga prodhimi, bujqësia, pyjet, peshkimi, gropat septike, rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, sistemin e kullimit, si dhe llumërat e ujërave të ndotura, automjetet në fund të jetës, mbetje nga ndërtimi dhe shembja. Ky përkufizim nuk cënon ndarjen e përgjegjësisë së menaxhimit të mbetjeve midis aktorëve publikë dhe privatë.	*Projektligji*	*4 (18)*	18. "Mbetje bashkiake" janë: (a) Mbetje shtëpiake të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet elektrike dhe elektronike, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të tyre individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit që janë pjesë përbërëse e këtyre pajisjeve, mbetjet e baterive, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë mobiljet, dyshekët dhe të ngjashme (b) Mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake (c) Mbetjet bashkiake nuk përfshijnë mbetjet nga prodhimi, bujqësia, pyjet, peshkimi, gropat septike, rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, sistemin e kullimit, si dhe llumrat e ujërave të ndotura, automjetet në fund të jetës, mbetje nga ndërtimi.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (18) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 pika 2b. të Direktivës 2008/98/KE për mbetjet dhe me Direktivën 2012/19/EU mbi mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike në lidhje me termin pajisjet elektrike dhe elektronike.Për t'u theksuar se paragrafi i fundit i nenit 2b. të Direktivës 2008/98/KE nuk është përfshirë tek përkufizimi nga projekt ligji. Megjithatë edhe projekt ligji nuk ndalon që menaxhimi i mbetjeve bashkiake të mund të kryhet nga subjekte private.
3 (2c.)	2c. 'mbetje nga ndërtimi dhe shembja' janë mbetje të krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe shembjes;	*Projektligji*	*4 (23)*	23. "Mbetje nga ndërtimi" janë mbetjet e krijuara nga veprimtaria e ndërtimit apo e shembjes.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (23) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 pika 2c. të Direktivës 2008/98/KE. Pavarësisht

						se nga titulli i përkufizimit të projektligjit është hequr termi 'shembja', përmbajtja është e njëjtë sepse nën këtë përkufizim përfshihen edhe mbetjet nga shembjet. Si rrjedhojë ky ndryshim nuk përbën problem.
3 (3)	3. 'vajrat e përdorura' janë vajrat mineralë ose sintetikë për lubrifikim ose industrialë që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin për të cilin ishin parashikuar fillimisht, siç janë vajrat e përdorura të motorëve dhe të kutive të ingranazheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat dhe vajrat hidraulike;	*Projektligji*	*4 (64)*	64. "Vajra të përdorura" janë të gjitha vajrat lubrifikuese ose industriale, minerale apo sintetike, që nuk janë më të përshtatshme për përdorimin për të cilin ishin paracaktuar, të tilla si vajrat e përdorura të motorëve me djegie të brendshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (64) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (3) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (4)	4. 'mbetje bio' janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, zyrat, restorantet, kateringu, kantinat dhe ambientet e shitjes me pakicë dhe shumicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.	*Projektligji*	*4 (19)*	19. "Mbetje bio" janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, zyrat, restorantet, kateringu, kantinat dhe ambientet e shitjes me pakicë dhe shumicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (19) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (4) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (4a.)	4a. 'mbetje ushqimore' është çdo ushqim sipas përcaktimit në Nenin 2 të Rregullores (KE) Nr. 178/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[3], që është kthyer në mbetje;	*Projektligji*	*4 (21)*	21. "Mbetje ushqimore" është çdo ushqim që është kthyer në mbetje.	E pjesshme	Përkufizimi i nenit 4 (21) të projektligjit është pjesërisht i përafruar me nenin 3 (4a.) të Direktivës 2008/98/KE, sepse përkufizimi i termit ushqim që përcaktohet nga Ligji Nr.9863, datë 28.1.2008 'Për ushqimin", është pjesërisht në përputhje me përkufizimin e termit ushqim të parashikuar në nenin 2 të Rregullores (KE) Nr. 178/2002. Konkretisht përputhshmëria konsiderohet e pjesshme sepse: 1. Ligji për

[3] Rregullore (KE) Nr. 178/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 28 janar 2002, e cila përcakton parimet dhe kërkesat e përgjithshme të ligjit të ushqimit, krijon Autoritetin Evropian të Sigurisë Ushqimore dhe përcakton procedurat në çështjet e sigurisë ushqimore (OJ L 31, 1.2.2002, f. 1).

						ushqimin' ka shtuar termin 'aditivët ushqimor' që nuk përfshihen në përkufizimin e rregullores; 2. Tek përkufizimi i ligjit për ushqimin mungon përjashtimi i 'pajisjeve mjekësore'. Përafrimi i plotë mund të arrihet vetëm duke ndryshuar përkufizimin e termit 'ushqim' tek ligji i posaçëm.
3 (5)	5. 'krijues mbetjesh' është çdo person, veprimtaria e të cilit krijon mbetje (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.	*Projektligji*	*4 (12)*	12. "Krijues i mbetjeve" është çdo person, veprimtaria e të cilit krijon mbetje ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (12) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (5) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (6)	6. 'zotëruesi i mbetjeve' është krijuesi i mbetjeve ose personi fizik ose juridik që ka në posedim mbetjet;	*Projektligji*	*4 (66)*	66. "Zotërues i mbetjeve" është krijuesi i mbetjeve ose çdo person që ka posedimin e mbetjeve.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (66) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (6) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (7)	7. 'Tregtar' është çdo person që vepron si palë kryesore në blerjen dhe më pas në shitjen e mbetjeve, përfshirë çdo person që nuk i merr fizikisht mbetjet në posedim.	*Projektligji*	*4 (63)*	63. "Tregtar" në kuptim të këtij ligji, është çdo person që vepron si palë kryesore në blerjen dhe më pas në shitjen e mbetjeve, përfshirë çdo person që nuk i merr fizikisht mbetjet në posedim.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (63) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (7) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (8)	8. 'Agjent' në kuptim të këtij ligji, është çdo person që mundëson rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve në emër dhe për llogari të të tretëve, duke përfshirë edhe agjentët të cilët nuk posedojnë mbetje.	*Projektligji*	*4 (2)*	2. "Agjent" në kuptim të këtij ligji, është çdo person që realizon rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve në emër dhe për llogari të të tretëve. Ky term përfshin edhe agjentët të cilët nuk posedojnë mbetje.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (2) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (8) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (9)	9. 'menaxhimi i mbetjeve' është grumbullimi, transporti, rikuperimi (përfshirë ndarjen), dhe asgjësimi i mbetjeve, duke përfshirë mbikëqyrjen e këtyre operacioneve dhe kujdesin pas asgjësimit, dhe duke përfshirë veprimet e kryera si një tregtar ose agjent.	*Projektligji*	*4 (37)*	37. "Menaxhim i integruar i mbetjeve" është grumbullimi, transporti, rikuperimi, përfshirë ndarjen, dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (37) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (9) të Direktivës 2008/98/KE. Shtesa e termit 'i integruar' në dispozitën shqiptare nuk sjell asnjë ndryshim thelbësor kundrejt dispozitës së direktivës.

3 (10)	10. 'grumbullimi' është mbledhja e mbetjeve, duke përfshirë ndarjen paraprake dhe ruajtjen paraprake të mbetjeve për qëllime transporti në një impiant trajtimi të mbetjeve;	*Projektligji*	*4 (10)*	10. "Grumbullim" është mbledhja, përfshirë ndarja paraprake dhe ruajtja paraprake e mbetjeve me qëllim transportimin e tyre në impiantet e trajtimit të mbetjeve.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (10) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (10) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (11)	11. 'grumbullimi i diferencuar' është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh mblidhet dhe mbahet e ndarë sipas llojit dhe natyrës, për të bërë të mundur një trajtim specifik.	*Projektligji*	*4 (11)*	11. "Grumbullim i diferencuar" është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh mblidhet dhe mbahet e ndarë, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (11) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (11) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (12)	12. 'parandalimi' janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet: a) sasia e mbetjeve, përfshirë nëpërmjet ripërdorimit të produkteve ose zgjatjes së jetës së tyre; b) ndikimi negativ i krijimit të mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut; (c) përmbajtja e substancave të rrezikshme në materiale dhe produkte;	*Projektligji*	*4 (43)*	43. "Parandalim" janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet a) Sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre; b) Ndikimi negativ i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut c) Përmbajtja e substancave të rrezikshme në materiale dhe produkte	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (43) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (12) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (13)	13. 'ripërdorim' është çdo operacion, me anë të së cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.	*Projektligji*	*4 (55)*	55. "Ripërdorim" është çdo operacion, me anë të së cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (55) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (13) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (14)	14. 'trajtim' janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.	*Projektligji*	*4 (61)*	61. "Trajtim" janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (61) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (14) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (15)	15. 'rikuperim' është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoreshin në të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar ose që mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë në veprimtarinë ekonomike. Shtojca 2 jep një listë joshteruese të operacioneve të rikuperimit.	*Projektligji*	*4 (50)*	50. "Rikuperim" është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që: a) Mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (50) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (15) të Direktivës 2008/98/KE.

				b) Mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë në veprimtarinë ekonomike. Operacionet e rikuperimit, përfshihen, por pa u kufizuar në, në Shtojcën 2 që i bashkëlidhet ligjit dhe është pjesë përbërëse e tij.		
3 (15a.)	15a. 'rikuperimi i materialeve' është çdo operacion rikuperimi, me përjashtim të operacioneve për rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin e mbetjeve duke i kthyer në materiale që do të përdoren si lëndë djegëse apo mjete të tjera për prodhimin e energjisë. Këtu përfshihen, ndër të tjera, përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe rimbushje.	*Projektligji*	*4 (51)*	51. "Rikuperim i materialeve" është çdo operacion rikuperimi, me përjashtim të operacioneve për rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin e mbetjeve duke i kthyer në materiale që do të përdoren si lëndë djegëse apo mjete të tjera për prodhimin e energjisë. Këtu përfshihen, ndër të tjera, përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe rimbushje	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (51) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (15a.) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (16)	16. 'përgatitja për ripërdorim' janë operacionet e rikuperimit dhe përkatësisht kontrolli, pastrimi ose riparimi, me anë të së cilave produktet ose përbërësit e produkteve, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t'u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak.	*Projektligji*	*4 (42)*	42. "Përgatitje për ripërdorim" janë operacionet e rikuperimit dhe përkatësisht kontrolli, pastrimi ose riparimi, me anë të së cilave produktet ose përbërësit e produkteve, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t'u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (42) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (16) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (17)	17. 'riciklim' është çdo operacion rikuperimi, me anë të së cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t'i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë rimbushëse.	*Projektligji*	*4 (52)*	52. "Riciklim" është çdo operacion rikuperimi, me anë të së cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t'i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë rimbushëse	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (52) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (17) të Direktivës 2008/98/KE.

3 (17a.)	17a. 'Rimbushje' është çdo operacion rikuperimi ku mbetje të përshtatshme jo të rrezikshme përdoren për qëllime bonifikimi në zonat e gërmuara ose për qëllime të ndërhyrjeve inxhinierike në peisazh. Mbetjet e përdorura për rimbushje duhet të zëvëndësojnë materialet që nuk janë mbetje, të jenë të përshtatshme për qëllimet e sipërpërmendura dhe të kufizohen me sasinë e nevojshme për të arritur qëllimet e mësipërme.	*Projektligji*	*4 (53)*	53. "Rimbushje" është çdo operacion rikuperimi ku mbetje të përshtatshme jo të rrezikshme përdoren për qëllime bonifikimi në zonat e gërmuara ose për qëllime të ndërhyrjeve inxhinierike në peizazh. Mbetjet e përdorura për rimbushje të zëvendësojnë materialet që nuk janë mbetje, të jenë të përshtatshme për qëllimet e sipërpërmendura dhe të kufizohen me sasinë e nevojshme për të arritur qëllimet e mësipërme.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (53) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (17a.) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (18)	18. 'Rigjenerim i vajrave të përdorura' është çdo operacion riciklimi, me anë të së cilit vajrat bazë mund të prodhohen nga rafinimi i vajrave të përdorura, në mënyrë të veçantë duke hequr ndotësit, produktet oksiduese dhe shtuesit e tjerë, që gjenden në këto vajra.	*Projektligji*	*4 (54)*	54. "Rigjenerim i vajrave të përdorura" është çdo operacion riciklimi, me anë të së cilit vajrat bazë mund të prodhohen nga rafinimi i vajrave të përdorura, në mënyrë të veçantë duke hequr ndotësit, produktet oksiduese dhe shtuesit e tjerë, që gjenden në këto vajra.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (54) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (18) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (19)	19. 'asgjësim' është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore përftimin e substancave ose të energjisë. Shtojca 1 përmban listën jo shteruese të operacioneve të asgjësimit.	*Projektligji*	*4 (4)*	4. "Asgjësim" është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë të tërthortë përftimin e substancave ose të energjisë. Shtojca 1 e këtij ligji përmban listën jo shteruese të operacioneve që konsiderohen operacione asgjësimi.	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (4) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (19) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (20)	20. 'teknikat më të mira të disponueshme' janë teknikat më të mira të disponueshme siç janë të përcaktuara në Nenin 2(11) të Direktivës 96/61/KE;	*Projektligji*	*4 (60)*	*1.1. Projektligji* 60. "Teknika më të mira të disponueshme" ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (60) të projektligjit është i përafruar plotësisht me nenin 3 (20) të Direktivës 2008/98/KE, sepse përkufizimi TMD tek ligji për lejet e mjedisit – të cilit i referohet projektligji - është në përputhje të plotë me nenin 2(11) të Direktivës 96/61/KE' dhe si rrjedhoje është i përafruar plotësisht edhe me nenin 3 (20) të Direktivës 2008/98/KE.
3 (21)	21. 'skema e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit' është tërësia e masave të ndërmarra nga Shtetet Anëtare për të siguruar që prodhuesit e produkteve	*Projektligji*	*4 (58)*	58. "Skema e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit" është tërësia e masave të cilat sigurojnë	E plotë	Përkufizimi i nenit 4 (58) të projektligjit është i përafruar

	mbartin përgjegjësinë financiare ose përgjegjësinë financiare dhe organizative për menaxhimin e fazës së mbetjes të ciklit të jetës së produktit.			që subjektet prodhuese mbartin përgjegjësinë financiare ose përgjegjësinë financiare dhe organizative për menaxhimin e asaj faze të ciklit të jetës së produktit që quhet mbetje.		plotësisht me nenin 3 (21) të Direktivës 2008/98/KE.
Neni 4 ***Hierarkia e mbetjeve*** *(1)*	1. Hierarkia e mëposhtme e mbetjeve do të aplikohet si një rend prioriteti në legjislacionin dhe politikën për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve: (a) parandalimi; (b) përgatitja për ripërdorim; (c) riciklimi; (d) rikuperim tjetër, p.sh. rikuperimi i energjisë; dhe (e) asgjësimi.	*Projektligji*	*6 (1), 11*	**Neni 6** **Hierarkia e mbetjeve** 1. Legjislacioni, politikat, strategjitë, planet, programet dhe masat e ndërmarra për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë si edhe lejet dhe licencat përkatëse dhe aktivitetet e përditshme të menaxhimit të mbetjeve, zbatojnë hierarkinë e mbetjeve sipas renditjes së mëposhtme: a) parandalimin e mbetjeve; b) përgatitjen e mbetjeve për ripërdorim; c) riciklimin e mbetjeve; ç) rikuperime të tjera të mbetjeve, d) asgjësimin e mbetjeve. **Neni 11** **Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve** Masat për nxitjen e përgatitjes për ripërdorim të mbetjeve përcaktohen strategjinë kombëtare, planin sektorial, zonal ose vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve, sipas parashikimeve të kreut V të këtij ligji dhe përfshijnë: a) masa për ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve të ripërdorimit dhe të riparimit; b) masa që u lehtësojnë rrjeteve të ripërdorimit dhe të riparimit akses tek mbetjet që përgatiten për ripërdorim, të grumbulluara nga	E pjesshme	Neni 6 (1) i projekt ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikon të njëjtën hierarki të menaxhimit të mbetjeve si neni 4 (1) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Megjithatë dispozitat e tjera të projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, nuk fuqizojnë aktivitetet që janë në krye të piramidës së hierarkisë së mbetjeve. Kështu dispozitat e porjektligjit në lidhje me parandalimin e mbetjeve nuk përmbajnë masat kryesore të parandalimit të mbetjeve (*shiko analizën e nenit 9 të Direktivës më poshtë*). Gjithashtu neni 11 i projekt ligjit e ndryshon politikën e grumbullimit të diferencuar, duke hequr nga ligji detyrimin ekzsitues të grumbullimit të diferencuar për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin dhe duke e shtyrë atë për një afat të pa përcaktuar që do të miratohet me VKM. Ky ndryshim mund ta vonojë akoma më shumë nisjen e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në territorin e shqipërisë dhe dobëson proceset e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve që zënë vendin 2, 3 dhe 4 në hierarkinë e mbetjeve. Prandaj, dispozitat e projekt ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve sëbashku me praktikën e menaxhimit të mbetjeve në shqipëri që përqëndrohet kryesisht tek lendfilli

				persona fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e grumbullimit të mbetjeve; c) masa që promovojnë përdorimin e instrumenteve ekonomikë; ç) kritere specifike në procedurat e prokurimit publik; d) përmbushja e objektivave sasiorë; dh) masa që inkurajojnë zbatimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit; e) masa të tjera të përshtatshme për realizimin e këtij qëllimi; Për të nxitur riciklimin me cilësi të lartë mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore miraton kriteret, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve.		dhe incinerimi i mbetjeve, pra asgjësimi i mbetjeve, nuk është aktualisht në përputhje të plotë me hierarkinë e mbetjeve të parashikuar në nenin 4 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
4 (2)	2. Kur aplikojnë hierarkinë e mbetjeve të përmendur në paragrafin 1, Shtetet Anëtare do të marrin masa për të inkurajuar opsionet që japin rezultatet më të mira mjedisore të përgjithshme. Kjo mund të kërkojë që rryma specifike mbetjesh mos zbatojnë hierarkinë, kur kjo është e justifikuar nga qasja për ciklin e jetës për ndikimet e përgjithshme të krijimit dhe menaxhimit të këtyre mbetjeve.	*Projektligji*	*6 (2), (3)*	2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton rregullat për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve që japin rezultatet më të mira për mjedisin. Në këto rregulla parashikohen edhe përjashtimet që lejojnë që për rryma të veçanta mbetjesh të mos zbatohet hierarkia e mbetjeve. Përjashtimi lejohet vetëm në rast se justifikohet nga analiza e ciklit të plotë jetës së mbetjeve dhe e impaktit të përgjithshëm që kanë mbetjet që nga krijimi dhe deri në menaxhimin të tyre. 3. Për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë	E pjesshme	Parimet që përmban neni 4 (2) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve janë përfshirë edhe në dispozitën e projekt ligjit, megjithatë zbatimi i tyre mund të vlerësohet vetëm pas miratimit të akteve nën ligjore konkrete. Në këtë vlerësim do të ndikojnë edhe çështjet e ngritura më sipër në lidhje me hierarkinë e mbetjeve.

				dhe juridikë që angazhohen në menaxhimin e integruar të mbetjeve përdorin instrumentet ekonomikë dhe masat e tjera nxitëse të Shtojcës 6 të këtij ligji.		
4 (2) Paragrafi 2	Shtetet Anëtare do të sigurojnë që zhvillimi i legjislacionit dhe politikës për mbetjet të jetë një proces plotësisht transparent, duke respektuar rregullat ekzistuese kombëtare për konsultimin dhe përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara.	*Legjislacion sektorial*	-	-	E plotë	Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve nuk e parashikon këtë dispozitë, sepse dispozita është plotësisht e përfaruar nga dy ligje ekzsituese: Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar dhe Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".
4 (2) Paragrafi 3	Shtetet Anëtare do të mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të mbrojtjes mjedisore të kujdesit dhe qëndrueshmërisë, fizibilitetin teknik dhe leverdinë ekonomike, mbrojtjen e burimeve si dhe ndikimet e përgjithshme në mjedis, në shëndetin e njeriut, ndikimet ekonomike dhe sociale, në përputhje me Nenet 1 dhe 13. .	*Projektligji*	*1, 2, 5*	**Neni 1** **Qëllimi** Ky ligj ka si qëllim të krijojë një sistem të menaxhimit të integruar të mbetjeve, për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut, si dhe të sigurojë përdorimin e burimeve me efikasitet,duke krijuar kushtet e domosdoshme për kalimin në modelin e ekonomisë qarkulluese. **Neni 2** **Objekti dhe fusha e veprimit** Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe zbatimi i hierarkisë së mbetjeve të masave për arritjen e objektivave të mëposhtme: a) parandalimin ose pakësimin e mbetjeve;	E plotë	Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, i parandalimit dhe të gjitha parimet e tjera të parashikuara në nenin 4 (2) paragrafi 3 i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, janë të pasqyruara gjerësisht tek projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe tek ligji kuadër për mbrojtjen e mjedisit.

				b) parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i mbetjeve; c) zvogëlimin e ndikimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimin e efiçencës së përdorimit të tyre. Dispozitat e këtij ligji mbulojnë të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe zbatohen nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që kanë të drejta dhe detyrime në përputhje me parashikimet e këtij ligji **Neni 5** **Parime të përgjithshme** Menaxhimi i integruar i mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë është çështje e interesit publik. 2. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet duke respektuar: a) Parimet e mbrojtjes, ruajtjes, dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e mjedisit; b) Parimet e ekonomisë qarkulluese, që i konsideron mbetjet si burim c) Parimet e barazisë dhe mos diskriminimit, përfshirë barazinë gjinore, si dhe ndikimin e përgjithshëm ekonomik dhe social ç) Parimin "ndotësi paguan" sipas parashikimit në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit d) Hierarkinë e mbetjeve		

				3. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet sipas kritereve të efikasitetit, eficencës, leverdisë ekonomike, transparencës dhe fizibilitetit teknik dhe ekonomik, për të garantuar një sistem të qëndrueshëm dhe proporcional. Sistemi i menaxhimit te integruar te mbetjeve mbështetet edhe në bashkëpunimin e subjekteve të përfshira në prodhimin, shpërndarjen, përdorimin, konsumin e produkteve, prej të cilave krijohen mbetje 4. Institucionet dhe subjektet përgjegjëse marrin masat e nevojshme që mbetjet të menaxhohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin, duke garantuar që të mos vihen në rrezik ujërat, ajri, toka, përfshirë tokat bujqësore, bimët ose kafshët dhe të mos shkaktohen shqetësime përmes zhurmës ose erës së pakëndshme, të mos ndikohen negativisht zonat rurale ose zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë.		
4 (3)	3. Shtetet Anëtare do të shfrytëzojnë instrumentet ekonomike dhe masa të tjera për të mundësuar incentiva për aplikimin e hierarkisë së mbetjeve, si ato të listuara në Shtojcën IVa ose instrumente dhe masa të tjera të përshtatshme.	*Projektligji*	*28*	**Neni 28** **Instrumentet ekonomikë dhe masa të tjera nxitëse të hierarkisë së mbetjeve** Politikat dhe kuadri ligjor për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve në nivel qendror dhe vendor përfshin instrumentet ekonomike dhe masat nxitëse të parashikuara në Shtojcën 6 të këtij ligji, si dhe instrumente dhe masa të tjera të konsideruara të nevojshme sipas rastit.	E pjesshme	Direktiva përmban një listë me instrumentat ekonomike dhe masat e tjera nxitëse për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, që duhet të përdoren nga shtetet anëtare. Kjo nuk do të thotë që secili shtet anëtar duhet të përdorë të gjitha instrumentat dhe masat e përshkruara. Mjafton që shtetet anëtare të zbatojnë disa nga masat dhe instrumentat që u mundësojnë atyre zbatimin e hierarkisë së mbetjeve. Në të njëjtën linjë me direktivën edhe projekligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Shtojcën 6 ka përfshirë një sërë instrumentash ekonomikë dhe masash nxitëse që mund të përdoren

						për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve. Instrumentat dhe masat e projektligjit përputhen me disa nga insutrmentat dhe masat e rradhitura në Aneksin IVa., të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Megjithatë përafrimi është i pjesshëm sepse instrumentat dhe masat e përmendura në Shtojcën 6 të projekligjit janë angazhime politike të cilat duhet të zbatohen me akte ligjore dhe nën ligjore konkrete. Vlerësimi i hollësishëm për secilin instrument dhe masë jepet më poshtë tek analiza e Shtojcës 6.
Neni 5 ***Nënprodukte*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masa të përshtatshme për të siguruar që një substancë ose objekt që rezulton nga një proces prodhimi, qëllimi kryesor i të cilit nuk është prodhimi i asaj substance ose objekti, të konsiderohet jo si mbetje, por si një nënprodukt nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: **▼B** (a) përdorimi i mëtejshëm i substancës ose objektit është i sigurtë; (b) substanca ose objekti mund të përdoret drejtpërdrejtë pa iu nënshtruar ndonjë përpunimi të mëtejshëm, përveç atyre të parashikuar nga praktika normale industriale; (c) substanca ose objekti prodhohet si pjesë përbërëse e procesit të prodhimit; (d) përdorimi i mëtejshëm i kësaj substance ose i këtij objekti është i ligjshëm, në kuptimin që substanca ose objekti i përmbush të gjitha standardet e produktit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga përdorimi specifik dhe nuk ka një ndikim të përgjithshëm negativ në mjedis apo në shëndetin e njeriut.	*Projektligji*	*7 (1)*	**Neni 7** **Nënproduktet** Për qëllime të këtij ligji, një substancë ose një objekt, që përftohet gjatë një procesi prodhimi, qëllimi kryesor i të cilit nuk është prodhimi i kësaj substance apo i këtij objekti, konsiderohet se nuk është mbetje por nënprodukt, vetëm në qoftë se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme: a) është e sigurtë që substanca ose objekti do të ketë përdorim të mëtejshëm; b) substanca ose objekti mund të përdoret drejtpërdrejtë pa iu nënshtruar ndonjë përpunimi të mëtejshëm, përveç atyre të parashikuara nga praktika normale industriale; c) substanca ose objekti prodhohet si pjesë përbërëse e procesit të prodhimit; ç) përdorimi i mëtejshëm i kësaj substance ose i këtij objekti është i ligjshëm, në kuptimin që substanca ose objekti i përmbush të gjitha standardet e produktit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit	E plotë	Dispozita 7(1) e projekt ligjit të menaxhimit të mbetjeve është plotësisht në përputhje me dispozitën 5 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Sa për qartësim, kushtet e parashikuara në dispozitën 5 (1) gërmat a – d të direktivës janë kumulative. Kjo rrjedh jo vetëm nga interpretimi logjik i kushteve, që janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën, por gjithashtu shpjegohet nga Udhëzim i Komisionit mbi interpretimin e dispozitave kyçe të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve (“*Guidance on the interpretation of key provisions of Directive 2008/98/EC on ëaste*”) faqe 14-22. Ky udhëzim edhe pse nuk është detyrues, është një instrument i Komisionit që ndihmon në interpretimin e dispozitave të direktivës.

				dhe shëndetit nga përdorimi dhe nuk ka një ndikim të përgjithshëm negativ në mjedis apo në shëndetin e njeriut.		
5 (2)	2. Komisioni mund të miratojë akte zbatimi për të vendosur kritere të detajuara për aplikimin uniform të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 për substanca ose objekte specifike. Këto kritere të detajuara duhet të sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje të mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe të lehtësojnë përdorimin e kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore. Aktet zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 39(2). Kur miraton këto akte zbatimi, Komisioni do të marrë si pikënisje kriteret më shtrënguese dhe mbrojtëse për mjedisin nga çdo kriter që është miratuar nga Shtetet Anëtare në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni dhe do të japë përparësi praktikat e replikueshme të simbiozës industriale në zhvillimin e kritereve të detajuara.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
5 (3)	3. Kur kriteret nuk janë vendosur në nivelin e BE-së sipas paragrafit 2, Shtetet Anëtare mund të vendosin kritere të detajuara për aplikimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 për substanca ose objekte specifike.	*Projektligji*	*7 (2)*	2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kriteret dhe procedurat për klasifikimin si nënprodukte dhe jo si mbetje, në përputhje me kushtet e pikës 1 të këtij neni.	E plotë	Aktualisht nuk gjenden akte zbatuese të Komisionit që përcaktojnë kritere të hollësishme për nën-produktet. Në përputhje me lejimin e nenit 5 (2) (3) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, dispozita e projekt ligjit, parashikon se kriteret dhe procedurat specifike për zbatimin e dispozitës mbi nën produktet do të miratohen me VKM. Në fazën e hartimit të këtyre VKM-ve, duhen mbajtur parasysh të gjitha aktet e BE-së, përfshirë udhëzimet e Komisionit mbi nën produktet.
5 (3) paragrafi 2	Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin për këto kritere të detajuara në përputhje me Direktiven (BE) 2015/1535 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[4], kur e kërkon ajo Direktivë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

[4] Direktiva (BE) 2015/1535 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 9 shtator 2015, e cila përcakton një procedurë për sigurimin e informacionit në fushën e rregulloreve teknike dhe të rregullave për shërbimet e Shoqërisë së Informacionit (OJ L 241, 17.9.2015, f. 1).

Neni 6 ***Fundi i statusit mbetje*** (1)	1. Shtetet Anëtare do të marrin masa të përshtatshme për të siguruar që mbetjet që i janë nënshtruar një operacioni riciklimi ose rikuperimi tjetër, konsiderohen që kanë pushuar së qëni mbetje, nëse ato plotësojnë kushtet e mëposhtme: (a) substanca ose objekti do të përdoret për qëllime specifike; (b) ekziston një treg ose kërkesë për një substancë ose objekt të tillë; (c) substanca ose objekti përmbush kërkesat teknike për qëllimet specifike dhe është në përputhje me legjislacionin dhe standardet ekzistuese që zbatohen për produktet; dhe (d) përdorimi i substancës ose objektit nuk do të çojë në ndikime të përgjithshme negative në mjedis ose në shëndetin e njeriut.	*Projektligji*	*8 (1)*	**Neni 8** **Fundi i statusit mbetje** 1. Për qëllim të këtij ligji, mbetja që ka pësuar një operacion riciklimi ose operacione të tjera rikuperimi, pushon së qeni mbetje, vetëm në qoftë se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme: a) substanca ose objekti do të përdoret për qëllime të caktuara; b) ekziston tregu apo kërkesa për atë substancë ose objekt; c) substanca ose objekti plotëson kërkesat teknike për përdorimin e caktuar dhe është në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe standardet që zbatohen për këto produkte; ç) përdorimi i substancës ose objektit plotëson të gjitha kërkesat për mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit dhe nuk sjell ndikime të përgjithshme negative në mjedis ose në shëndetin e njeriut.	E plotë	Neni 8 (1) i projekt ligjit është në përputhje të plotë me nenin 6 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Edhe në këtë rast kushtet janë kumulative, gjë që specifikohet edhe nga Udhëzimi i komisionit për interpretimin e Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, faqe 22-27.
6 (2)	2. Komisioni do të monitorojë zhvillimin e kritereve kombëtare për fundin e statusit mbetje në Shtetet Anëtare dhe do të vlerësojë nevojën për të zhvilluar kritere të BE-së mbi këtë bazë. Për këtë qëllim, dhe kur është e përshtatshme, Komisioni do të miratojë akte zbatimi për të vendosur kritere të detajuara për aplikimin uniform të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 për disa lloje mbetjesh. Këto kritere të detajuara duhet të sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje të mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe të lehtësojnë përdorimin e kujdesshëm dhe të arsyeshëm të burimeve natyrore. Ato do të përfshijnë: (a) materialet e lejuara të mbetjeve për operacionin e rikuperimit; (b) proceset dhe teknikat e trajtimit të lejuara; (c) kritere cilësie për materialet me fund të statusit të mbetjes që rezultojnë nga operacioni i rikuperimit në përputhje me standardet për produktet, duke përfshirë vlerat kufi për ndotësit kur është e nevojshme;	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	(d) kërkesat për sistemet e menaxhimit për të demonstruar përputhshmërinë me kriteret për fundin e statusit mbetje, duke përfshirë për kontrollin e cilësisë dhe vetë-monitorimin, dhe akreditimin, kur është e përshtatshme; dhe (e) një kërkesë për një deklaratën e konformitetit. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 39(2). Kur miraton këto akte zbatimi, Komisioni do të marrë parasysh kriteret përkatëse të vendosura nga Shtetet Anëtare në përputhje me paragrafin 3 dhe do të marrë si pikënisje kriteret më shtrënguese dhe mbrojtëse për mjedisin.					
6 (3)	3. Kur kriteret nuk janë vendosur në nivelin e BE-së sipas paragrafit 2, Shtetet Anëtare mund të vendosin kritere të detajuara për aplikimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 për disa lloje mbetjesh. Këto kritere të detajuara do të marrin parasysh çdo ndikim të mundshëm negativ në mjedis dhe në shëndetin e njeriut të substancës ose objektit dhe do të përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikat (a) deri (e) të paragrafit 2.	*Projektligji*	*8 (2)*	3. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit miraton kriteret dhe procedurat e posaçme për njohjen e fundit të statusit mbetje për çdo lloj mbetjeje. Këto kritere sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, lehtësojnë përdorimin e kujdesshëm dhe të arsyeshëm të burimeve natyrore dhe përfshijnë të paktën: a) kërkesën që në operacionet e rikuperimit të përdoren materiale të lejuara mbetjesh; b) kërkesën që të përdoren procese dhe teknika të lejuara trajtimi; c) kritere cilësie sipas standardeve për produktet përkatëse, që plotësohen nga materialet që kanë pushuar së qëni mbetje pas operacioneve të rikuperimit dhe kur është e nevojshme, vlera kufi të ndotësve; ç) kërkesën që sistemet e menaxhimi të kenë aftësinë të tregojnë se zbatohen kriteret e fundit të statusit mbetje, dhe që të përfshijnë kontrollin e cilësisë, vetë-monitorimin dhe kur është e nevojshme akreditimin; d) kërkesën për deklaratën e konformitetit.	E plotë	Neni 8 (2) i projekt ligjit e parashikon se do të ketë kritere dhe procedura të posaçme që do të përcaktojnë për çdo lloj mbetjeje fundin e statusit e mbetjeve në përputhje me parimet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 6 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

6 (3) *Paragrafi 2*	Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin për këto kritere në përputhje me Direktivën (BE) 2015/1535 kur e kërkon ajo Direktivë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
6 (4)	4. Kur kriteret nuk janë vendosur në nivelin e BE-së ose në nivel kombëtar sipas paragrafëve 2 ose 3, përkatësisht, një Shtet Anëtar mund të vendosë në një rast të veçantë, ose të marrë masa të përshtatshme për të verifikuar, që disa mbetje kanë pushuar së qeni mbetje në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe, kur është e nevojshme, duke reflektuar kërkesat e përcaktuara në pikat (a) deri në (e) të paragrafit 2, dhe duke marrë parasysh vlerat kufi për ndotësit dhe çdo ndikim të mundshëm negativ në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Vendimet për rastet e veçanta nuk kërkohet të njoftohen pranë Komisionit në përputhje me Direktivën (BE) 2015/1535. Shtetet Anëtare mund të bëjnë të disponueshme për publikun informacionin mbi vendimet për rastet e veçanta dhe mbi rezultatet e verifikimeve nga autoritetet kompetente përmes mjeteve elektronike.	N/A	N/A	N/A	N/A	Neni 6 (4) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, nuk është i zbatueshëm sepse Shqipëria ka zgjedhur opsionin e miratimit të kritereve në nivel kombëtar, me aktet nënligjore të parashikuar në nenin 8(2) më sipër të projekt ligjit. Si rrjedhojë nuk zbatohet verifikimi rast pas rasti.
6 (5)	5. Personi fizik ose juridik që: (a) përdor, për herë të parë, një material që ka pushuar së qeni mbetje dhe që nuk është hedhur në treg; ose (b) hedh një material në treg për herë të parë pasi ka pushuar së qeni mbetje, do të sigurojë që materiali të plotësojë kërkesat përkatëse sipas legjislacionit të zbatueshëm për kimikatet dhe produktet. Kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 duhet të përmbushen para se legjislacioni për kimikatet dhe produktet të zbatohet, për materialin që ka pushuar së qeni mbetje.	Projektligji	8 (2)	2. Çdo person fizik ose juridik që përdor, për herë të parë, një material që ka pushuar së qeni mbetje dhe nuk është hedhur në treg, ose hedh për herë të parë në treg një material që ka pushuar së qeni mbetje, sigurohet që materiali përmbush këto kushte dhe kritere: a) kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni; b) kriteret e legjislacionit të posaçëm për kimikatet; c) kriteret e legjislacionit të posaçëm për produktin përkatës	E plotë	Neni 8 (2) i projektligjit është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 6 (5) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve në lidhje me kushtet e sigurisë që duhet të plotësojë mbetja për marrjen e fundit të statusit të mbetjes.
Neni 7 ***Lista e mbetjeve*** *(1)*	1. Komisioni ka fuqinë të miratojë akte të deleguara në përputhje me Nenin 38a për të plotësuar këtë Direktivë, duke krijuar dhe rishikuar në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni, një listë të mbetjeve.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
7 (1) *Paragrafi 2*	◄ Lista e mbetjeve duhet të përfshijë mbetje të rrezikshme dhe duhet të marrë parasysh origjinën dhe përbërjen e mbetjeve dhe, kur është e nevojshme, vlerat kufi të përqëndrimit të substancave të rrezikshme. Lista e mbetjeve do të jetë e detyrueshme për sa i përket përcaktimit të mbetjeve që	*Projektligji*	*9*	**Neni 9** **Klasifikimi dhe katalogu i mbetjeve** Në kuadër të këtij ligji mbetjet klasifikohen mbi bazën e origjinës	E plotë	Neni 7 (1) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, synon rregullimin e klasifikimit të mbetjeve në BE dhe përmban udhëzimet mbi metodologjinë e klasifikimit të mbetjeve. Edhe projekt ligji shqiptar

	konsiderohen si mbetje të rrezikshme. Përfshirja e një substance ose objekti në listë nuk do të thotë se ajo është mbetje në të gjitha rrethanat. Një substancë ose objekt do të konsiderohet si mbetje vetëm nëse plotësohet përkufizimi në pikën (1) të Nenit 3.			së krijimit, në mbetje shtëpiake dhe mbetje nga veprimtari të tjera, dhe mbi bazën e karakteristikave të rrezikshmërisë, në mbetje të rrezikshme dhe mbetje jo të rrezikshme. Klasifikimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet nga katalogu i mbetjeve që përmban listën e mbetjeve, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre dhe kur është e nevojshme, edhe sipas vlerave kufi të përqendrimit të substancave të rrezikshme. Katalogu i mbetjeve miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Katalogu i mbetjeve përfshin mbetjet e rrezikshme që klasifikohen si të tilla në përputhje me vetitë e mbetjeve të përcaktuara në Shtojcën 3 të këtij ligji. Klasifikimi i një mbetjeje në katalogun e mbetjeve, si mbetje e rrezikshme, është detyrues Ndalohet hollimi apo përzierja e mbetjeve të rrezikshme me mbetje të tjera, me qëllim uljen e përqendrimeve fillestare të substancave të rrezikshme në një nivel më të ulët se vlera kufi, që i përkufizon mbetjet si të rrezikshme, me qëllim riklasifikimin e tyre si mbetje jo të rrezikshme. Pavarësisht se një substancë ose objekt gjendet në katalogun e mbetjeve, ajo konsiderohet si e tillë vetëm në rastet kur përmbush parashikimet e pikës 17 të nenit 4 të këtij ligji. Ministria, të paktën çdo 2 vjet, analizon nëse është i nevojshëm rishikimi i katalogut të mbetjeve, veçanërisht në rastet kur		për menaxhimin e integruar të mbetjeve ndjek të njëjtën linjë klasifikimi si direktiva në lidhje me origjinën e mbetjeve dhe përbërësve të rrezikshëm të mbetjeve. Po njësoj si direktiva, edhe projektligji përcakton që klasifikimi i një mbetjeje si e rrezikshme, në katalogun e mbetjeve, është detyrues. Edhe legjislacioni shqiptar thekson parimin që një substancë ose objekt konsiderohet mbetje vetëm kur plotëson kushtet e të qenurit mbetje sipas përkufizimit përkatës. Rrezikshmëria e mbetjeve sipas legjislacioni shqiptar, përcaktohet bazuar në Shtojcën 3 të projekt ligjit. Si rrjedhojë sistemi shqiptar i klasifikimit të mbejteve ndjek me përpikmëri sistemin e BE-së.

				evidenton një mbetje të re të rrezikshme ose kur konstaton se një mbetje e klasifikuar si e rrezikshme nuk shfaq vetitë e listuara në Shtojcën 3. Në këto raste dhe në raste të tjera kur është e nevojshme, Ministri i propozon Këshillit të Ministrave rishikimin e katalogut të mbetjeve, me qëllim përditësimin dhe përshtatjen e tij. Katalogu i mbetjeve dhe çdo rishikim i tij, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë.		
7 (2)	2. Një Shtet Anëtar mund të konsiderojë mbetjet si mbetje të rrezikshme kur, edhe pse nuk shfaqet si e tillë në listën e mbetjeve, ajo paraqet një ose më shumë nga vetitë e renditura në Shtojcën III. Shteti Anëtar do të njoftojë Komisionin për çdo rast të tillë pa vonesë dhe do ti ofrojë Komisionit të gjitha informacionet përkatëse. Në vijim të njoftimeve të marra, lista do të rishikohet për të vendosur mbi përshtatjen e saj.	*Projektligji*	*4 (25)* *9 (1), (2), (3)*	Neni 4 **Përkufizime** 25. "Mbetje të rrezikshme" janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij ligji. **Neni 9** **Klasifikimi dhe katalogu i mbetjeve** 1. Në kuadër të këtij ligji mbetjet klasifikohen mbi bazën e origjinës së krijimit, në mbetje shtëpiake dhe mbetje nga veprimtari të tjera, dhe mbi bazën e karakteristikave të rrezikshmërisë, në mbetje të rrezikshme dhe mbetje jo të rrezikshme. 2. Klasifikimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet nga katalogu i mbetjeve që përmban listën e mbetjeve, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre dhe kur është e nevojshme, edhe sipas vlerave kufi të përqendrimit të substancave të rrezikshme. Katalogu i mbetjeve miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.	E plotë	Përkufizimi i 'mbetjeve të rrezikshme' sipas projektligjit lidhet me vetitë e mbetjeve dhe jo me faktin nëse është apo jo e përfshirë në katalogun e mbetjeve. Kështu konsiderohet mbetje e rrezikshme çdo mbetje që paraqet vetitë e rrezikshme të listuara në Shtojcën 3 të këtij ligji që është në përputhje të pjesshme me Aneksin III të Direktivës. Pra një mbetjet mund të konsiderohet si mbetje e rrezikshme edhe në rast se nuk është e përfshirë në katalog por përmban vetitë e mbetjes së rrezikshme sipas Shtojcës 3 të ligjit. Në këto raste katalogu i mbetjeve duhet të përditësohet sipas nenit 9 të projektligjit. Si rrjedhojë sistemi shqiptar i klasifikimit të mbejteve ndjek me përpikmëri sistemin e BE-së.

				3. Katalogu i mbetjeve përfshin mbetjet e rrezikshme që klasifikohen si të tilla në përputhje me vetitë e mbetjeve të përcaktuara në Shtojcën 3 të këtij ligji. Klasifikimi i një mbetjeje në katalogun e mbetjeve, si mbetje e rrezikshme, është detyrues 6. Ministria, të paktën çdo 2 vjet, analizon nëse është i nevojshëm rishikimi i katalogut të mbetjeve, veçanërisht në rastet kur evidenton një mbetje të re të rrezikshme ose kur konstaton se një mbetje e klasifikuar si e rrezikshme nuk shfaq vetitë e listuara në Shtojcën 3. Në këto raste dhe në raste të tjera kur është e nevojshme, Ministri i propozon Këshillit të Ministrave rishikimin e katalogut të mbetjeve, me qëllim përditësimin dhe përshtatjen e tij.		
7 (3)	3. Kur një Shtet Anëtar ka prova për të treguar se mbetje të caktuara që shfaqen në listë si mbetje të rrezikshme nuk paraqesin asnjë nga vetitë e renditura në Shtojcën III, ai mund ta konsiderojë atë mbetje si mbetje jo të rrezikshme. Shteti Anëtar do të njoftojë Komisionin për çdo rast të tillë pa vonesë dhe do ti ofrojë Komisionit provat e nevojshme. Në vijm të njoftimeve të marra, lista do të rishikohet për të vendosur mbi përshtatjen e saj.	*Projektligji*	*9 (6)*	6. Ministria, të paktën çdo 2 vjet, analizon nëse është i nevojshëm rishikimi i katalogut të mbetjeve, veçanërisht në rastet kur evidenton një mbetje të re të rrezikshme ose kur konstaton se një mbetje e klasifikuar si e rrezikshme nuk shfaq vetitë e listuara në Shtojcën 3. Në këto raste dhe në raste të tjera kur është e nevojshme, Ministri i propozon Këshillit të Ministrave rishikimin e katalogut të mbetjeve, me qëllim përditësimin dhe përshtatjen e tij.	E plotë	Edhe në këtë rast sistemi shqiptar përputhet me sistemin e BE-së, pasi parashikon mundësinë që katalogu i mbetjeve të përditësohet duke hequr nga katalogu mbetje të klasifikuara të rrezikshme kur nuk kanë më vetitë e përcaktuara në Shtojcën 3 të ligjit.
7 (4)	4. Riklasifikimi i mbetjeve të rrezikshme si mbetje jo të rrezikshme nuk mund të arrihet duke e holluar ose përzier mbetjen me qëllim për të ulur përqëndrimet fillestare të substancave të rrezikshme në një nivel më të ulët se kufinjtë për përcaktimin e mbetjeve si të rrezikshme.	*Projektligji*	*9 (4)*	4. Ndalohet hollimi apo përzierja e mbetjeve të rrezikshme me mbetje të tjera, me qëllim uljen e përqendrimeve fillestare të substancave të rrezikshme në një nivel më të ulët se vlera kufi, që i përkufizon mbetjet si të rrezikshme, me qëllim	E plotë	Neni 9 (4) i projekt ligjin parashikon të njëjtin ndalim të përcaktuar nga neni 7 (4) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

				riklasifikimin e tyre si mbetje jo të rrezikshme.		
7 (6)	6. Shtetet Anëtare mund të konsiderojnë mbetjet si mbetje jo të rrezikshme, në përputhje me listën e mbetjeve të përmendur në paragrafin 1.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
7 (7)	7. Komisioni do të sigurojë që lista e mbetjeve dhe çdo rishikim i kësaj liste të respektojë, sipas rastit, parimet e qartësisë, kuptueshmërisë dhe aksesueshmërisë për përdoruesit, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të).	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 8 ***Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit*** *(1)*	1. Për të përforcuar ripërdorimin dhe parandalimin, riciklimin dhe rikuperimet e tjera të mbetjeve, Shtetet Anëtare mund të ndërmarrin masa legjislative ose jolegjislative për të siguruar që çdo person fizik ose juridik që në mënyrë profesionale zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhues i produktit) të ketë përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit. Këto masa mund të përfshijnë pranimin e produkteve të kthyera dhe të mbetjeve që mbeten pasi këto produkte të jenë përdorur, si dhe menaxhimin e mëtejshëm të mbetjeve dhe përgjegjësinë financiare për këto aktivitete. Këto masa mund të përfshijnë detyrimin për të ofruar informacion të disponueshëm publikisht mbi shkallën në të cilën produkti është i ripërdorshëm dhe i ricikluesshëm. Kur këto masa përfshijnë krijimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, kërkesat e përgjithshme minimale të përcaktuara në Nenin 8a do të aplikohen. Shtetet Anëtare mund të vendosin që prodhuesit e produkteve që ndërmarrin përgjegjësi financiare ose financiare dhe organizative për menaxhimin e fazës së mbetjes së ciklit të jetës së produktit sipas dëshirës së tyre, duhet të aplikojnë disa ose të gjitha kërkesat e përgjithshme minimale të përcaktuara në Nenin 8a.	*Projektligji*	*17*	**Neni 17** **Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese** Subjekti prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit përfshihet në skemën e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese. Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese, rregullohet me ligj të posaçëm.	E pjesshme	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve përmban vetëm përshkrimin e mekanizmit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të parashikuara në Direktivën 2008/98/EC të mbetjeve, por parashikimet dhe rregullimet specifike i përmban projekt ligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit që është ligji i posacëm. Megjithatë në tekstin e neni 17 të këtij projektligjit vihet re një mospërputhje mes termit 'prodhuesi i produktit' të përdorur nga Direktiva 2008/98/KE e mbetjeve, dhe termit 'subjekti prodhues' të përdorur nga projektligji. Kjo sjell një mosmpërputhje terminologjike me direktivën kuadër të mbetjeve. Vlerësimi i hollësishëm i përputhshmërisë së dispozitave për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është kryer në kuadër të projekt ligjit për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit dhe niveli i përafrimit ka rezultuar i pjesshëm.

8 (2)	2. Shtetet Anëtare mund të ndërmarrin masa të përshtatshme për të inkurajuar projektimin e produkteve dhe komponentëve të produkteve me qëllim për të reduktuar ndikimin e tyre në mjedis dhe krijimin e mbetjeve gjatë prodhimit dhe përdorimit të mëtejshëm të produkteve, dhe për të siguruar që rikuperimi dhe asgjësimi i produkteve që janë kthyer në mbetje të bëhen në përputhje me Nenet 4 dhe 13. Masa të tilla mund të inkurajojnë, ndër të tjera, zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e produkteve dhe komponentëve të produkteve që janë të përshtatshëm për përdorim të shumëfishtë, që përmbajnë materiale të ricklueshme, që janë teknikisht të qëndrueshëm dhe lehtësisht të riparueshëm dhe që, pasi janë kthyer në mbetje, janë të përshtatshëm për përgatitje për ripërdorim dhe riciklim në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i duhur i hierarkisë së mbetjeve. Masat do të marrin parasysh ndikimin e produkteve gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës, hierarkinë e mbetjeve dhe, sipas rastit, potencialin për riciklim të shumëfishtë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (3)	3. Kur aplikojnë përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, Shtetet Anëtare marrin parasysh fizibilitetin teknik dhe leverdinë ekonomike dhe ndikimet e përgjithshme mjedisore, shëndetin e njeriut dhe impaktin shoqëror, duke respektuar nevojën për të siguruar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (4)	4. Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit do të zbatohet pa cënuar përgjegjësinë për menaxhimin e mbetjeve siç parashikohet në nenin 15(1) dhe pa cënuar legjislacionin ekzistues për rrymat specifike të mbetjeve dhe produktet.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8 (5)	5. Komisioni do të organizojë një shkëmbim informacioni midis Shteteve Anëtare dhe aktorëve të përfshirë në skemat e zgjeruara të përgjegjësisë së	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	prodhuesit mbi zbatimin praktik të kërkesave minimale të përgjithshme të përcaktuara në nenin 8a. Kjo përfshin, ndër të tjera, shkëmbimin e informacionit mbi praktikat më të mira për të siguruar qeverisjen e duhur, bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me skemat e zgjeruara të përgjegjësisë së prodhuesit dhe një funksionim të mirë të tregut të brendshëm, mbi veçoritë organizative dhe monitorimin e organizatave që zbatojnë detyrimet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në emër të prodhuesve të produkteve, për modulimin e kontributeve financiare, për përzgjedhjen e operatorëve të menaxhimit të mbetjeve dhe për parandalimin e hedhjes së mbetjeve. Komisioni publikon rezultatet e shkëmbimit të informacionit dhe mund të japë udhëzime për këto dhe aspekte të tjera relevante. Komisioni do të publikojë udhëzime, në konsultim me Shtetet Anëtare, për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me skemat e zgjeruara të përgjegjësisë së prodhuesit dhe mbi modulimin e kontributeve financiare të përmendura në pikën (b) të nenit 8a (4). Kur është e nevojshme për të shmangur prishjen e tregut të brendshëm, Komisioni mund të miratojë akte zbatimi për të përcaktuar kriteret me qëllim zbatimin uniform të pikës (b) të nenit 8a (4), por duke përjashtuar çdo përcaktim të saktë të nivelit të kontributeve. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 39(2).					
Neni 8a ***Kërkesat e përgjithshme minimale për skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit*** *(1)*	1. Kur krijohen skema të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në përputhje me nenin 8(1), duke përfshirë në zbatim të akteve të tjera legjislative të Bashkimit, Shtetet Anëtare duhet: (a) të përcaktojnë në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve përkatës të përfshirë, duke përfshirë prodhuesit e produkteve që vendosin produkte në tregun e Shtetit Anëtar, organizatat që zbatojnë detyrime të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në emër të tyre, operatorët privatë ose publikë të mbetjeve, autoritetet vendore dhe, sipas rastit, operatorët për ripërdorimin dhe përgatitjen për ripërdorim dhe ndërmarrjet e ekonomisë sociale; (b) në përputhje me hierarkinë e mbetjeve, të caktojnë objektiva të menaxhimit të mbetjeve, duke synuar	N/A	N/A	N/A	N/A	Projekt ligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit është në proces miratimi. Vlerësimi i përputhshmërisë së dispozitave për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve është kyrer në kuadër të projekt ligjit për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit.

	arritjen e të paktën objektivave sasiorë të rëndësishëm për skemën e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, siç përcaktohen në këtë Direktivë, në Direktivën 94/62/KE, në Direktivën 2000/53/KE, në Direktivën 2006/66/KE dhe në Direktivën 2012/19/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[5], dhe vendosin objektiva të tjerë sasiorë dhe/ose objektiva cilësorë që konsiderohen të rëndësishëm për skemën e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit; (c) të sigurojnë që ekziston një sistem raportimi për të mbledhur të dhëna për produktet e vendosura në tregun e Shtetit Anëtar nga prodhuesit e produkteve që i nënshtrohen përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe të dhëna për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve që rezultojnë nga ato produkte duke specifikuar, kur është e përshtatshme, rrjedhën e materialeve të mbetjeve, si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për qëllimet e pikës (b); (d) të sigurojnë trajtim të barabartë të prodhuesve të produkteve, pavarësisht nga origjina ose madhësia e tyre, pa vënë një barrë rregullatore disproporcionale për prodhuesit, përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e sasive të vogla të produkteve.					
8a (2)	2. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që zotëruesit e mbetjeve subjekt i skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të krijuara në përputhje me nenin 8(1), të informohen për masat e parandalimit të mbetjeve, qendrat për ripërdorim dhe përgatitje për ripërdorim, sistemet e rikthimit dhe grumbullimit, dhe parandalimin e hedhjes së mbetjeve. Shtetet Anëtare do të marrin gjithashtu masa për të krijuar incentiva për zotëruesit e mbetjeve që të marrin përsipër përgjegjësinë e tyre për të dorëzuar mbetjet e tyre në sistemet e grumbullimit të diferencuar në vend, veçanërisht, kur është e përshtatshme, nëpërmjet incentivave ose rregullimeve ekonomike.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8a (3)	3. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që çdo prodhues i produkteve ose organizatë që zbaton detyrime të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në emër të prodhuesve të produkteve: (a) ka një mbulim gjeografik, të produktit dhe të materialit të përcaktuar qartë, pa i kufizuar ato zona	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

[5] Direktiva 2012/19/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 4 korrik 2012 mbi mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE) (OJ L 197, 24.7.2012, p. 38)

	në ato ku grumbullimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë më fitimprurës; (b) siguron disponueshmërinë e duhur të sistemeve të grumbullimit të mbetjeve brenda zonave të përmendura në pikën (a); (c) ka mjetet e nevojshme financiare ose mjetet financiare dhe organizative për të përmbushur detyrimet e tij të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit; (d) vendos një mekanizëm të përshtatshëm të vetëkontrollit, të mbështetur, sipas rastit, nga auditime të rregullta të pavarura, për të vlerësuar: (i) menaxhimin financiar të tij, duke përfshirë përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 4; (ii) cilësinë e të dhënave të mbledhura dhe të raportuara në përputhje me pikën (c) të paragrafit 1 të këtij neni dhe me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 1013/2006; (e) vë në dispozicion të publikut informacionin në lidhje me arritjen e objektivave të menaxhimit të mbetjeve të përmendura në pikën (b) të paragrafit 1, dhe, në rastin e përmbushjes kolektive të detyrimeve të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, gjithashtu informacion rreth: (i) pronësinë dhe anëtarësimin e tij; (ii) kontributet financiare të paguara nga prodhuesit e produkteve për njësi të shitur ose për ton produkt të vendosur në treg; dhe (iii) procedurën e përzgjedhjes për operatorët e menaxhimit të mbetjeve.					
8a (4)	4. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që kontributet financiare të paguara nga prodhuesi i produktit të jenë në përputhje me detyrimet e tij të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit: (a) të mbulojë kostot e mëposhtme për produktet që prodhuesi hedh në tregun e shtetit anëtar në fjalë: — kostot e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe transportit dhe trajtimit të tyre të mëvonshëm, duke përfshirë trajtimin e nevojshëm për të përmbushur objektivat e Bashkimit për menaxhimin e mbetjeve, dhe kostot e nevojshme për të përmbushur synimet dhe objektivat e tjera siç përmenden në pikën (b) të paragrafit 1, duke marrë parasysh të ardhurat nga ripërdorimi, nga shitja e lëndës së parë dytësore	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	nga produktet e saj dhe nga tarifat e pa mbledhura të depozitave, — kostot e sigurimit të informacionit të duhur për zotëruesit e mbetjeve në përputhje me paragrafin 2, — kostot e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave në përputhje me pikën (c) të paragrafit 1. Kjo pikë nuk do të zbatohet për skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të krijuara në përputhje me Direktivën 2000/53/KE, 2006/66/KE ose 2012/19/BE; (b) në rastin e përmbushjes kolektive të detyrimeve të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, modulohen, aty ku është e mundur, për produkte individuale ose grupe produktesh të ngjashme, veçanërisht duke marrë parasysh qëndrueshmërinë, riparueshmërinë, ripërdorueshmërinë dhe riciklimin e tyre dhe praninë e substancave të rrezikshme, duke konsideruar në këtë mënyrë qasjen ndaj ciklit të jetës dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Ligji përkatës i Bashkimit, dhe kur është i disponueshëm, bazuar në kritere të harmonizuara për të siguruar një funksionim të mirë të tregut të brendshëm; dhe (c) të mos tejkalojë kostot që janë të nevojshme për të ofruar shërbime të menaxhimit të mbetjeve me efikasitet të kostove. Kostot e tilla do të vendosen në mënyrë transparente ndërmjet aktorëve të interesuar. Kur justifikohet nga nevoja për të siguruar menaxhimin e duhur të mbetjeve dhe qëndrueshmërinë ekonomike të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, Shtetet Anëtare mund të devijojnë nga ndarja e përgjegjësisë financiare siç është përcaktuar në pikën (a), me kusht që: (i) në rastin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të krijuara për të arritur objektivat dhe synimet e menaxhimit të mbetjeve të përcaktuara nën aktet legjislative të Bashkimit, prodhuesit e produkteve të mbajnë të paktën 80% të kostove të nevojshme; (ii) në rastin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të krijuara më 4 Korrik 2018 ose më pas, për të arritur objektivat dhe synimet e menaxhimit të					

	mbetjeve të përcaktuara vetëm në legjislacionin e Shtetit Anëtar, prodhuesit e produkteve të mbajnë të paktën 80% të kostove të nevojshme; (iii) në rastin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të krijuara para datës 4 Korrik 2018 për të arritur objektivat dhe synimet e menaxhimit të mbetjeve të përcaktuara vetëm në legjislacionin e Shtetit Anëtar, prodhuesit e produkteve të mbajnë të paktën 50% të kostove të nevojshme, dhe me kusht që kostot e mbetura të mbulohen nga prodhuesit ose distributorët fillestarë të mbetjeve. Ky përjashtim nuk mund të përdoret për të ulur përqindjen e kostove që mbajnë prodhuesit e produkteve nën skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të krijuara para datës 4 Korrik 2018.					
8a (5)	5. Shtetet Anëtare do të krijojnë një kuadër të përshtatshëm monitorimi dhe zbatimi me qëllim që të sigurojnë që prodhuesit e produkteve dhe organizatat që zbatojnë detyrimet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në emër të tyre, të zbatojnë detyrimet e tyre të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, duke përfshirë rastin e shitjeve në distancë, që mjetet financiare të përdoren siç duhet dhe që të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të raportojnë të dhëna të besueshme. Kur, në territorin e një Shteti Anëtar, disa organizata zbatojnë detyrimet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në emër të prodhuesve të produkteve, Shteti Anëtar përkatës do të caktojë të paktën një organ të pavarur nga interesat private ose do të ngarkojë një autoritet publik për të mbikëqyrur zbatimin e detyrimeve të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Çdo Shtet Anëtar do të lejojë që prodhuesit e produkteve të regjistruar në një Shtet Anëtar tjetër dhe që vendosin produkte në territorin e tij, të emërojnë një person juridik ose fizik të regjistruar në territorin e tij si përfaqësues të autorizuar për qëllime të përmbushjes së detyrimeve të një prodhuesi në lidhje me skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në territorin e tij.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	Për qëllimet e monitorimit dhe verifikimit të përputhshmërisë me detyrimet e prodhuesit të produktit në lidhje me skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë kërkesa, të tilla si regjistrimi, informacioni dhe kërkesat për raportim, që duhet të përmbushen nga një person juridik ose fizik për t'u emëruar si përfaqësues i autorizuar në territorin e tyre.					
8a (6)	6. Shtetet Anëtare do të sigurojnë një dialog të rregullt midis palëve të interesuara të përfshira në zbatimin e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, duke përfshirë prodhuesit dhe distributorët, operatorët privatë ose publikë të mbetjeve, autoritetet vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe, kur është e aplikueshme, aktorët e ekonomisë sociale, rrjetet e ripërdorimit dhe të riparimit dhe operatorët e përgatitjes për ripërdorim.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8a (7)	7. Shtetet Anëtare do të marrin masa për të siguruar që skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit që janë krijuar para 4 Korrik 2018, të jenë në përputhje me këtë Nen deri më 5 Janar 2023.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
8a (8)	8. Dhënia e informacionit për publikun në bazë të këtij Neni do të bëhet pa cënuar ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit tregtar të ndjeshëm në përputhje me ligjin përkatës të Bashkimit dhe legjislacionin kombëtar	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 9 ***Parandalimi i mbetjeve*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masa për të parandaluar krijimin e mbetjeve. Këto masa duhet, së paku: (a) të promovojnë dhe mbështesin modele të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit; (b) të inkurajojnë projektimin, prodhimin dhe përdorimin e produkteve që janë efikase në përdorimin e burimeve, të qëndrueshme (përfshirë në lidhje me jetëgjatësinë dhe mungesën e daljes nga përdorimi), të riparueshme, të ripërdorshme dhe të përmirësueshme; (c) të shënjestrojnë produktet që përmbajnë materiale kritike për të parandaluar që këto materiale të kthehen mbetje; (d) të inkurajojnë ripërdorimin e produkteve dhe krijimin e sistemeve që promovojnë aktivitetet e riparimit dhe ripërdorimit, duke përfshirë veçanërisht pajisjet elektrike dhe elektronike, tekstilet dhe	*Projektligji*	*10, 66*	**Neni 10** **Parandalimi i mbetjeve** 1. Parandalimi i mbetjeve kryhet nëpërmjet masave të parashikuara në Programin Kombëtar të Parandalimit të mbetjeve që miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, në përputhje me parashikimet e nenit 66, të këtij ligji. 2. Masat për parandalimin e mbetjeve në nivel sektorial, zonal apo vendor parashikohen, sipas rastit, edhe në planet sektoriale, zonale apo vendore për menaxhimin e integruar të	E pjesshme	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve e parashikon në parim se parandalimi i mbetjeve rradhitet i pari në hierarkinë e mbetjeve. Megjithatë asnjë nga dispozitat specifike të projektligjit – neni 10, neni 66 dhe Shtojca 5 - nuk përfshijnë masat kryesore për parandalimin e mbetjeve të parashikuara në nenin 9 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

	mobiljet, si dhe produktet dhe materialet e ambalazhit dhe ndërtimit; (e) të inkurajojnë, kur është e përshtatshme dhe pa cënuar të drejtat e pronësisë intelektuale, mundësimin e pjesëve rezervë, manualeve të udhëzimeve, informacionit teknik, ose instrumenteve të tjera, pajisjeve ose softuerëve që mundësojnë riparimin dhe ripërdorimin e produkteve pa kompromentuar cilësinë dhe sigurinë e tyre; (f) të reduktojnë krijimin e mbetjeve në proceset e prodhimit industrial, nxjerrjes së mineraleve, prodhimit, ndërtimit dhe shembjes, duke marrë parasysh teknikat më të mira të disponueshme; (g) të reduktojnë krijimin e mbetjeve ushqimore në prodhimin parësor, në përpunim dhe prodhim, në shitje dhe shpërndarje të tjera të ushqimit, në restorante dhe shërbime ushqimore, si dhe në shtëpia, si një kontribut për Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara për të reduktuar mbetjet ushqimore me 50% për frymë në nivelin e shitjes me pakicë dhe konsumatorëve dhe për të reduktuar humbjet e ushqimit gjatë zinxhirëve të prodhimit dhe furnizimit deri në vitin 2030; (h) të inkurajojnë dhurimin e ushqimit dhe shpërndarjet e tjera për konsum njerëzor, duke e prioritarizuar përdorimin nga njeriu para ushqimit të kafshëve dhe ripërpunimin në produkte jo ushqimore; (i) të promovojnë reduktimin e përmbajtjes së substancave të rrezikshme në materiale dhe produkte, pa cënuar kërkesat ligjore të harmonizuara në lidhje me këto materiale dhe produkte të përcaktuara në nivelin e Bashkimit, dhe të sigurojnë që çdo furnizues i një artikulli siç është përcaktuar në pikën 33 të Nenit 3 të Rregullores (KE) Nr. 1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[6] të sigurojë informacionin sipas Nenit 33(1) të asaj Rregulloreje në Agjencinë Evropiane të Kimikateve që nga 5 Janari 2021; (j) të reduktojnë krijimin e mbetjeve, veçanërisht të mbetjeve që nuk janë të përshtatshme për përgatitje për ripërdorim ose riciklim; (k) të identifikojnë produktet që janë burimet kryesore të hedhjes së mbetjeve, veçanërisht në ambientet			mbetjeve të parashikuar në nenet 63-65 të këtij ligji. Në çdo rast këto masa janë në përputhje me masat e parashikuara në Programin Kombëtar të parandalimit të mbetjeve dhe me parashikimet e këtij ligji. **Neni 66** **Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve** 1. Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve përcakton politikat kombëtare për parandalimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim garantimin që rritja ekonomike të mos shoqërohet me ndikime negative në mjedis nga mbetjet e krijuara. 2. Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve përmban objektivat e parandalimit të mbetjeve dhe masat për realizimin e tyre sipas Shtojcës 5 të këtij ligji. 3. Ministria harton Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe bashkitë, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit. 4. Programi Kombëtar i Parandalimit të Mbetjeve është pjesë përbërëse e Strategjisë		

[6] Rregullorja (KE) Nr. 1907/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 Dhjetorit 2006 që lidhet me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), që krijon një Agjenci Evropiane për Kimikatet, ndryshon Direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 1488/94, si dhe Direktivën e Këshillit 76/769/KEE dhe Direktivat e Komisionit 91/155/KEE, 93/67/KEE, 93/105/KE dhe 2000/21/KE (OJ L 396, 30.12.2006, fq. 1).

	natyrore dhe detare, dhe të marrin masa të përshtatshme për të parandaluar dhe reduktuar ndotjen nga këto produkte; kur Shtetet Anëtare vendosin të zbatojnë këtë detyrim përmes kufizimeve të tregut, ato duhet të sigurojnë që këto kufizime të jenë proporcionale dhe jo diskriminuese; (l) të synojnë ndalimin e krijimit të mbetjeve detare si një kontribut për Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara për të parandaluar dhe reduktuar ndjeshëm ndotjen detare të të gjitha llojeve; dhe (m) të zhvillojnë dhe mbështesin fushatat e informacionit për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me parandalimin e mbetjeve dhe hedhjen e mbetjeve.			Kombëtare për Menaxhimin e integruar të mbetjeve, si shtojcë e saj, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit.		
9 (2)	2. Agjencia Evropiane e Kimikateve do të krijojë një bazë të dhënash për të dhënat që duhet t'i dorëzohen asaj sipas pikës (i) të paragrafit 1 deri më 5 Janar 2020 dhe do ta mbajë atë. Agjencia Evropiane e Kimikateve do të ofrojë akses në atë bazë të dhënash për operatorët e trajtimit të mbetjeve. Ajo gjithashtu do të ofrojë akses në atë bazë të dhënash për konsumatorët sipas kërkesës.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9 (3)	3. Shtetet Anëtare do të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e masave të parandalimit të mbetjeve. Për këtë qëllim, ato do të përdorin tregues dhe objektiva të përshtatshëm cilësorë ose sasiorë, veçanërisht në lidhje me sasinë e mbetjeve që krijohen.	-	-		E papërputhur	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve nuk i përmban këto parashikime. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet të ri-bëhet pas miratimit të programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve për të parë nëse tek ky i fundit janë përfshirë dispozita për monitorimin, zbatimin dhe treguesit e vlerësimit të përcaktuar nga Neni 9 (3) i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve.
9 (4)	4. Shtetet Anëtare do të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e masave të tyre për ripërdorimin duke matur ripërdorimin në bazë të metodologjisë së përbashkët të përcaktuar nga akti i zbatimit i përmendur në paragrafin 7, që nga viti i plotë kalendarik pas miratimit të atij akti të zbatimit.	-	-	-	E papërputhur	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve nuk i përmban këto parashikime. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet të ri-bëhet pas miratimit të programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve për të parë nëse tek ky i fundit janë përfshirë parashikimet e Nenit 9 (4) i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve.
9 (5)	5. Shtetet Anëtare do të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e masave të tyre për parandalimin e mbetjeve ushqimore duke matur nivelet e mbetjeve	-	-	-	E papërputhur	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve nuk i përmban këto parashikime. Vlerësimi i

	ushqimore në bazë të metodologjisë të përcaktuar nga akti i deleguar i përmendur në paragrafin 8, që nga viti i plotë kalendarik pas miratimit të atij akti të deleguar.					përputhshmërisë duhet të ri-bëhet pas miratimit të programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve për të parë nëse tek ky i fundit janë përfshirë parashikimet e Nenit 9 (5) i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve.
9 (6)	6. Deri më 31 Dhjetor 2023, Komisioni do të shqyrtojë të dhënat mbi mbetjet ushqimore të dhëna nga Shtetet Anëtare në përputhje me Nenin 37(3), me qëllim shqyrtimin e mundësisë së krijimit të një objekti të përbashkët në nivel Bashkimi, për reduktimin e mbetjeve ushqimore për t'u arritur deri në vitin 2030, në bazë të të dhënave të raportuara nga Shtetet Anëtare në përputhje me metodologjinë e përbashkët të përcaktuar sipas paragrafit 8 të këtij Neni. Për këtë qëllim, Komisioni do të paraqesë një raport në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, i shoqëruar, nëse është e përshtatshme, nga një propozim legjislativ.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9 (7)	7. Komisioni do të miratojë akte zbatimi për të krijuar tregues për të matur progresin e përgjithshëm në zbatimin e masave për parandalimin e mbetjeve dhe do të miratojë, deri më 31 Mars 2019, një akt zbatimi për të krijuar një metodologji të përbashkët për raportimin mbi ripërdorimin e produkteve. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 39(2).	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9 (8)	8. Deri më 31 Mars 2019, Komisioni do të miratojë, në bazë të rezultateve të punës së Platformës së BE-së për Humbjet Ushqimore dhe Mbetjet Ushqimore, një akt të deleguar në përputhje me Nenin 38a për të plotësuar këtë Direktivë duke krijuar një metodologji të përbashkët dhe kërkesa minimale të cilësisë për matjen uniforme të niveleve të mbetjeve ushqimore.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
9 (9)	9. Deri më 31 Dhjetor 2024, Komisioni do të shqyrtojë të dhënat mbi ripërdorimin të mundësuara nga Shtetet Anëtare në përputhje me Nenin 37(3), me qëllim shqyrtimin e mundësisë së masave për të inkurajuar ripërdorimin e produkteve, duke përfshirë vendosjen e objektivave sasiorë. Komisioni gjithashtu do të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së masave të tjera për parandalimin e mbetjeve, duke përfshirë objektivat për reduktimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, Komisioni do të paraqesë një raport në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, i shoqëruar, nëse është e përshtatshme, nga një propozim legjislativ.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Neni 10 ***Rikuperimi*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që mbetjet i nënshtrohen përgatitjes për ripërdorim, riciklimit ose operacioneve të tjera rikuperimi, në përputhje me Nenet 4 dhe 13.	*Projektligji*	*5, 12* *(1)*	*Neni 12* **Rikuperimi i mbetjeve** 1. Për kryerjen e operacioneve të përgatitjes për ripërdorim, të riciklimit dhe të rikuperimeve të tjera të mbetjeve në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me parimet e këtij ligji: a) mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, sipas nenit 11 të këtij ligji dhe nuk përzihen me mbetje apo materiale të tjera që janë të ndryshme në përbërje, përveçse në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. b) mbetjet e rrezikshme, substancat, përzierjet apo përbërësit e rrezikshëm, eliminohen përpara apo gjatë rikuperimit, me qëllim trajtimin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji. *Neni 5* **Parime të përgjithshme** 1. Menaxhimi i integruar i mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë është çështje e interesit publik. 2. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet duke respektuar: a) Parimet e mbrojtjes, ruajtjes, dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e mjedisit; b) Parimet e ekonomisë qarkulluese, që i konsideron mbetjet si burim; c) Parimet e barazisë dhe mos diskriminimit, përfshirë barazinë gjinore, si dhe ndikimin e përgjithshëm ekonomik dhe social;	E plotë	Neni 12 i projekt ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve i referohet parimeve të menaxhimit të mbetjeve që parashikohen në nenin 5 të projektligjit dhe hierarkisë së mbetjeve. Neni 5 i projekt-ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikon se të gjitha operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, pra edhe përgatitja për ripërdorim, riciklimi dhe rikuperimet e tjera, kryhen në përputhje me paramiet e parashikuara nga nenet 4 dhe 13 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

				ç) Parimin "ndotësi paguan" sipas parashikimit në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit d) Hierarkinë e mbetjeve. 3. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet sipas kritereve të efikasitetit, eficencës, leverdisë ekonomike, transparencës dhe fizibilitetit teknik dhe ekonomik, për të garantuar një sistem të qëndrueshëm dhe proporcional. Sistemi i menaxhimit te integruar te mbetjeve mbështetet edhe në bashkëpunimin e subjekteve të përfshira në prodhimin, shpërndarjen, përdorimin, konsumin e produkteve, prej të cilave krijohen mbetje. 4. Institucionet dhe subjektet përgjegjëse marrin masat e nevojshme që mbetjet të menaxhohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin, duke garantuar që të mos vihen në rrezik ujërat, ajri, toka, përfshirë tokat bujqësore, bimët ose kafshët dhe të mos shkaktohen shqetësime përmes zhurmës ose erës së pakëndshme, të mos ndikohen negativisht zonat rurale ose zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë.		
10 (2)	2. Kur është e nevojshme për të përmbushur parashikimin e paragrafit 1 dhe për të lehtësuar ose përmirësuar përgatitjen për ripërdorim, riciklimin dhe operacionet e tjera të rikuperimit, mbetjet duhet të jenë subjekt i grumbullimit të diferencuar dhe nuk duhet të përzihen me mbetje të tjera ose materiale të tjera me karakteristika të ndryshme.	*Projektligji*	*11 (2), 12 (1) (a)*	**Neni 11** **Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve** 2. Për të nxitur riciklimin me cilësi të lartë mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore miraton kriteret, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve.	E pjesshme	Pavarësisht se dispozitat e projektligjit e përmendin disa herë se mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, ky detyrim nuk hyn në fuqi me miratimin e ligjit, por me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave që do të vendosë mes të tjerash afatin kur nis detyrimi. Shtyrja e afatit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për një kohë të pacaktuar, përtej vitit 2018 që parashikon legjislacioni aktual, nuk është në përputhje me nenin 10(2) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve,

				Neni 12 **Rikuperimi i mbetjeve** 1. Për kryerjen e operacioneve të përgatitjes për ripërdorim, të riciklimit dhe të rikuperimeve të tjera të mbetjeve në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me parimet e këtij ligji, mbetjet: a) grumbullohen në mënyrë të diferencuar, sipas nenit 11 të këtij ligji dhe nuk përzihen me mbetje apo materiale të tjera që janë të ndryshme në përbërje, përveçse në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.		me hierarkinë e mbetjeve dhe me parimine e ekonomisë qarkulluese. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet të kryhet sërisht pas miratimit të VKM-ve që përcaktojnë afatet e nisjes së riciklimit.
10 (3)	3. Shtetet Anëtare mund të lejojnë përjashtime nga paragrafi 2 në rastet kur një nga kushtet në vijim plotësohet: (a) grumbullimi i disa llojeve të mbetjeve së bashku nuk ndikon në potencialin e tyre për t'u përgatitur për ripërdorim, riciklimin ose operacionet e tjera të rikuperimit në përputhje me Nenin 4 dhe ka rezultat nga këto operacione, që është i krahasueshëm me cilësinë që arrihet përmes grumbullimit të diferencuar; (b) grumbullimi i diferencuar nuk ofron rezultatin më të mirë mjedisor kur merren parasysh ndikimet e përgjithshme mjedisore të menaxhimit të rrymave përkatëse të mbetjeve; (c) grumbullimi i diferencuar nuk është teknikisht i mundshëm duke marrë parasysh praktikat e mira në grumbullimin e mbetjeve; (d) grumbullimi i diferencuar do të krijonte kosto ekonomike jo proporcionale duke marrë parasysh kostot e ndikimeve të dëmshme mjedisore dhe shëndetësore të grumbullimit dhe trajtimit të përzier të mbetjeve, potencialin për përmirësimin e eficiencës në grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve, të ardhurat nga shitjet e materialeve të papërpunuara dytësore si dhe aplikimin e parimit "ndotësi paguan" dhe përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Shtetet Anëtare do të rishikojnë rregullisht përjashtimet sipas këtij paragrafi duke marrë parasysh praktikat e mira në grumbullimin e diferencuar të	*Projektligji*	*12 (2)*	2. Lejohen përjashtime nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në rastet kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme: a) kur grumbullimi i disa lloje mbetjesh së bashku nuk pengon që këto mbetje t'i nënshtrohen përgatitjes për ripërdorim, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera në përputhje me nenin 6 të këtij ligji dhe cilësia e materialit është e ngjashme me cilësinë e materialit që përftohet nga operacionet e përgatitjes për ripërdorim, riciklim dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar; b) kur grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk jep rezultatin më të mirë për mjedisin, duke konsideruar ndikimet e përgjithshme në mjedis nga menaxhimi i rrymave përkatëse të mbetjeve; c) kur grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk është teknikisht i realizueshëm duke konsideruar	E plotë	Neni 12 (2) i projektligjit përmban përjashtimet e parashikuara nga neni 10 (3) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

	mbetjeve dhe zhvillimet e tjera në menaxhimin e mbetjeve.			praktikat më të mira të grumbullimit të mbetjeve; ç) kur grumbullimi i diferencuar shkakton kosto ekonomike jo proporcionale, që llogariten duke konsideruar këto elemente: i) kostot e ndikimit negativ në mjedis dhe në shëndet që shkaktohen nga grumbullimi dhe trajtimi i pa diferencuar i mbetjeve; ii) potencialin e rritjes së efiçencës së grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve; iii) të ardhurat nga shitja e lëndëve të para dytësore si dhe iv) zbatimin e parimit ndotësi paguan dhe të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.		
10 (4)	4. Shtetet Anëtare do të marrin masa për të siguruar që mbetjet që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin në përputhje me Nenin 11(1) dhe Nenin 22 të mos incinerohen, me përjashtim të mbetjeve që rezultojnë nga operacionet e mëvonshme të trajtimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, për të cilat incinerimi ofron rezultatin më të mirë mjedisor në përputhje me Nenin 4.	*Projektligji*	*37 (3)*	*Neni 37* **Incinerimi i mbetjeve** 3. Nuk pranohen për incinerim, mbetjet që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar për qëllim të përgatitjes për ripërdorim dhe riciklim, me përjashtim të mbetjeve që krijohen nga operacionet e mëtejshme të trajtimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar për të cilat operacioni i incenerimit përbën rezultatin më të mirë mjedisor.	E plotë	Neni 37 (4) i projektligjit përmban ndalimin e incinerimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar të parashikuara nga neni 10 (4) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
10 (5)	5. Kur është e nevojshme për të përmbushur parashikimet e paragrafit 1 të këtij Neni dhe për të lehtësuar ose përmirësuar rikuperimin, Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme, para ose gjatë rikuperimit, për të hequr substancat, përzierjet dhe komponentët e rrezikshëm nga mbetjet e rrezikshme me qëllim trajtimin e tyre në përputhje me Nenet 4 dhe 13.	*Projektligji*	*12 (1) (b)*	Neni 12 **Rikuperimi i mbetjeve** 1. Për kryerjen e operacioneve të përgatitjes për ripërdorim, të riciklimit dhe të rikuperimeve të tjera të mbetjeve në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me parimet e këtij ligji, mbetjet: b) e rrezikshme, substancat, përzierjet apo përbërësit e rrezikshëm, eliminohen përpara apo gjatë rikuperimit, me qëllim	E plotë	Parashikimi i nenit 10 (5) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve pasqyrohet në nenin 12 (1) (b) të projektligjit.

				trajtimin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji.		
10 (6)	6. Deri më 31 Dhjetor 2021, Shtetet Anëtare do të dorëzojnë një raport në Komision mbi zbatimin e këtij Neni në lidhje me mbetjet bashkiake dhe mbetjet bio, përfshirë mbi mbulimin material dhe territorial të grumbullimit të diferencuar dhe çdo përjashtim sipas paragrafit 3.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni11 ***Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masa për të promovuar aktivitetet e përgatitjes për ripërdorim, veçanërisht duke inkurajuar krijimin dhe mbështetjen e rrjeteve të përgatitjes për ripërdorim dhe riparim, duke lehtësuar, kur është e përputhshme me menaxhimin e duhur të mbetjeve, aksesin e tyre në mbetjet e mbajtura nga skemat e grumbullimit ose impiantet, që mund të përgatiten për ripërdorim, por që nuk janë të destinuara për përgatitje për ripërdorim nga këto skema ose impiante, dhe duke promovuar përdorimin e instrumentave ekonomikë, kriteret e prokurimit, objektivat sasiorë ose masa të tjera.	*Projektligji*	*11 (1)*	*Neni 11* **Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve** 1. Masat për nxitjen e përgatitjes për ripërdorim të mbetjeve përcaktohen strategjinë kombëtare, planin sektorial, zonal ose vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve, sipas parashikimeve të kreut V të këtij ligji dhe përfshijnë: a) masa për ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve të ripërdorimit dhe të riparimit; b) masa që u lehtësojnë rrjeteve të ripërdorimit dhe të riparimit akses tek mbetjet që përgatiten për ripërdorim, të grumbulluara nga persona fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e grumbullimit të mbetjeve; c) masa që promovojnë përdorimin e instrumenteve ekonomikë; ç) kritere specifike në procedurat e prokurimit publik; d) përmbushja e objektivave sasiorë; dh) masa që inkurajojnë zbatimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit; e) masa të tjera të përshtatshme për realizimin e këtij qëllimi;	E plotë	Projektligji përmban të gjitha parimet dhe masat e parashikuara nga neni 11 i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve dhe përcakton se ato do të përfshihen në strategjinë kombëtare, planin sektoria, planet zonale dhe venodre të parashikuara në Kreun V të projektligjit.
11 (1) Paragrafi 2	Shtetet Anëtare do të marrin masa për të promovuar riciklimin e cilësisë së lartë dhe, për këtë qëllim, në përputhje me Nenin 10(2) dhe (3), do të bëjnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.	*Projektligji*	*12 (1) (a),* *11 (2)*	*Neni 12* **Rikuperimi i mbetjeve** 1. Për kryerjen e operacioneve të përgatitjes për ripërdorim, të	E pjesshme	Pavarësisht se dispozitat e projektligjit e përmendin disa herë se mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, ky detyrim nuk hyn në

				riciklimit dhe të rikuperimeve të tjera të mbetjeve në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me parimet e këtij ligji, mbetjet: a) grumbullohen në mënyrë të diferencuar, sipas nenit 11 të këtij ligji dhe nuk përzihen me mbetje apo materiale të tjera që janë të ndryshme në përbërje, përveçse në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni *Neni 11* **Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve** 2. Për të nxitur riciklimin me cilësi të lartë mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore miraton kriteret, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve.		fuqi me miratimin e ligjit, por me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave që do të vendosë mes të tjerash afatin kur nis detyrimi. Shtyrja e afatit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, që ishte vendosur të niste në vitin 2018, për një kohë të pacaktuar nuk është në përputhje me nenin 10(2) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, me hierarkinë e mbetjeve, me kërkesën e riciklimit cilësor si dhe me konceptin e ekonomisë qarkulluese.
11 (1) *Paragrafi 3*	Në përputhje me Nenin 10(2) dhe (3), Shtetet Anëtare do të bëjnë grumbullim të diferencuar të paktën për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin, dhe deri më 1 Janar 2025, për tekstilet.	*Projektligji*	*11 (2)*	*Neni 11* **Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve** 2. Për të nxitur riciklimin me cilësi të lartë mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore miraton kriteret, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve.	E pjesshme	Afatet e nisjes së grumbullimit të diferencuar për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin, janë hequr nga teksti i projektligjit dhe janë parashikuar të miratohen me VKM, bashkë me afatet e grumbullimit të diferencuar për rrymat e tjera të mbetjeve. Shtyrja e afatit të grumbullimit të diferencuar të letrës, plastikës, metalit dhe qelqit, që ishte vendosur të niste në vitin 2018, e dobëson politikën e riciklimit dhe ripërdorimit dhe zbatimin e hierarkisë së mbetjeve duke e ulur nivelin e harmonizimi të politikave shqiptare të menaxhimit të mbetjeve me ato të BE-së.
11 (1) *Paragrafi 4*	Shtetet Anëtare do të marrin masa për të promovuar shembjen selektive në mënyrë që të mundësojnë heqjen dhe trajtimin e sigurt të substancave të rrezikshme dhe të lehtësojnë ripërdorimin dhe	-	-	-	E papërputhur	Projektligji nuk parashikon miratimin e masave të përcaktuara në nenin 11 (1) paragrafit 4 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve

	riciklimin e cilësisë së lartë përmes heqjes selektive të materialeve, dhe për të siguruar krijimin e sistemeve të ndarjes për mbetjet nga ndërtimi dhe shembja, të paktën për drurin, fraksionet e mineraleve (beton, tulla, pllaka dhe qeramikë, gurë), metalin, qelqin, plastikën dhe gipsin.					në lidhje me mbetjet nga ndërtimi dhe shembja.
11 (2)	2. Për të përmbushur objektivat e kësaj Direktive dhe për të kaluar drejt një ekonomie evropiane qarkulluese me një nivel të lartë të efikasitetit të burimeve, Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme të projektuara për të arritur objektivat e mëposhtëm: (a) deri në vitin 2020, përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i materialeve të mbetjeve si, të paktën për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin nga shtëpitë dhe mundësisht nga burime të tjera për sa kohë që këto rryma mbetjesh janë të ngjashme me mbetjet shtëpiake, do të rritet në një minimum prej 50 % të peshës; (b) deri në vitin 2020, përgatitja për ripërdorim, riciklimi dhe rikuperimi i materialeve të tjera, duke përfshirë operacionet e rimbushjes që përdorin mbetje për të zëvendësuar materiale të tjera, të mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja që nuk janë të rrezikshme, përjashtuar materialet që gjenden natyrshëm të përcaktuara në kategorinë 17 05 04 në listën e mbetjeve, do të rritet në një minimum prej 70 % të peshës; (c) deri në vitin 2025, përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve bashkiake do të rritet në një minimum prej 55 % të peshës; (d) deri në vitin 2030, përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve bashkiake do të rritet në një minimum prej 60 % të peshës; (e) deri në vitin 2035, përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve bashkiake do të rritet në një minimum prej 65 % të peshës.	*Projektligji*	13 (1)	**Neni 13** **Objektivat dhe metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve** 1. Objektivat e përgatitjes së mbetjeve për ripërdorim, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera të rrymave të mbetjeve, përcaktohen në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, që miratohet sipas parashikimeve të nenit 62 të këtij ligji	E pjesshme	Projektligji parashikon se objektivat e përgatitjes për ripërdorim dhe riciklimit të mbetjeve bashkiake të parashikuara nga direktiva do të përcaktohen në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Pas miratimit të kësaj strategjie duhet rivlerësuar niveli i përputhshmërisë me nenin 11 (2) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
11 (3)	3. Një Shtet Anëtar mund të shtyjë afatet për arritjen e objektivave të përmendur në pikë (c), (d) dhe (e) të paragrafit 2 deri në pesë vjet me kusht që ky Shtet Anëtar: (a) të ketë përgatitur për ripërdorim dhe ricikluar më pak se 20 % ose të ketë asgjësuar në lendfill më shumë se 60 % të mbetjeve bashkiake të krijuara në vitin 2013 siç është raportuar në Pyetësorin e Përbashkët të OECD dhe Eurostat; dhe	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	(b) të njoftojë Komisionin për qëllimin e tij për të shtyrë afatin përkatës dhe të dorëzojë një plan zbatimi në përputhje me Shtojcën IVb, jo më vonë se 24 muaj përpara afatit përkatës të përcaktuar në pikat (c), (d) ose (e) të paragrafit 2.					
11 (4)	4. Brenda tre muajve nga marrja e planit të zbatimit të dorëzuar në përputhje me pikën (b) të paragrafit 3, Komisioni mund të kërkojë nga një Shtet Anëtar të rishikojë atë plan nëse Komisioni konsideron që plani nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën IVb. Shteti Anëtar përkatës duhet të dorëzojë një plan të rishikuar brenda tre muajve nga marrja e kërkesës së Komisionit.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
11 (5)	5. Në rastin e shtyrjes së arritjes së objektivave në përputhje me paragrafin 3, Shteti Anëtar përkatës duhet të marrë masat e nevojshme për të rritur përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin e mbetjeve bashkiake: (a) në një minimum prej 50 % deri në vitin 2025 në rastin e shtyrjes së afatit për arritjen e objektivit të përmendur në pikën (c) të paragrafit 2; (b) në një minimum prej 55 % deri në vitin 2030 në rastin e shtyrjes së afatit për arritjen e objektivit të përmendur në pikën (d) të paragrafit 2; (c) në një minimum prej 60 % deri në vitin 2035 në rastin e shtyrjes së afatit për arritjen e objektivit të përmendur në pikën (e) të paragrafit 2.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
11 (6)	6. Deri më 31 Dhjetor 2024, Komisioni do të shqyrtojë përcaktimin e objektivave për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja dhe fraksioneve specifike të materialeve të tyre, mbetjeve tekstile, mbetjeve tregtare, mbetjeve industriale jo të rrezikshme dhe rrymave të tjera të mbetjeve, si dhe objektivave për përgatitjen për ripërdorim të mbetjeve bashkiake dhe objektivave për riciklimin e mbetjeve bashkiake bio. Për këtë qëllim, Komisioni do të dorëzojë një raport në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, shoqëruar, nëse është e përshtatshme, me një propozim ligjor.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
11 (7)	7. Deri më 31 Dhjetor 2028, Komisioni do të rishikojë objektivin e përcaktuar në pikën (e) të paragrafit 2. Për këtë qëllim, Komisioni do të dorëzojë një raport në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, shoqëruar, nëse është e përshtatshme, me një propozim ligjor. Komisioni do të vlerësojë teknologjinë e bashkë-trajtimit që lejon përfshirjen e mineraleve në procesin	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	e bashkëincinerimit të mbetjeve bashkiake. Kur të gjendet një metodologji e besueshme, si pjesë e këtij rishikimi, Komisioni do të shqyrtojë nëse këto minerale mund të llogariten në objektivat e riciklimit.					
Neni 11a ***Rregullat për llogaritjen e arritjes së objektivave*** *(1)*	1. Për qëllim të llogaritjes nëse objektivat e përcaktuara në pikat (c), (d) dhe (e) të Nenit 11(2) dhe të Nenit 11(3) janë arritur: (a) Shtetet Anëtare do të llogarisin peshën e mbetjeve bashkiake të krijuara dhe të përgatitura për ripërdorim ose të ricikluara në një vit kalendarik të caktuar; (b) Pesha e mbetjeve bashkiake të përgatitura për ripërdorim do të llogaritet si peshë e produkteve ose komponentëve të produkteve që janë kthyer në mbetje bashkiake dhe që kanë kaluar të gjitha kontrollet, pastrimet ose operacionet e nevojshme të riparimit për të mundësuar ripërdorimin pa nevojë për ndarje ose përpunim të mëtejshëm; (c) Pesha e mbetjeve bashkiake të ricikluara do të llogaritet si pesha e mbetjeve që, pasi ka kaluar të gjitha kontrollet, ndarjet dhe operacionet paraprake të nevojshme për të hequr materialet e mbetjeve që nuk janë të synuara për përpunim të mëtejshëm dhe për të siguruar riciklim me cilësi të lartë, hyn në operacionin e riciklimit ku materialet e mbetjeve riprocesohen në produkte, materiale ose substanca.	*Projektligji*	*13 (2)*	**Neni 13** **Objektivat dhe metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve** 2. Metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave, viti në të cilin fillon detyrimi për përmbushjen e objektivave si dhe afatet e ndërmjetme përcaktohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në: a) situatën faktike të NJQV-ve; b) analizën e sasive totale të mbetjeve bashkiake; c) aftësinë teknologjike për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim; d) metodologjinë e përmbushjes së objektivave. e) peshën e mbetjeve bashkiake të krijuara dhe të përgatitura për ripërdorim ose të ricikluara në një vit të caktuar kalendarik që llogaritet si më poshtë: i. pesha e mbetjeve bashkiake të përgatitura për ripërdorim llogaritet si pesha e produkteve ose përbërësve të produkteve që janë kthyer në mbetje bashkiake dhe i janë nënshtruar të gjitha operacioneve të nevojshme të kontrollit,	E plotë	Neni 13 (2) i projekt ligjit anë parashikon se metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave do të miratohet me vendim të këshillit të ministrave, megjithatë përfshin në gërmën (e) të gjitha kriteret e parashikuara nga neni 11a (1) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

				pastrimit ose riparimit për të mundësuar ripërdorimin pa iu nënshtruar ndarjes apo përpunimit paraprak të mëtejshëm; ii. pesha e mbetjeve bashkiake të ricikluara llogaritet si pesha e mbetjeve të cilat, pasi i janë nënshtruar të gjitha kontrolleve, ndarjes dhe operacioneve të tjera paraprake të nevojshme për të hequr materialet e mbetjeve që nuk trajtohen në proceset e mëvonshme të ripërpunimit dhe që garantojnë riciklimin me cilësi të lartë, u nënshtrohen operacioneve të riciklimit ku mbetjet ripërpunohen për të përftuar produkte, materiale apo substanca		
11a (2)	2. Për qëllimet e pikës (c) të paragrafit 1, pesha e mbetjeve bashkiake të ricikluara do të matet kur mbetjet hyjnë në operacionin e riciklimit. Në përjashtim nga nënparagrafi i parë, pesha e mbetjeve bashkiake të ricikluara mund të matet në daljen e çdo operacioni ndarjeje, me kusht që: (a) kjo mbetje e dalë të riciklohet më pas; (b) pesha e materialeve ose substancave që hiqen nga operacione të mëtejshme që paraprijnë operacionin e riciklimit dhe që nuk riciklohen më pas, nuk do të përfshihet në peshën e mbetjeve të raportuara si të ricikluara.	-	-	-	E papërputhur	Derisa të miratohet VKMja me metodologjinë e llogaritjes së përmbushjes së objektivave, kjo dispozitë e Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve është e papërputhur.
11a (3)	3. Shtetet Anëtare do të krijojnë një sistem efektiv të kontrollit të cilësisë dhe të gjurmimit të mbetjeve bashkiake për të siguruar që kushtet e përcaktuara në pikën (c) të paragrafit 1 të këtij Neni dhe në paragrafin 2 të këtij Neni të përmbushen. Për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të mbledhura mbi mbetjet e ricikluara, sistemi mund të përfshijë regjistra elektronikë të krijuar në përputhje me Nenin 35(4), specifikime teknike për kërkesat e cilësisë së mbetjeve të ndara, ose norma mesatare të humbjeve për mbetjet e ndara për lloje të ndryshme të mbetjeve dhe praktikat e menaxhimit të mbetjeve përkatësisht. Normat mesatare të humbjeve do të përdoren vetëm në raste kur të dhëna të besueshme nuk mund të merren ndryshe dhe do të llogariten mbi	*Projektligji*	*70 (1),(4), (5), (6), 71*	**Neni 70** **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave** 1. Çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve si veprimtari profesionale, përfshirë krijuesit e mbetjeve të rrezikshme, subjektet që grumbullojnë ose transportojnë mbetje të rrezikshme, ose veprojnë si tregtarë dhe agjentë të mbetjeve të rrezikshme ruajnë në mënyrë kronologjike:	E papërputhur	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka dy nene që rregullojnë mbajtjen e të dhënave. Në asnjë nga nenet nuk parashikohet element më vete mbledhja e të dhënave mbi mbetjet bashkiake të ricikluara. Nuk ekziston ndonjë mekanizëm që parashikon kontrollin e cilësisë të mbetjeve bashkiake.

	bazën e rregullave të llogaritjes të përcaktuara në aktin delegues të miratuar në përputhje me paragrafin 10 të këtij Neni.			a) të dhëna mbi sasinë, llojin dhe origjinën e mbetjeve, si dhe sasinë e produkteve dhe materialeve që rezultojnë nga përgatitja për ripërdorim, riciklim ose operacione të tjera të rikuperimit; b) sipas rastit, destinacionin, shpeshtësinë e grumbullimit, mënyrën e transportit dhe metodën e trajtimit të parashikuar sipas llojit të mbetjeve. 4. AKM krijon regjistrin elektronik për të mbajtur të dhënat e mbetjeve sipas pikës 1 të këtij neni, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Personat e parashikuar në paragrafin 2 më sipër raportojnë çdo 6 muaj të dhënat e mbetjeve në regjistrin elektronik. 5. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes, çdo 6 muaj, dokumentacionin që vërteton se operacionet e menaxhimit të mbetjeve janë kryer. 6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kriteret minimale për operimin e regjistrave elektronikë, referuar në pikën 4 të këtij neni. **Neni 71** **Të dhënat dhe raportimet** 1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson të dhënat e raportuara për krijimin, trajtimin, ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e		

				mbetjeve nga personat fizikë dhe juridikë që pajisen me leje apo licencë për ushtrimin e veprimtarisë. 2. AKEM mban dhe përditëson të dhënat për sasinë e mbetjeve bashkiake të krijuara brenda territorit të bashkive dhe ja përcjell ato AKM-së çdo vit. 3. Të gjitha bizneset që operojnë në territorin e bashkisë dhe krijojnë, përpunojnë, grumbullojnë apo trajtojnë mbetje, raportojnë çdo vit në bashki, sipas rrymave specifike të mbetjeve dhe në bazë të legjislacionit përkatës për këto rryma mbetjesh. 4. AKM harton brenda muajit mars të çdo viti raportin vjetor për vitin paraardhës, me të dhënat për mbetjet në të gjithë territorin e vendit dhe e publikon në faqen zyrtare të Agjencisë dhe i vihet në dispozicion publikut. 5. AKM dhe AKEM përpunojnë të dhënat në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".		
11a (4)	4. Për qëllimet e llogaritjes nëse objektivat e përcaktuara në pikat (c), (d) dhe (e) të Nenit 11(2) dhe në Nenit 11(3) janë arritur, sasia e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme që shkon në trajtim aerobik ose anaerobik mund të llogaritet si e ricikluar nëse ky trajtim gjeneron pleh, tretës, ose rezultat tjetër me një sasi të ngjashme të përmbajtjes së ricikluar në raport me hyrjen, që do të përdoret si produkt, material ose substancë e ricikluar. Nëse rezultati përdoret në tokë, Shtetet Anëtare mund ta llogarisin atë si të ricikluar vetëm nëse ky përdorim rezulton në përfitime për bujqësinë ose në përmirësim ekologjik. Nga 1 janari 2027, Shtetet Anëtare mund të llogarisin mbetjet bashkiake bio që hyjnë në trajtim aerobik ose anaerobik si të ricikluara vetëm nëse, në përputhje me	-	-	-	E papërputhur	Metodologjia teknike e përllogaritjes do të miratohet me akte nën ligjore. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet ribërë pas miratimit të këtyre akteve.

	Nenin 22, ato janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar ose janë ndarë në burim.					
11a (5)	5. Për qëllimet e llogaritjes nëse objektivat e përcaktuara në pikat (c), (d) dhe (e) të Nenit 11(2) dhe në Nenin 11(3) janë arritur, sasia e materialeve të mbetjeve që kanë pushuar së qeni mbetje si rezultat i një operacioni përgatitor para se të riprocesohet, mund të llogaritet si e ricikluar me kusht që këto materiale të jenë të destinuara për riprocesim të mëtejshëm në produkte, materiale ose substanca për t'u përdorur për qëllimet fillestare ose të tjera. Megjithatë, materialet që kanë pushuar së qeni mbetje për t'u përdorur si karburante ose mjete të tjera për të krijuar energji, ose për t'u incineruar, përdorur si rimbushje ose asgjësuar në lendfille, nuk do të llogariten për arritjen e objektivave të riciklimit.	-	-	-	E papërputhur	Metodologjia teknike e përllogaritjes do të miratohet me akte nën ligjore. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet ribërë pas miratimit të këtyre akteve.
11a (6)	6. Për qëllimet e llogaritjes nëse objektivat e përcaktuara në pikat (c), (d) dhe (e) të Nenit 11(2) dhe në Nenin 11(3) janë arritur, Shtetet Anëtare mund të marrin parasysh riciklimin e metaleve të ndara pas incinerimit të mbetjeve bashkiake me kusht që metalet e ricikluara të përmbushin disa kritere cilësie të përcaktuara në aktin e zbatimit të miratuar në përputhje me paragrafin 9 të këtij Neni.	-	-	-	E papërputhur	Metodologjia teknike e përllogaritjes do të miratohet me akte nën ligjore. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet ribërë pas miratimit të këtyre akteve.
11a (7)	7. Mbetjet e dërguara në një Shtet Anëtar tjetër për qëllime të përgatitjes për ripërdorim,të riciklimit ose të rimbushjes në atë Shtet Anëtar tjetër mund të llogariten për arritjen e objektivave të përcaktuara në Nenin 11(2) dhe (3) vetëm nga Shteti Anëtar në të cilin janë grumbulluar ato mbetje.	-	-	-	E papërputhur	Metodologjia teknike e përllogaritjes do të miratohet me akte nën ligjore. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet ribërë pas miratimit të këtyre akteve.
11a (8)	8. Mbetjet e eksportuara nga Bashkimi Evropian për përgatitjen për ripërdorim ose riciklim do të llogariten për arritjen e objektivave të përcaktuara në Nenin 11(2) dhe (3) të kësaj Direktive nga Shteti Anëtar në të cilin janë grumbulluar vetëm nëse plotësohen kërkesat e paragrafit 3 të këtij Neni dhe nëse, në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1013/2006, eksportuesi mund të provojë se dërgesa e mbetjeve i përmbahet kërkesave të asaj Rregulloreje dhe që trajtimi i mbetjeve jashtë Bashkimit Evropian është kryer në kushte që janë përgjithësisht të barabarta me kërkesat e ligjit mjedisor të Bashkimit Evropian.	-	-	-	E papërputhur	Metodologjia teknike e përllogaritjes do të miratohet me akte nën ligjore. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet ribërë pas miratimit të këtyre akteve.
11a (9)	9. Për të siguruar kushte të barabarta për aplikimin e këtij Neni, Komisioni do të miratojë deri më 31 mars 2019 akte zbatimi që do të përcaktojnë rregulla për	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	llogaritjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave, veçanërisht sa i përket: (a) një metodologjie të përbashkët për llogaritjen e peshës së metaleve që janë ricikluar në përputhje me paragrafin 6, duke përfshirë kritere cilësie për metalet e ricikluara, dhe (b) mbetjeve bio të ndara dhe të ricikluara në burim. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 39(2).					
11a (10)	10. Deri më 31 mars 2019, Komisioni do të miratojë një akt delegues në përputhje me Nenin 38a për të plotësuar këtë Direktivë duke përcaktuar rregulla për llogaritjen, verifikimin dhe raportimin e peshës së materialeve ose substancave që janë hequr pas një operacioni ndarjeje dhe që nuk riciklohen më pas, duke u bazuar në normat mesatare të humbjeve për mbetjet e ndara.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni11b ***Raporti i paralajmërimit të hershëm***	1. Komisioni, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Mjedisit, do të përgatisë raporte mbi progresin drejt arritjes së objektivave të përcaktuara në pikat (c), (d) dhe (e) të Nenit 11(2) dhe në Nenin 11(3) jo më vonë se tre vjet para çdo afati të përcaktuar aty.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
11b (2)	2. Raportet e përmendura në paragrafin 1 do të përfshijnë: (a) një vlerësim të arritjes së objektivave nga çdo Shtet Anëtar; (b) një listë të Shteteve Anëtare që rrezikojnë të mos arrijnë objektivat brenda afateve përkatëse, të shoqëruar me rekomandime të përshtatshme për Shtetet Anëtare në fjalë; (c) shembuj të praktikave më të mira që përdoren në të gjithë Bashkimin dhe që mund të ofrojnë udhëzime për progresin drejt arritjes së objektivave.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 12 ***Asgjësimi*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që, kur rikuperimi në përputhje me Nenin 10 (1) nuk ndërmerret, mbetjet të kalojnë në operacione të sigurta të asgjësimit që plotësojnë dispozitat e Nenit 13 për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.	*Projektligji*	*14 (1)*	**Neni 14** **Asgjësimi i mbetjeve** Mbetjet që nuk i nënshtrohen rikuperimit sipas nenit 12 të këtij ligji, i nënshtrohen operacioneve të sigurta të asgjësimit, në përputhje me parimet e nenit 5 të këtij ligji, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.	E plotë	Dispozita e projektligjit përputhet me parashikimin e nenit 12 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

12 (2)	2. Deri më 31 dhjetor 2024, Komisioni do të kryejë një vlerësim të operacioneve të asgjësimit të listuara në Shtojcën I, veçanërisht në lidhje me Nenin 13, dhe do të paraqesë një raport për Parlamentin Evropian dhe për Këshillin, të shoqëruar, nëse është e nevojshme, me një propozim ligjor, me qëllim rregullimin e operacioneve të asgjësimit, përfshirë nëpërmjet kufizimeve të mundshme, dhe për të konsideruar një objektiv të reduktimit të asgjësimit, për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm mjedisor të mbetjeve.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 13 ***Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit***	Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që menaxhimi i mbetjeve të realizohet pa rrezikuar shëndetin e njeriut, pa dëmtuar mjedisin dhe, në veçanti: (a) pa rrezik për ujërat, ajrin, tokën, bimët ose kafshët; (b) pa shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose aromave; (c) pa ndikuar negativisht në peisazhin ose vendet me interes të veçantë.	*Projektligji*	*5 (4)*	Neni 5 **Parime të përgjithshme** 4. Institucionet dhe subjektet përgjegjëse marrin masat e nevojshme që mbetjet të menaxhohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin, duke garantuar që të mos vihen në rrezik ujërat, ajri, toka, përfshirë tokat bujqësore, bimët ose kafshët dhe të mos shkaktohen shqetësime përmes zhurmës ose erës së pakëndshme, të mos ndikohen negativisht zonat rurale ose zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë.	E plotë	Parimet e përgjithshme të projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve pasqyrojnë me përpikmëri parimet e nenit 13 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
Neni 14 ***Kostot***	1. Në përputhje me parimin "ndotësi paguan", kostot e menaxhimit të mbetjeve, përfshirë për infrastrukturën e nevojshme dhe operimin e saj, do të mbulohen nga krijuesi fillestar i mbetjeve ose nga zotëruesit aktualë ose të mëparshëm të mbetjeve.	*Projektligji*	*27 (1)*	*Neni 27* **Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve** 1. Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke përfshirë kostot e infrastrukturës dhe operimit të saj, mbulohen nga krijuesi ose nga zotëruesi i mbetjeve në përputhje me parimin "Ndotësi paguan".	E plotë	Parimet e mbulimit të kostove të projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve pasqyrojnë me përpikmëri parimet e mbulimit të kostove të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
14 (2)	2. Pa cënuar Nenin 8 dhe 8a, Shtetet Anëtare mund të vendosin që kostot e menaxhimit të mbetjeve të mbulohen pjesërisht ose plotësisht nga prodhuesi i produktit nga i cili janë krijuar mbetjet dhe që distributorët e këtij produkti mund të ndajnë këto kosto.	*Projektligji*	*17, 27 (2)*	**Neni 17** **Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese** **1.** Subjekti prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që	E pjesshme	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve në parim parashikon se prodhuesi i produkteve ngarkohet me përgjegjësinë e menaxhimit të mbetjeve që rrjedhin nga produktet e tij. Gjithsesi elementet konkrete se si do të funksionojë kjo skemë përcaktohen

				gjenerojnë mbetje pas përdorimit përfshihet në skemën e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese. 2. Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese, rregullohet me ligj të posaçëm. *Neni 27* **Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve** 2. Kostot për menaxhimin e integruar të mbetjeve që krijohen nga produktet që i nënshtrohen skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, mbulohen në përputhje me parashikimit e ligjit të posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të subjekteve prodhuese.		në ligjin e posaçëm mbi përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit dhe në aktet nën ligjore që do të miratohen në zbatim. Në tabelën e përputhshmëris **s**ë plotësuar në kuadër të ligjit për PZP parashikohet se përputhshmëria e ligjit me Acquis e BE është e pjesshme. Gjithashtu vihet re një mospërputhje mes terminologjisë së përdorur nga direktiva 'prodhuesi i produktit' dhe terminologjisë së përdorur nga projekligji 'subjekti prodhues'.
Neni 15 ***Përgjegjësia për menaxhimin e mbetjeve*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që çdo prodhues fillestar i mbetjeve ose zotërues tjetër të realizojë trajtimin e mbetjeve vetë ose trajtimi të kryhet nga një agjent ose një subjekt ose ndërmarrje që kryen operacione të trajtimit të mbetjeve ose të organizohet nga një grumbullues privat ose publik i mbetjeve në përputhje me Nenet 4 dhe 13.	*Projektligji*	*16 (1)*	Neni 16 **Përgjegjësia e krijuesit ose zotëruesit të mbetjeve** 1. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve është përgjegjës për realizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të krijuara dhe/ose të zotëruara prej tij, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe lejet e mjedisit, si dhe me legjislacionin e posaçëm që rregullon rrymat e caktuara te mbetjeve. Në zbatim të këtij detyrimi, krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve sigurohet që mbetjet e krijuara apo të zotëruara prej tij t'i nënshtrohen operacioneve të menaxhimit të integruar të mbetjeve në një nga mënyrat e mëposhtme:	E plotë	Sipas projektligjit krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve është përgjegjës për realizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve të krijuara apo të zotëruara prejt tij dhe ligji i ka vënë në dispozicion disa opsione për realizimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parashikimet e nenit 15 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

				a) duke kryer menaxhimin e integruar të mbetjeve; b) duke realizuar menaxhimin e integruar të mbetjeve nëpërmjet një agjenti apo tregtari të licencuar sipas legjislacionit në fuqi; c) duke transferuar apo dorëzuar mbetjet tek personat që kryejnë trajtimin e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi; ç) duke i transferuar apo dorëzuar mbetjet tek sistemi i grumbullimit të mbetjeve të ngritur nga bashkia përkatëse. d) duke i transferuar apo dorëzuar mbetjet tek një sistem grumbullimi i ngritur dhe administruar nga operatorë privatë brenda territorit ku ndodhen mbetjet dhe vepron në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.		
15 (2)	2. Kur mbetjet transferohen nga krijuesi ose zotëruesi fillestar te një nga personat fizikë ose juridikë të përmendur në paragrafin 1 për trajtim paraprak, si rregull i përgjithshëm, nuk lirohet nga përgjegjësia për realizimin e një operacioni të plotë të rikuperimit ose të asgjësimit. Pa cënuar Rregulloren (KE) Nr. 1013/2006, Shtetet Anëtare mund të specifikojnë kushtet e përgjegjësisë dhe të vendosin në cilat raste prodhuesi fillestar duhet të mbajë përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit ose në cilat raste përgjegjësia e krijuesit dhe zotëruesit mund të ndahet ose delegohet ndërmjet aktorëve të zinxhirit të trajtimit.	*Projektligji*	*16 (2)*	*Neni 16* **Përgjegjësia e krijuesit ose zotëruesit të mbetjeve** 2. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve, që dorëzon apo transferon mbetjet tek një agjent ose tregtar, nuk çlirohet nga përgjegjësia për kryerjen e plotë të operacioneve të rikuperimit ose asgjësimit të mbetjeve. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve, që dorëzon apo transferon mbetjet tek sistemi i grumbullimit të mbetjeve i ngritur sipas parashikimeve të këtij ligji ose tek një person fizik ose juridik që kryen trajtimin e mbetjeve, çlirohet nga përgjegjësia për kryerjen e plotë të operacioneve të rikuperimit ose asgjësimit të mbetjeve, kur pajiset me	E plotë	Neni 15 (2) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve parashikon si rregull që krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve nuk çlirohet nga përgjegjësia për kryerjen e trajtimit ose asgjësimit përfundimtar të mbetjeve vetëm në raste se i transferon ato tek një person tjetër që kryen trajtimin paraprak. Të njëjtën linjë ndjek edhe neni 16 i projektligjit.

				dokumentacionin e përshtatshëm ligjor sipas rastit.		
15 (3)	3. Shtetet Anëtare mund të vendosin, në përputhje me Nenin 8, që përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të mbetjeve të mbulohet pjesërisht ose plotësisht nga prodhuesi i produktit nga i cili janë krijuar mbetjet dhe që distributorët e këtij produkti mund të ndajnë këtë përgjegjësi.	*Projektligji*	*17*	**Neni 17** **Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese** 1. Subjekti prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit përfshihet në sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese. 2. Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese, rregullohet me ligj të posaçëm.	E pjesshme	Projekt ligji i mbetjeve e parashikon përgjegjësinë e prodhuesit të produktit për menaxhimin e mbetjeve të produkteve të prodhuara prej tyre. Gjithsesi, skema konkrete se si do të funksionojë, cilat produkte përfshihen dhe si do të ndahet përgjegjësia rregullohet me legjislacion të posaçëm. Vlerësimi i përputhshmërisë kryhet bazuar në ligjin e posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit që është në proces miratimi. Vihet re një mospërputhje mes terminologjisë së përdorur nga direktiva 'prodhuesi i produktit' dhe terminologjisë së përdorur nga projekligji 'subjekti prodhues'.
15 (4)	4. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që, brenda territorit të tyre, subjektet ose ndërmarrjet që grumbullojnë ose transportojnë mbetje në bazë profesionale t'i dorëzojnë mbetjet e grumbulluara dhe të transportuara në impiante të përshtatshme për trajtimin që respektojnë dispozitat e Nenit 13.	*Projektligji*	*19*	**Neni 19** **Përgjegjësia e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve** Personat fizikë dhe juridikë, të licencuar, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje, kanë përgjegjësinë të dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impiante trajtimi të përshtatshme, që i përmbushin kërkesat e këtij ligji dhe që shoqërohen me dokumentacionin e dorëzimit apo të transferimit sipas kërkesave të këtij ligji ose legjislacionit të posaçëm.	E plotë	Edhe projekt ligji, njësoj si neni 15 (5) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve parashikon që grumbulluesit dhe transportuesit e mbetjeve kanë detyrimin të dorëzojnë mbetjet në impiante të përshtatshme trajtimi që përmbushin kërkesat ligjore.
Neni 16 **Parimet e vetë-mjaftueshmërisë dhe afërsisë** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e përshtatshme, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare të tjera kur është e nevojshme ose e kështillueshme, për të ngritur një rrjet të integruar dhe të përshtatshëm të impianteve të asgjësimit të mbetjeve dhe të impianteve për rikuperimin e mbetjeve të përziera që grumbullohen nga familjet, duke përfshirë kur grumbullimi i tillë	*Projektligji*	*30*	**Neni 30** **Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve** 1. Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve përbëhet nga të gjitha impiantet e mbetjeve, përfshirë impiantet për	E plotë	Neni 16 (1) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve përcakton ngritjen e një rrjeti të integruar dhe të përshtatshëm instalimesh për asgjësimin dhe rikuperimin e mbetjeve bashkiake të përziera, brenda një shteti anëtar apo në bashkëpunim mes disa shtetetsh që integrojnë rrjetet e tyre kur kjo

	mbulon gjithashtu mbetje nga prodhues të tjerë, duke marrë parasysh teknikat më të mira të disponueshme.			rikuperimin dhe impiantet për asgjësimin e mbetjeve dhe impiantet mbështëtese. Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve ngrihet në përputhje me planin kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve, në nivel ndërvendor, brenda territorit të zonave të menaxhimit të mbetjeve, duke mbajtur në konsideratë: a) rrethanat gjeografike dhe nevojat për instalimin e impianteve të specializuara për disa lloje mbetjesh;. b) teknikat më të mira të disponueshme;. c) parashikimet e nenit 25 të këtij ligji. 2. Rrjeti i integruar i impianteve udhëhiqet nga parimi i afërsisë dhe vendndodhja e impianteve të jetë e përshtatshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga bashkitë që ndodhen brenda zonës së menaxhimit të mbetjeve, si dhe nga parimi i vetëqëndrueshmërisë që garanton aftësinë e Republikës së Shqipërisë të kryejë vetë operacionet e rikuperimit dhe asgjësimit të mbetjeve të territorit të saj.		është e nevojshme apo e këshillueshme. Edhe projektligji shqiptar, në linjë me politikën e BE-së, parashikon ngritjen e një rrjeti të integruar impiantesh për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve brenda territorit të Shqipërisë në zbatim të teknikave më të mira të disponueshme.
16 (1) Paragrafi 2	Në përjashtim nga Rregullorja (KE) Nr. 1013/2006, Shtetet Anëtare mund të kufizojnë, për të mbrojtur rrjetin e tyre, dërgesat hyrëse të mbetjeve të destinuara për inceneratorë që janë të klasifikuar si rikuperime, nëse është e provuar se këto dërgesa do të rezultonin në nevojën për të asgjësuar mbetjet kombëtare ose për të trajtuar mbetje në një mënyrë që nuk është në përputhje me planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve. Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin për çdo vendim të tillë. Shtetet Anëtare gjithashtu mund të	*Projektligji*	*72*	Neni 72 **Importi i mbetjeve** 1. Ndalohet në të gjitha rastet importi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë. 2. Ndalohet në të gjitha rastet kalimi transit ndërkufitar i	E plotë	Projekt ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve ndalon importin e të gjitha mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë qëllimi mbrojtës i nenit 16 (1) paragrafi 2 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, përmbushet plotësisht.

	kufizojnë dërgesat dalëse të mbetjeve për arsye mjedisore siç është përcaktuar në Rregulloren (KE) Nr. 1013/2006.			mbetjeve të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë.		
16 (2)	2. Rrjeti do të projektohet për të mundësuar që Bashkimi si një tërësi të bëhet i vetë-mjaftueshëm në asgjësimin e mbetjeve si dhe në rikuperimin e mbetjeve të përmendura në paragrafin 1, dhe për të mundësuar që Shtetet Anëtare të përparojnë drejt këtij qëllimi individualisht, duke marrë parasysh rrethanat gjeografike ose nevojën për impiante të specializuara për lloje të caktuara mbetjesh.	*Projektligji*	*30*	**Neni 30** **Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve** 1. Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve përbëhet nga të gjitha impiantet e mbetjeve, përfshirë impiantet për rikuperimin dhe impiantet për asgjësimin e mbetjeve dhe impiantet mbështëtese. Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve ngrihet në përputhje me planin kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve, në nivel ndërvendor, brenda territorit të zonave të menaxhimit të mbetjeve, duke mbajtur në konsideratë: a) rrethanat gjeografike dhe nevojat për instalimin e impianteve të specializuara për disa lloje mbetjesh;. b) teknikat më të mira të disponueshme;. c) parashikimet e nenit 25 të këtij ligji. 2. Rrjeti i integruar i impianteve udhëhiqet nga parimi i afërsisë dhe vendndodhja e impianteve të jetë e përshtatshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga bashkitë që ndodhen brenda zonës së menaxhimit të mbetjeve, si dhe nga parimi i vetëqëndrueshmërisë që garanton aftësinë e Republikës së Shqipërisë të kryejë vetë operacionet e rikuperimit dhe asgjësimit të mbetjeve të territorit të saj.	E plotë	Neni 16 (2) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve parashikon si parim që BE-ja në tërësi, por edhe shtetet anëtare individualisht duhet të synojnë ngritjen e një rrjeti të integruar instalimesh për asgjësimin dhe rikuperimin e mbetjeve që të jetë i vetëmjaftueshëm dhe të marrë parasysh kushtet gjeografike dhe nevojën për instalime të specializuara për rryma të posaçme mbetjesh. Projekt ligji shqiptar, në të njëjtën linjë me direktivën përcakton se për ngritjen e rrjetit mbahen parasysh kriteret gjeografike dhe nevojat e posaçme për instalime të specializuara. Të njëjtat parime parashikohen edhe në nenin 30 të projektligjit.

16 (3)	3. Rrjeti do të mundësojë që mbetjet të asgjësohen ose mbetjet e përmendura në paragrafin 1 të rikuperohen në një nga impiantet më të afërta dhe të përshtatshme, duke përdorur metodat dhe teknologjitë më të përshtatshme, për të siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje për mjedisin dhe shëndetin publik.	*Projektligji*	*25, 46*	**Neni 25** **Zonat e menaxhimit të mbetjeve** Territori i Republikës së Shqipërisë organizohet në zona për menaxhimin e mbetjeve. Për kualifikimin e një territori si zonë e menaxhimit të mbetjeve, konsiderohen të gjitha kriteret e mëposhtme: a) në zonën e menaxhimit të mbetjeve krijohen impiantet kryesore për trajtimin e mbetjeve ose planifikohet ngritja e tyre; b) në zonën e menaxhimit të mbetjeve ekziston infrastruktura mbështetëse e trajtimit të mbetjeve ose planifikohet ngritja e saj; c) vendndodhja dhe shtrirja e zonës së menaxhimit të mbetjeve në mënyrë që të mbulojë një territor ne mënyrë sa me eficente; ç) aksesueshmëria e territorit të mbuluar nga zona e menaxhimit të mbetjeve të jetë ne përputhje me kushtet teknike të infrastrukturës rrugore; d) numri i popullsisë; dh) sasitë e mbetjeve të krijuara në territorin e mbuluar nga zona e menaxhimit të mbetjeve; 2. Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe janë pjesë e Planit Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta. **Neni 46** **Normat teknike minimale**	E plotë	Shqipëria është ndarë në zona të menaxhimit të mbetjeve, brenda të cilave planifikohet të ngrihen impiantet kryesore të trajtimit të mbetjeve në mënyrë që të krijohet rrjeti i integruar. Synimi është që secila zonë e menaxhimit të mbetjeve të ketë aftësinë të trjatojë mbetjet e veta. Përsa i përket trajtimit të mbetjeve në përputhje me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, dhe me teknologjitë më të përshtatshme, ky është parim i përgjithshëm i zbatueshëm për të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve që parashikohet në nenin 5 të projektligjit dhe gjithashtu rregullohet edhe në nenin 46 të projektligjit.

				Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloret që përcaktojnë normat teknike minimale për të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve të parashikuara në këtë ligj, dukë përfshirë këtu edhe transportin, grumbullimin, operacionet e trajtimit, tregtimin dhe ndërmjetësimin. 2. Normat teknike minimale, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni: a) rregullojnë ndikimet kryesore në mjedis të shkaktuara nga impiantet e trajtimit të mbetjeve; b) sigurojnë që mbetjet të trajtohen në përputhje me këtë ligj dhe në veçanti me nenin 5 të tij; c) marrin në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme për kryerjen e veprimtarive; ç) në rast së është e përshtatshme, përfshijnë elemente që lidhen me cilësinë e trajtimit dhe kërkesat e procesit.		
16 (4)	4. Parimet e afërsisë dhe vetë-mjaftueshmërisë nuk do të thonë që çdo Shtet Anëtar duhet të ketë një gamë të plotë të impianteve të rikuperimit përfundimtar brenda atij Shteti Anëtar.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 17 ***Kontrolli i mbetjeve të rrezikshme***	Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që krijimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të rrezikshme, si dhe ruajtja dhe trajtimi i tyre, të kryhen në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut në përputhje me dispozitat e Nenit 13, duke përfshirë veprimet për të siguruar gjurmueshmërinë nga prodhimi deri në destinacionin përfundimtar dhe kontrollin e mbetjeve të rrezikshme për të përmbushur kërkesat e Neneve 35 dhe 36.	*Projektligji*	*5 (2), (4) ,* *40*	Neni 5 **Parime të përgjithshme** 2. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet duke respektuar: a) Parimet e mbrojtjes, ruajtjes, dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e mjedisit; b) Parimet e ekonomisë qarkulluese, që i konsideron mbetjet si burim	E plotë	Në linjë me parashikimet e Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve edhe projekt ligji shqiptar përcakton që menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme kryhet duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Analiza e përputhshmërisë me nenet 35 dhe 36 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, bëhet më poshtë tek nenet përkatëse.

				c) Parimet e barazisë dhe mos diskriminimit, përfshirë barazinë gjinore, si dhe ndikimin e përgjithshëm ekonomik dhe social ç) Parimin "ndotësi paguan" sipas parashikimit në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit d) hierarkinë e mbetjeve. 4. Institucionet dhe subjektet përgjegjëse marrin masat e nevojshme që mbetjet të menaxhohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin, duke garantuar që të mos vihen në rrezik ujërat, ajri, toka, përfshirë tokat bujqësore, bimët ose kafshët dhe të mos shkaktohen shqetësime përmes zhurmës ose erës së pakëndshme, të mos ndikohen negativisht zonat rurale ose zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë. Neni 40 **Menaxhimi i integruar i mbetjeve të rrezikshme** 1. Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut. 2. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit miraton masat që sigurojnë gjurmueshmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, si dhe kontrollin e te dhënave mbetjeve të rrezikshme, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.		

				3. Personat që ushtrojnë veprimtari në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve të rrezikshme të pajisen me një leje mjedisi, që përcakton kushtet që duhen përmbushur për të siguruar zbatimin e pikës 1 të këtij neni. Leja për ndikimin në mjedis përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe lëshohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar dhe/ose licencën me kodin III.2.B. për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, nëse do të kryejnë edhe transportin ose vetem transportin.		
Neni 18 **Ndalimi i përzierjes së mbetjeve të rrezikshme** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që mbetjet e rrezikshme të mos përzihen, qoftë me kategori të tjera të mbetjeve të rrezikshme, qoftë me mbetje, substanca ose materiale të tjera. Përzierja përfshin edhe hollimin e substancave të rrezikshme.	*Projektligji*	*41 (1)*	Neni 41 **Ndalimi i përzierjes së mbetjeve të rrezikshme** 1. Ndalohet përzierja e mbetjeve të rrezikshme me lloje të tjera mbetjesh të rrezikshme ose me mbetje, substanca apo materiale të tjera, përveç rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Koncepti i përzierjes përfshin edhe hollimin e substancave të rrezikshme	E plotë	Dispozita e projekt ligjit pasqyron në mënyrë të plotë ndalimin e Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
18 (2) *(a), (b), (c)*	2. Në përjashtim nga paragrafi 1, Shtetet Anëtare mund të lejojnë përzierjen me kusht që: (a) operacioni i përzierjes të kryhet nga një subjekt ose ndërmarrje që ka marrë një leje në përputhje me Nenin 23; (b) të respektohen dispozitat e Nenit 13 dhe ndikimi negativ i menaxhimit të mbetjeve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin të mos rritet; dhe (c) operacioni i përzierjes të bëhet konform teknikave më të mira të disponueshme.	*Projektligji*	*41 (2), (3)*	Neni 41 **Ndalimi i përzierjes së mbetjeve të rrezikshme** 2. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në pikën 1 më sipër, lejohet përzierja e mbetjeve të rrezikshme vetëm kur kryhet nga një person fizik ose juridik që zotëron lejen e mjedisit për përzierjen e mbetjeve të rrezikshme, që lëshohet kur	E plotë	Përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm, të parashikuara nga neni i projektligjit janë në përputhje të plotë me kushtet e përjashtimit të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Analiza e përputhshmërisë së nenit 23 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve bëhet në nenin përkatës më poshtë.

				plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: a) përzierja kryhet në përputhje me parimet e nenit 5 të këtij ligji dhe nuk rrit ndikimin negativ në mjedis dhe në shëndetin e njeriut; b) operacioni i përzierjes kryhet në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme 3. Lejet për veprimtaritë e përcaktuara në këtë dispozitë miratohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshihen në kategorinë III.1 të shtojcës së tij dhe ligjit nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit".		
18 (3)	3. Kur mbetjet e rrezikshme janë përzierë në mënyrë të paligjshme në shkelje të këtij Neni, Shtetet Anëtare do të sigurojnë, pa cënuar Nenin 36, që ndarja të kryhet kur është teknikisht e mundur dhe e nevojshme për të përmbushur Nenin 13.	*Projektligji*	*41 (4)*	Neni 41 **Ndalimi i përzierjes së mbetjeve të rrezikshme** 4. Kur mbetjet e rrezikshme, janë përzier në mënyrë të paligjshme në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, zbatohen masat e parashikuara në nenet 77 dhe 78 të këtij ligji. Përveç zbatimit të masave të neneve 77 dhe 78, subjektet shkelëse kanë detyrimin të kryejnë me shpenzimet e tyre ndarjen e mbetjeve të rrezikshme të përziera, nëse një gjë e tillë është teknikisht e mundur dhe e nevojshme për të plotësuar kërkesat e nenit 5 të këtij ligji.	E plotë	Projektligji parashikon të njëjtat detyrime për subjektet shkelëse, si Direktiva 2008/98/EC e mbetjeve.
18 (3) *Paragrafi 2*	Kur ndarja nuk kërkohet sipas nënparagrafit të parë të këtij neni, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që mbetjet e përziera të trajtohen në një impiant që ka marrë një leje në përputhje me Nenin 23 për të trajtuar një përzierje të tillë.	*Projektligji*	41 (5)	Neni 41 **Ndalimi i përzierjes së mbetjeve të rrezikshme** 5. Kur ndarja e mbetjeve të rrezikshme të përziera nuk është teknikisht e mundur dhe e nevojshme për plotësimin e	E plotë	Projektligji shqiptar e parashikon gjithashtu këtë mundësi të përcaktuar nga neni 18 (3), paragrafi 2 i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve.

				kërkesave të nenit 5, atëherë përzierja duhet të trajtohet në një impiant i cili është pajisur me lejen përkatëse		
Neni 19 ***Etiketimi i mbetjeve të rrezikshme*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që, gjatë grumbullimit, transportit dhe ruajtjes së përkohshme, mbetjet e rrezikshme të jenë të ambalazhuara dhe të etiketuara në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit në fuqi.	*Projektligji*	*42*	Neni 42 **Etiketimi i mbetjeve të rrezikshme** 1. Mbetjet e rrezikshme grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në mënyrë të përkohshme vetëm kur ato janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me rregullat dhe standardet për ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve të rrezikshme 2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat dhe standardet për ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve të rrezikshme gjatë procesit të grumbullimit, transportit dhe magazinimit të përkohshëm	E plotë	Projektligji shqiptar, njësoj si Direktiva 2008/98/EC e mbetjeve, parashikon se ambalazhimi dhe etiketimi i mbetjeve të rrezikshme duhet të kryhet në përputhje me rregulla dhe standarde të posaçme. Përputhshmëria e rregullave dhe standardeve shqiptare për ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve të rrezikshme me standardet e BE-së, vlerësohet në tabelat e përputhshmërisë të akteve përkatëse të BE-së.
19 (2)	2. Sa herë që mbetjet e rrezikshme transferohen brenda një Shteti Anëtar, ato duhet të shoqërohen me një dokument identifikimi, i cili mund të jetë në format elektronik, që përmban të dhënat përkatëse të specifikuara në Shtojcën IB të Rregullores (KE) Nr. 1013/2006.	*Projektligji*	*45 (1), (2), (7)*	Neni 45 **Dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme** 1. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike. 2. Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm: a) numrin e dokumentit të dorëzimit; b) emrin, adresën, e-mailin, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të personit të kontaktit të dorëzuesit;	E pjeshme	Në nenin 45 (2) të projekt ligjit përcaktohen elementet minimale të dokumentetit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme. Këto elemente përfshijnë një pjesë të të dhënave të parashikuara në Aneksin IB të Rregullores (KE) Nr. 1013/2006 siç kërkohet nga neni 19 (2) i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve. Me miratimin e formularit të dorëzimit nga Këshilli i Ministrave, mund të shqyrtohet sërisht nëse përputhshmëria e kësaj dispozite mbetet e pjesshme apo bëhet e plotë.

				c) emrin, adresën, e-mailin, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të personit të kontaktit të transportuesit; ç) emrin, adresën, e-mailin, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme dhe të marrësit në dorëzim; d) emrin, adresën, e-mailin, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme kontakti të krijuesit të mbetjeve; dh) përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve, sasitë respektive, datën e dorëzimit, llojin e paketimit etj.; e) informacione për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimet e tyre. ë) çdo informacion tjetër të nevojshëm në lidhje me origjinën e mbetjeve të rrezikshme, dorëzimin, destinacionin e mbetjeve të rrezikshme dhe operacionet e trajtimit 7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni përfshirë formularin e dokumentacionit të dorëzimit.		
Neni 20 ***Mbetjet e rrezikshme të krijuara nga shtëpitë***	1. Nga 1 Janari 2025, Shtetet Anëtare do të bëjnë grumbullimin e diferencuar për fraksionet e mbetjeve të rrezikshme të prodhuara nga shtëpitë për të siguruar që ato trajtohen në përputhje me Nenet 4 dhe 13 dhe që nuk ndotin rrymat e tjera të mbetjeve bashkiake.	*Projektligji*	*43 (1)*	Neni 43 **Mbetjet e rrezikshme shtëpiake** 1. Mbetjet e rrezikshme shtëpiake grumbullohen në mënyrë të diferencuar në mënyrë që të mos ndotin rrymat e tjera të mbetjeve bashkiake dhe të trajtohen në	E pjesshme	Edhe projekt ligji shqiptar parashikon në parim që mbetjet e rrezikshme shtëpiake grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Megjithatë afati nga kur nis ky detyrim nuk përcaktohet nga ligji por vendoset të përcaktohet nga aktet nënligjore.

(1)				përputhje me nenin 5 të këtij ligji, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore.		Përputhshmëria e kësaj dispozite duhet të vlerësohet edhe njëherë pas hyrjes në fuqi të akteve nën ligjore që vendosin afatet përkatëse.
20 (2)	2. Nenet 17, 18, 19 dhe 35 nuk do të aplikohen për mbetjet e përziera të krijuara nga shtëpitë.	*Projektligji*	*43 (2)*	Neni 43 **Mbetjet e rrezikshme shtëpiake** 2. Nenet 40, 41, 42 dhe 70 të këtij ligji nuk zbatohen për mbetjet e përziera të krijuara nga sektori familjar	E plotë	Përjashtimet e parashikuara nga projektligji janë të njëjta me përjashtimet e parashikuara nga neni 20 (2) i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve. Përputhshmëria me nenin 35 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve analizohet më poshtë.
20 (3)	3. Nenet 19 dhe 35 nuk do të aplikohen për fraksionet e ndara të mbetjeve të rrezikshme të krijuara nga shtëpitë deri sa ato të pranohen për grumbullim, asgjësim ose rikuperim nga një subjekt ose ndërmarrje që ka marrë një leje ose është regjistruar në përputhje me Nenin 23 ose 26.	*Projektligji*	*43 (3)*	Neni 43 **Mbetjet e rrezikshme shtëpiake** 3. Nenet 42 dhe 70 të këtij ligji nuk zbatohen ndaj pjesëve të ndara të mbetjeve të rrezikshme shtëpiake derisa nuk janë pranuar për grumbullim, asgjësim ose rikuperim nga një person që zotëron lejen përkatëse ose që është regjistruar në përputhje me nenin 67 të këtij ligji.	E plotë	Përjashtimet e parashikuara nga projektligji janë të njëjta me përjashtimet e parashikuara nga neni 20 (3) i Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve. Përputhshmëria me nenet 23 dhe 26 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve analizohet tek nenet përkatëse më poshtë.
20 (4)	4. Nga 5 Janari 2020, Komisioni do të përgatisë udhëzime për të ndihmuar dhe lehtësuar Shtetet Anëtare në grumbullimin e diferencuar të fraksioneve të mbetjeve të rrezikshme të krijuara nga shtëpitë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 21 ***Vajrat e përdorura*** *(1)*	1. Pa cënuar detyrimet lidhur me menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të përcaktuara në Nenet 18 dhe 19, Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që: (a) vajrat e përdorura të grumbullohen në mënyrë të diferencuar, përveçse në rastet kur grumbullimi i diferencuar nuk është teknologjikisht i mundur duke marrë parasysh praktikat e mira; (b) vajrat e përdorura trajtohen, duke i dhënë përparësi rigjenerimit ose në mënyrë alternative operacioneve të tjera të rikuperimit që ofrojnë një rezultat mjedisor të barabartë ose më të mirë se rigjenerimi, në përputhje me Nenet 4 dhe 13; (c) vajrat e përdorura me karakteristika të ndryshme nuk përzihen dhe vajrat e përdorura nuk përzihen me lloje të tjera mbetjesh ose substancash, nëse një përzierje e tillë pengon rigjenerimin e tyre ose një	*Projektligji*	*47 (1), (2), (3), (6)*	Neni 47 **Vajrat e përdorura** 1. Vajrat e përdorura grumbullohen në mënyrë të diferencuar, përveçse kur një gjë e tillë nuk është teknikisht e mundur duke pasur parasysh praktikat më të mira. 2. Vajrat e përdorura trajtohen duke i dhënë prioritet rigjenerimit ose operacioneve të tjera të riciklimit, të cilat kanë rezultat të barabartë ose më të mirë për mjedisin sesa rigjenerimi. 3. Vajrat e përdorura që kanë karakteristika të ndryshme nuk përzihen me njëra -tjetrën dhe as me lloje të tjera mbetjesh apo	E plotë	Projektligji është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 21 (1) të Direktivës 2008/98/KE së mbetjeve.

	operacion tjetër rikuperimi që ofron një rezultat mjedisor të barabartë ose më të mirë se rigjenerimi.			substancash, nëse kjo përzierje pengon rigjenerimin apo operacione të tjera të riciklimit, të cilat kanë rezultat të barabartë ose më të mirë për mjedisin sesa rigjenerimi. 6. Kjo dispozitë nuk cenon detyrimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të parashikuara në këtë ligj.		
21 (2)	2. Për qëllim të grumbullimit të diferencuar të vajrave të përdorura dhe trajtimit të duhur të tyre, Shtetet Anëtare mund të aplikojnë, sipas kushteve të tyre kombëtare, masa shtesë të tilla si kërkesa teknike, përgjegjësia e prodhuesit, instrumente ekonomike ose marrëveshje vullnetare.	*Projektligji*	*47 (5)*	Neni 47 **Vajrat e përdorura** 5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura. Në këto rregulla përfshihen masa të tilla si kërkesat teknike, instrumentet ekonomikë dhe marrëveshjet vullnetare.	E plotë	Neni 21 (2) i Direktivës 2008/98/KE së mbetjeve u jep shteteve anetare diskrecionin të miratojnë disa rregulla shtesë për vajrat e përdorura, por dispozita nuk është detyruese. Në këto kushte fakti që projektligji në parim e parashikon këtë mundësi, pavarësisht miratimit të aktit nën ligjor, përbën përputhje të plotë me parashikimin e Direktivës.
21 (3)	3. Nëse vajrat e përdorura, sipas legjislacionit kombëtar, janë subjekt i kërkesave për rigjenerim, Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë që këto vajra të përdorura të rigjenerohen nëse është teknologjikisht e mundur dhe, kur aplikohen nenet 11 ose 12 të Rregullores (KE) Nr. 1013/2006, të kufizojnë dërgesat ndërkufitare të vajrave të përdorura nga territori i tyre në impiantet e incinerimit ose të bashkëincinerimit për ti dhënë përparësi rigjenerimit të vajrave të përdorura.	-	-	-	-	Neni 21 (3) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve parashikon këto masa diskrecioniale, por jo detyruese. Projektligji nuk e parashikon këtë rregullim por kjo nuk përbën mospërputhje.
21 (4)	4. Nga 31 Dhjetori 2022, Komisioni do të shqyrtojë të dhënat mbi vajrat e përdorura të dhëna nga Shtetet Anëtare në përputhje me Nenin 37(4) me qëllim që të shqyrtojë mundësinë e miratimit të masave për trajtimin e vajrave të përdorura, duke përfshirë objektivat sasiorë për rigjenerimin e vajrave të përdorura dhe çdo masë tjetër për të promovuar rigjenerimin e vajrave të përdorura. Për këtë qëllim, Komisioni do të paraqesë një raport në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, i shoqëruar, nëse është e përshtatshme, nga një propozim ligjor.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Neni 22 ***Mbetjet bio*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që, deri më 31 Dhjetor 2023 dhe në përputhje me Nenet 10(2) dhe (3), mbetjet bio të ndahen dhe të riciklohen në burim, ose të grumbullohen në mënyrë të diferencuar dhe të mos përzihen me lloje të tjera mbetjesh.	*Projektligji*	*11 (2)* *48 (1)*	Neni 48 **Mbetjet bio** 1. Bashkitë, marrin masat që në territorin nën juridiksionin e tyre mbetjet bio ndahen dhe riciklohen në burim, ose grumbullohen në mënyrë të diferencuar dhe nuk përzihen me lloje të tjera mbetjesh. Neni 11 **Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve** 2. Për të nxitur riciklimin me cilësi të lartë mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore miraton kriteret, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve.	E pjesshme	Edhe projektligji shqiptar e parashikon në parim grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio. Në pamje të parë, duke lexuar nenin 48 (1) të projekt ligjit, duket sikur detyrimi është i menjëhershëm. Por nga interpretimi organik i ligjit, pra interpretimi i përbashkët i neneve 21 dhe 48 të projektligjit, tregon se edhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve bio do të nis në një afat të papërcaktuar, pas miratimit të aktit nënligjor përkatës. Si rrjedhojë, përputhshmëria me nenin 22 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve është e pjesshme për shkak të afatit. **Analiza e përputhshmërisë duhet të bëhet sërisht pas miratimit të afatit me aktin nënligjor përkatës.**
22 (1) *Paragrafi 2*	Shtetet Anëtare mund të lejojnë që mbetjet me veti të ngjashme të biodegradueshmërisë dhe të kompostueshmërisë që përputhen me standardet përkatëse evropiane ose çdo standard kombëtar ekuivalent për ambalazhet që mund të rikuperohen përmes kompostimit dhe biodegradimit, të grumbullohen së bashku me mbetjet bio.	*Projektligji*	*48 (3)*	Neni 48 **Mbetjet bio** 3. Mbetjet bio mund të grumbullohen së bashku me mbetje të cilat kanë përbërje të ngjashme të biodegradimit dhe kompostimit, që plotësojnë standardet për ambalazhet e biodegradueshme nëpërmjet kompostimit dhe biodegradimit	E plotë	Neni i projektligjit përmban të njëjtin parashikim me nenin 22 (1) paragrafi 2 të Direktivës 2008/98/KE. Vlerësimi nëse standardet shqiptare për ambalazhet e biodegradueshme janë në përputhje me standardet e BE-së, bëhet në tabelën e përputhshmërisë përkatëse.
22 (2)	2. Shtetet Anëtare do të marrin masa në përputhje me Nenet 4 dhe 13, për të: (a) inkurajuar riciklimin, duke përfshirë kompostimin dhe tretjen e mbetjeve bio në një mënyrë që mundëson një nivel të lartë mbrojtjeje mjedisore dhe rezulton në një produkt të cilësisë së lartë; (b) inkurajuar kompostimin në shtëpi; dhe (c) promovuar përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio.	*Projektligji*	*48 (4)*	Neni 48 **Mbetjet bio** 4. Ministria, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe sipas rastit institucione të tjera, përdorin të gjithë instrumentet ekonomikë dhe masat e tjera brenda kompetencave të tyre, në mënyrë që: a) të nxisin riciklimin, përfshirë kompostimin dhe tretjen e	E plotë	Neni i projektligjit përmban të njëjtin parashikim me nenin 22 (2) të Direktivës 2008/98/KE.

				mbetjeve bio në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit si edhe në produkte të cilat plotësojnë standardet e cilësisë së lartë të përshtatshme sipas përdorimit; b) të inkurajojnë kompostimin në shtëpi, veçanërisht në zonat rurale; c) të promovojnë përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio që janë të sigurta për mjedisin.		
22 (3)	3. Nga 31 Dhjetori 2018, Komisioni do të kërkojë nga organizatat evropiane të standardizimit të zhvillojnë standarde evropiane për mbetjet bio që hyjnë në proceset e riciklimit organik, për kompostin dhe për tretësin, të bazuara në praktikat më të mira të disponueshme.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 23 ***Issue of permits***	1. Shtetet Anëtare do të kërkojnë që çdo subjekt ose ndërmarrje që ka për qëllim të kryejë trajtimin e mbetjeve të marrë një leje nga autoriteti kompetent. Këto leje duhet të specifikojnë së paku sa vijon: (a) llojet dhe sasitë e mbetjeve që mund të trajtohen; (b) për çdo lloj operacioni të lejuar, kërkesat teknike dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje me vendin përkatës; (c) masat e sigurisë dhe kujdesit që duhet të ndërmerren; (d) metoda që do të përdoret për çdo lloj operacioni; (e) operacionet e monitorimit dhe kontrollit që mund të jenë të nevojshme; (f) dispozitat për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes që mund të jenë të nevojshme.	Projektligj	67 (1), (2), (3)	Neni 67 **Lejet e mjedisit për operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve** 1. Personat fizikë a juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për menaxhimin e integruar të mbetjeve, pajisen me leje mjedisi në përputhje me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit". 2. Kërkesa për lejen e mjedisit përmban të paktën informacionet e mëposhtme: a) adresën e biznesit, adresën e zyrave qendrore dhe numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT); b) vendndodhjen e impiantit të trajtimit të mbetjeve; c) llojin, kodin, sasinë dhe origjinën e mbetjeve që do të trajtohen;	E plotë	Neni i projektligjit përmban të njëjtin parashikim me nenin 23 të Direktivës 2008/98/KE.

				ç) operacionet e trajtimit të mbetjeve për të cilat kërkohet leja e mjedisit dhe kodet përkatëse; d) metodat dhe teknologjinë që përdoren; dh) impiantet dhe instalimet që përdoren, si dhe kapacitetet e tyre; e) masat e sigurisë dhe masat parandaluese. 3. Lejet e mjedisit që lëshohen për kryerjen e operacioneve të parashikuara në këtë ligj, përveç kërkesave të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, përfshijnë edhe elementet e mëposhtme: a) vendndodhjen e impiantit të trajtimit të mbetjeve; b) llojin, kodin, sasinë dhe origjinën e mbetjeve që do të trajtohen; c) operacionet e trajtimit të mbetjeve; ç) për çdo lloj operacioni që përfshihet në leje, kërkesat teknike dhe kërkesat që lidhen me vendndodhjen në fjalë; d) metodat dhe teknologjinë që përdoren; dh) masat e sigurisë dhe masat parandaluese; e) metodologjinë e veprimtarisë që përdoret për çdo operacion;		

				ë) operacionet e nevojshme të monitorimit dhe të kontrollit; f) dispozitat për mbylljen dhe kujdesin e mëtejshëm, sipas rastit.		
23 (2)	2. Lejet mund të lëshohen për një periudhë të caktuar dhe mund të rinovohen.	*Legjislacioni sektorial*	-	-	– E plotë	Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve nuk përmban një nen të tillë pasi kjo çështje rregullohet nga ligji për lejet mjedisit që është në përputhje të plotë me këtë aspekt të direktivës.
23 (3)	3. Kur autoriteti kompetent konsideron se metoda e synuar e trajtimit është e papranueshme nga pikëpamja e mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht kur metoda nuk është në përputhje me Nenin 13, ai do të refuzojë lëshimin e lejes.	*Legjislacioni sektorial*	*67 (5)*	Neni 67 **Lejet e mjedisit për operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve** 5.Kushtet e lejes së mjedisit duhet të garantojnë që metodologjia e trajtimit të mbetjeve nuk është e papranueshme nga pikëpamja e mbrojtjes së mjedisit dhe se kjo metodologji nuk cënon parimet e nenit 5 të këtij ligji	E plote	Neni i projektligjit përmban të njëjtin parashikim me nenin 23 (3) të Direktivës 2008/98/KE.
23 (4)	4.Çdo leje që mbulon incinerimin ose bashkëincinerimin me rikuperimin e energjisë do të ketë kushtin që rikuperimi i energjisë të bëhet me një nivel të lartë të efikasitetit të energjisë.	*Projektligji*	*67 (4)*	Neni 67 **Lejet e mjedisit për operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve** 4.Leja e mjedisit për incinerimin ose bashkincinerimin e mbetjeve, që shoqërohet me rikuperim energjie, përmban kushtin që rikuperimi i energjisë të kryhet me efiçencë të lartë të energjisë.	E plote	Neni i projektligjit përmban të njëjtin parashikim me nenin 23 (4) të Direktivës 2008/98/KE.

23 (5)	5. Nëse përmbushen kërkesat e këtij Neni, çdo leje e lëshuar në përputhje me legjislacionin tjetër kombëtar ose të Bashkimit Evropian mund të kombinohet me lejen e kërkuar sipas paragrafit 1 për të krijuar një leje të vetme, ku një format i tillë shmang duplikimin e informacionit dhe përsëritjen e punës nga operatori ose autoriteti kompetent.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 24 ***Përjashtimet nga kërkesat e lejeve***	Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë nga kërkesa e përcaktuar në Nenin 23(1) subjektet ose ndërmarrjet për operacionet e mëposhtme: (a) asgjësimin e mbetjeve të tyre jo të rrezikshme në vendin e krijimit; ose (b) rikuperimin e mbetjeve.	-	-	-	-	Porjektiligji nuk parashikon përjashtimet e nenit 24 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Megjithatë këto përjashtime nuk janë detyruese, por diskrecionale për shtetet, prandaj kjo nuk mund të konsiderohet një mospërputhje.
Neni 25 ***Kushtet për përjashtimet***	1. Kur një Shtet Anëtar dëshiron të lejojë përjashtime, siç parashikohet në Nenin 24, ai do të përcaktojë, në lidhje me çdo lloj aktiviteti, rregulla të përgjithshme që specifikojnë llojet dhe sasitë e mbetjeve që mund të mbulohen nga përjashtimi dhe metodën e trajtimit që do të përdoret. Këto rregulla do të përcaktohen për të siguruar që mbetjet të trajtohen në përputhje me Nenin 13. Në rastin e operacioneve të asgjësimit të përmendura në pikën (a) të Nenit 24, këto rregulla duhet të marrin parasysh teknikat më të mira të disponueshme.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
25 (2)	2. Përveç rregullave të përgjithshme të parashikuara në paragrafin 1, Shtetet Anëtare do të përcaktojnë kushte specifike për përjashtimet që lidhen me mbetjet e rrezikshme, duke përfshirë llojet e aktiviteteve, si dhe çdo kërkesë tjetër të nevojshme për kryerjen e formave të ndryshme të rikuperimit dhe, kur është e nevojshme, vlerat kufi për përmbajtjen e substancave të rrezikshme në mbetje si dhe vlerat kufi të emetimeve.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
25 (3)	3. Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin për rregullat e përgjithshme të përcaktuara në përputhje me paragrafët 1 dhe 2.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Neni 26 ***Regjistrimi***	Kur të mëposhtmet nuk janë subjekt i kërkesave të lejeve, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që autoriteti kompetent të mbajë një regjistër të: (a) subjekteve ose ndërmarrjeve që grumbullojnë ose transportojnë mbetje në bazë profesionale;	*Legjislacion sektorial*	-	Neni 68 **Licencimi i veprimtarive për menaxhimin e integruar të mbetjeve** 2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B.	E plotë	Sipas projektligjit grumbulluesit dhe transportuesit e mbetjeve i nënshtrohen licencimit si rrjedhojë janë të regjistruar pranë autoriteteve kompetente. Personat qe kryejne riciklim, perpunim, ruajtje, asgjesim, i nenshtrohen edhe licencimit edhe lejeve mjedisore.
26 (b)	(b) agjentëve ose tregtarëve; dhe	*Projektligji*	*68 (1)*	Neni 68 **Licencimi i veprimtarive për menaxhimin e integruar të mbetjeve** 2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B.	E plotë	Sipas projektligjit agjentët dhe tregtarët e mbetjeve i nënshtrohen licencimit si rrjedhojë janë të regjistruar pranë autoriteteve kompetente.
26 (c)	(c) subjekteve ose ndërmarrjeve që janë subjekt i përjashtimeve nga kërkesat e lejeve në përputhje me Nenin 24. Kur është e mundur, regjistrat ekzistues që mbahen nga autoriteti kompetent do të përdoren për të siguruar informacionin përkatës për këtë proces regjistrimi për të reduktuar ngarkesën administrative.	N/A	N/A	N/A	N/A	Kjo dispozitë nuk zbatohet për shkak të mos zbatimit të nenit 24 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, siç u tha më sipër.
Neni 27 ***Standardet minimale***	1. Komisioni do të miratojë akte të deleguara në përputhje me Nenin 38a për të plotësuar këtë Direktivë duke përcaktuar standarde teknike	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

(1)	minimale për aktivitetet e trajtimit, duke përfshirë për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve, që kërkojnë një leje sipas Nenit 23, kur ka prova se një përfitim në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit do të arrihej nga këto standarde minimale.					
27 (2)	2. Këto standarde minimale do të mbulojnë vetëm ato aktivitete të trajtimit të mbetjeve që nuk mbulohen nga Direktiva 96/61/KE ose nuk janë të përshtatshme për mbulim nga ajo Direktivë.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
27 (3)	3. Këto standarde minimale do të: (a) drejtohen ndaj ndikimeve kryesore mjedisore të aktivitetit të trajtimit të mbetjeve; (b) sigurojnë që mbetjet të trajtohen në përputhje me Nenin 13; (c) marrin parasysh teknikat më të mira të disponueshme; dhe (d) kur është e përshtatshme, përfshijnë elementë në lidhje me cilësinë e trajtimit dhe kërkesat e procesit.	*Projektligji*	*46*	Neni 46 **Normat teknike minimale** 1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloret që përcaktojnë normat teknike minimale për të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve të parashikuara në këtë ligj, dukë përfshirë këtu edhe transportin, grumbullimin, operacionet e trajtimit, tregtimin dhe ndërmjetësimin. 2. Normat teknike minimale, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni: a) rregullojnë ndikimet kryesore në mjedis të shkaktuara nga impiantet e trajtimit të mbetjeve; b) sigurojnë që mbetjet të trajtohen në përputhje me këtë ligj dhe në veçanti me nenin 5 të tij; c) marrin në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme për kryerjen e veprimtarive; ç) në rast së është e përshtatshme, përfshijnë elemente që lidhen me cilësinë e trajtimit dhe kërkesat e procesit.	E plotë	Pavarësisht se neni 27 (3) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve u referohet standardeve teknike minimale që Komisioni do të miratojë në zbatim të direktivës, kjo dispozitë është konsideruar e dobishme edhe për legjislacionin shqiptar dhe është përfshirë në projekt ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në këtë mënyrë, i hapet rruga autorizimit ligjor për të miratuar akte nën ligjore që përmbajnë standardet teknike minimale në linjë me aktet që do të miratohen në vijim nga Komisioni.
27 (4)	4. Komisioni do të miratojë akte të deleguara në përputhje me Nenin 38a për të plotësuar këtë Direktivë duke përcaktuar standardet minimale për aktivitetet që kërkojnë regjistrim në përputhje me pikat (a) dhe (b) të Nenit 26, kur ka prova se një përfitim në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të njeriut	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

	dhe mjedisit ose në shmangien e shqetësimeve në tregun e brendshëm do të arrihej nga këto standarde minimale.					
Neni 28 **Planet për menaxhimin e mbetjeve** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që autoritetet e tyre kompetente të krijojnë, në përputhje me Nenet 1, 4, 13 dhe 16, një ose më shumë plane për menaxhimin e mbetjeve. Këto plane do të mbulojnë, vetëm ose të kombinuara, të gjithë territorin gjeografik të Shtetit Anëtar përkatës.	*Projektligji*	*62*	**Neni 62** **Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve** Ministria harton Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në vijim Strategjia Kombëtare, e cila parashikon të paktën: a) analizën e situatës aktuale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; b) organizimin dhe funksionimin e zonave të menaxhimit të mbetjeve ekzistuese, çdo planifikim në lidhje me ndryshimet e tyre si dhe përshkrimin e rrjetit të integruar të menaxhimit të mbetjeve në territorin e çdo zone të menaxhimit të mbetjeve; c) masat që duhen marrë për të përmirësuar përgatitjen për ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve pa ndikuar mbi mjedisin; ç) objektivat specifike në të gjitha fushat e menaxhimit të integruar të mbetjeve si dhe masat specifike, aktivitetet, planin e veprimit dhe afatet për përmbushjen e objektivave, në zbatim të kërkesave të këtij ligji, të legjislacionit të posaçëm dhe akteve nënligjore përkatëse 2. Shtojca 4 e këtij ligji, përmban elementet specifike detyruese që	E plotë	Sipas nenit 62 të projektligjit hartohet një strategji kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Duke qënë strategji kombëtare ajo mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kështu kërkesën e nenit 28 (1) të Direktivës 2008/98/EC të mbetjeve.

				përfshihen në Strategjinë Kombëtare dhe elementet jo detyruese që përfshihen, sipas rastit. 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton Strategjinë Kombëtare 4. Strategjia Kombëtare rishikohet dhe, në rast se është e nevojshme, përditësohet çdo pesë vjet		
28 (2)	2. Planet për menaxhimin e mbetjeve do të përshkruajnë një analizë të situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve në entitetin gjeografik përkatës, si dhe masat që do të merren për të përmirësuar përgatitjen e përshtatshme në aspektin mjedisor për ripërdorim, riciklim, rikuperim dhe asgjësimin e mbetjeve dhe një vlerësim se si plani do të mbështesë zbatimin e qëllimeve dhe dispozitave të kësaj Direktive.	*Projektligji*	*62 (1)*	**Neni 62** **Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve** Ministria harton Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në vijim Strategjia Kombëtare, e cila parashikon të paktën: a) analizën e situatës aktuale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; b) organizimin dhe funksionimin e zonave të menaxhimit të mbetjeve ekzistuese, çdo planifikim në lidhje me ndryshimet e tyre si dhe përshkrimin e rrjetit të integruar të menaxhimit të mbetjeve në territorin e çdo zone të menaxhimit të mbetjeve; c) masat që duhen marrë për të përmirësuar përgatitjen për ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve pa ndikuar mbi mjedisin; ç) objektivat specifike në të gjitha fushat e menaxhimit të integruar të mbetjeve si dhe masat specifike, aktivitetet, planin e veprimit dhe afatet për përmbushjen e objektivave, në	E plotë	Në parim projektligji ka parashikuar se Strategjia kombëtare duhet t'i përmbajë të gjitha elementet e përmendura në nenin 28 (2) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Prandaj në nivel parimor përputhja konsiderohet e plotë. Megjithatë përputhshmëria duhet të vlerësohet sërisht në mënyrë konkrete, pas miratimit të Strategjisë kombëtare.

				zbatim të kërkesave të këtij ligji, të legjislacionit të posaçëm dhe akteve nënligjore përkatëse		
28 (3)(a)	3. Planet për menaxhimin e mbetjeve do të përmbajnë, kur është e përshtatshme dhe duke marrë parasysh nivelin gjeografik dhe mbulimin e zonës së planifikimit, të paktën aspektet në vijim: (a) llojin, sasinë dhe burimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit, mbetjet që priten të dërgohen nga ose në territorin kombëtar, dhe një vlerësim të zhvillimit të rrymave të mbetjeve në të ardhmen;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (a)*	**SHTOJCA 4 STRATEGJIA KOMBËTARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE Pjesa A** 1. Strategjia Kombëtare përmban elementet e mëposhtme: a) Llojin, sasinë dhe burimin e mbetjeve të krijuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mbetjet që mund të importohen ose eksportohen dhe një vlerësim për zhvillimin e rrymave të mbetjeve në të ardhmen.	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (a) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (3)(b)	(b) impiantet kryesore ekzistuese për asgjësim dhe rikuperim, duke përfshirë çdo organizim të veçantë për vajrat e përdorura, mbetjet e rrezikshme, mbetjet që përmbajnë sasi të konsiderueshme të lëndëve të rralla kritike, ose rrymat e mbetjeve të trajtuara nga legjislacioni specifik i Bashkimit;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (b)*	b) Impiantet e mëdha ekzistuese të rikuperimit dhe asgjësimit, dhe të gjitha sistemet e posaçme për vajrat e përdorura, mbetjet e rrezikshme, mbetjet që përmbajnë sasi të konsiderueshme të materialeve të rralla ose rrymat e tjera të mbetjeve që rregullohen nga legjislacioni në fuqi dhe aktet nën ligjore përkatëse.	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (b) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (3)(c)	(c) një vlerësim të nevojës për mbylljen e impianteve ekzistuese të mbetjeve, dhe për infrastrukturën shtesë të impianteve të mbetjeve në përputhje me Nenin 16. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të kryhet një vlerësim i investimeve dhe mjeteve financiare të tjera, duke përfshirë për autoritetet vendore, të nevojshme për të përmbushur këto nevoja. Ky vlerësim do të përfshihet në planet përkatëse për menaxhimin e mbetjeve ose në dokumente të tjera strategjike që mbulojnë të gjithë territorin e Shtetit Anëtar përkatës;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (c)*	c) Vlerësimin e nevojës për mbylljen e impianteve ekzistuese të trajtimit të mbetjeve, dhe për ngritjen e infrastrukturës së re të impianteve për trajtimin e mbetjeve, në përputhje me parimet e vetëqëndrueshmërisë dhe afërsisë. Në këtë kontekst kryhet edhe vlerësimi i investimeve dhe mjeteve të tjera financiare që janë të nevojshme për realizimin e mbylljes apo ndërtimit të impianteve të trajtimit të mbetjeve, përfshirë investimet	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (c) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

				që janë të nevojshme për njësitë e qeverisjes vendore.		
28 (3)(ca)	(ca) informacion mbi masat për të arritur objektivin e parashikuar në Nenin 5(3a) të Direktivës 1999/31/KE ose në dokumente të tjera strategjike që mbulojnë të gjithë territorin e Shtetit Anëtar përkatës.	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (ç)*	ç) Objektivat e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve si dhe objektivat për reduktimin e operacioneve të asgjësimit të mbetjeve.	E pjesshme	Kërkesa e nenit 28 (3) (ca) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve kanë të bëjnë me objektivin që brenda vitit 2030 të mos pranohen në lendfille mbetjet e përashtatshme për riciklim ose rikuperim tjetër. Ky element nuk është parashikuar specifikisht si element detyrues që duhet të përmbajë Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Megjithatë përmenden në mënyrë të përgjithshme objektivat e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve si dhe objektivat e reduktimit të asgjësimit. Me miratimin e strategjisë kombëtare duhet verifikuar nëse, veçanërisht masat e marra për reduktimin e operacioneve të asgjësimit janë në përputhje me nenin 28 (3) (ca) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
28 (3)(cb)	(cb) një vlerësim të skemave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, duke përfshirë mbulimin material dhe territorial të grumbullimit të diferencuar dhe masat për përmirësimin e operimit të saj, të çdo përjashtimi të dhënë në përputhje me Nenin 10(3), dhe të nevojës për skema të reja grumbullimi;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (d)*	d) Vlerësimin e skemave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, përfshirë shtrirjen territoriale të grumbullimit të diferencuar dhe rrymat e mbetjeve për të cilat zbatohet, si dhe masat për përmirësimin e këtyre operacioneve, të gjitha përjashtimet e zbatuara sipas pikës 3 të nenit 11 të këtij ligji, si dhe vlerësimin e nevojës për ngritjen e skemave të reja të grumbullimit.	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (cb) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (3)(d)	(d) informacion të mjaftueshëm mbi kriteret e vendndodhjes për identifikimin e vendit dhe mbi kapacitetin e impianteve të ardhshme të asgjësimit ose të impianteve të mëdha të rikuperimit, nëse është e nevojshme;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (dh)*	dh) Informacion të mjaftueshëm mbi kriteret e përdorura për identifikimin e vendndodhjes së territorit/sheshit të impianteve dhe kur është e nevojshme informacion mbi kapacitetin e impianteve të asgjësimit ose impianteve të mëdha të rikuperimit që planifikohen të ngrihen në të ardhmen.	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (d) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

28 (3)(e)	(e) politika të përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë teknologjitë dhe metodat e planifikuara për menaxhimin e mbetjeve, ose politika për mbetjet që paraqesin probleme specifike në menaxhim;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (e)*	e) Politikat e përgjithshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve, përfshirë metodat dhe teknologjinë e planifikuar të përdoret për menaxhimit e integruar të mbetjeve ose politikat e menaxhimit të integruar të mbetjeve që paraqesin probleme specifike menaxhimi.	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (e) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (3)(f)	(f) masa për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e hedhjes së mbetjeve dhe për të pastruar të gjitha llojet e ndotjes;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (ë)*	ë) Masat për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e hedhjes së paligjshme të mbetjeve në mjedis dhe për të pastruar të gjitha llojet e mbetjeve të hedhura në mjedis	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (f) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (3)(g)	(g) tregues dhe objektiva të përshtatshëm cilësorë ose sasiorë, duke përfshirë mbi sasinë e mbetjeve të krijuara dhe trajtimin e saj dhe mbi mbetjet bashkiake që janë asgjësuar ose që janë subjekt i rikuperimit të energjisë.	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A Par. 1 (f)*	f) Indikatorë dhe objektiva të përshtatshëm sasiorë ose cilësorë duke përfshirë indikatorë dhe objektiva mbi sasinë e mbetjeve dhe trajtimin e tyre si dhe mbi sasinë e mbetjeve bashkiake që asgjësohen ose që janë subjekt i rikuperimit të energjisë.	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (3) (g) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element detyrues që duhet të parashikohet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (4)(a)	4. Plani për menaxhimin e mbetjeve mund të përmbajë, duke marrë parasysh nivelin gjeografik dhe mbulimin e zonës së planifikimit, aspektet në vijim: (a) aspektet organizative të lidhura me menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë një përshkrim të ndarjes së përgjegjësive midis aktorëve publikë dhe privatë që kryejnë menaxhimin e mbetjeve;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa B (a)*	**SHTOJCA 4 STRATEGJIA KOMBËTARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE** **Pjesa B** Strategjia Kombëtare mund të përmbajë: a) aspektet organizative të lidhura me menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë përshkrimin e ndarjes së përgjegjësive midis aktorëve të sektorit publik dhe atij privat që angazhohen me menaxhimin e integruar të mbetjeve;	E plotë	Neni 28 (4) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve rradhit elementet që shtetet anëtare mund të përfshijnë në planet e menaxhimit të mbetjeve, por që nuk nuk janë detyruese. Edhe Aneksi i projekligjit shqiptar, në Pjesën B të tij parashikon elementet jo detyruese që mund të përfshihen tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Kërkesa e nenit 28 (4) (a) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element që mund të përfshihet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (4)(b)	(b) një vlerësim të dobishmërisë dhe përshtatshmërisë së përdorimit të instrumenteve ekonomike dhe të tjera për të adresuar problemet e ndryshme të mbetjeve,	*Projektligji*	*Shtojca 4*	b) vlerësimin e dobishmërisë dhe përshtatshmërisë së përdorimit të instrumenteve ekonomike dhe	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (4) (b) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element që mund

	duke marrë parasysh nevojën për të ruajtur mirëfunksionimin e tregut të brendshëm;		*Pjesa B (b)*	instrumenteve të tjera për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushën e mbetjeve, duke marrë në konsideratë nevojën për funksionimin normal të tregut në territorin e Republikës së Shqipërisë;		të përfshihet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (4)(c)	(c) përdorimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe ofrimin e informacionit drejtuar publikut të përgjithshëm ose një grupi specifik konsumatorësh;	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa B (c)*	c) përdorimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe ofrimin e informacionit për publikun e gjerë ose për kategori specifike konsumatorësh;	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (4) (c) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element që mund të përfshihet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (4)(d)	(d) vendet historike të ndotura të asgjësimit të mbetjeve dhe masat për rehabilitimin e tyre.	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa B (ç)*	ç) sheshet/territoret e asgjësimit të mbetjeve, që janë historikisht të ndotura dhe masat për rehabilitimin e tyre	E plotë	Kërkesa e nenit 28 (4) (d) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, është parashikuar si element që mund të përfshihet tek Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
28 (5)	5. Planet për menaxhimin e mbetjeve duhet të përputhen me kërkesat e planifikimit të mbetjeve të përcaktuara në Nenin 14 të Direktivës 94/62/KE, me objektivat e përcaktuara në Nenin 11(2) dhe (3) të kësaj Direktive dhe me kërkesat e përcaktuara në Nenin 5 të Direktivës 1999/31/KE, dhe për qëllimet e parandalimit të hedhjes së mbetjeve, me kërkesat e përcaktuara në Nenin 13 të Direktivës 2008/56/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[7] dhe Nenin 11 të Direktives 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[8].	*Projektligji*	*Shtojca 4 Pjesa A* *Par. 2* *Par. 4* *Par. 5*	**Pjesa A** 1. Strategjia Kombëtare përmban elementet e mëposhtme: 2. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të posaçëm për menaxhimin e ambalazheve dhe mbetjeve të ambalazheve ku përcaktohen: a) masat specifike për parandalimin e krijimit të mbetjeve nga ambalazheve dhe për zvogëlimin e ndikimit në mjedis të paketimeve, përfshirë përdorimin e instrumenteve ekonomike dhe masave të tjera të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve; b) masa për pakësimin e konsumit të qeseve mbajtëse me peshë të lehtë, të tilla si përcaktimi i objektivave kombëtare të	E pjesshme	-Në përputhje me kërkesën e nenit 14 të Direktivës 94/62/EC të referuar nga neni 28 (5) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve, parashikon si element detyrues të saj një kapitull të posaçëm për menaxhimin e ambalazheve dhe mbetjeve të ambalazheve ku përcaktohen elementet e parashikuara nga Direktiva 94/62/EC. - Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve, parashikon si element detyrues të saj një kapitull të posaçëm ku përcaktohen objektivat kombëtare për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimi, siç kërkohet nga nenet 11(2) dhe (3) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

[7] Direktiva 2008/56/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 qershor 2008, që krijon një kuadër për veprimet e Bashkimit në fushën e politikës mjedisore detare (Direktiva e Kuadrit të Strategjisë Detare) (OJ L 164, 25.6.2008, f. 19).

[8] Direktiva 2000/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 23 tetor 2000, që krijon një kuadër për veprimet e Bashkimit në fushën e politikës së ujërave (OJ L 327, 22.12.2000, f. 1).

				pakësimit të tyre, instrumente ekonomike si dhe kufizime për tregtimin e tyre, me kusht që këto kufizime të jenë proporcionale dhe jo diskriminuese; c) masa për të nxitur hedhjen në treg të sasive më të mëdha të paketimeve që mund të ripërdoren dhe sisteme për ripërdorimin e paketimeve, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve, duke u kujdesur për impaktin në mjedis dhe pa cenuar sigurinë ushqimore ose sigurinë e konsumatorëve. Këto masa mund të përfshijnë ndër të tjera, skema për depozitimin-kthimin e ambalazheve, vendosjen e objektivave cilësore ose sasiore, lehtësira ekonomike, përcaktimin e detyrimit vjetor për hedhjen në treg të një përqindjeje minimale të paketimeve që mund të ripërdoren, për secilën rrymë paketimesh ç) objektiva kombëtare për rikuperimin dhe riciklimin e rrymave të ndryshme të paketimeve; 4. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të posaçëm ku përcaktohen objektivat kombëtare për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimi. 5. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të posaçëm, që përcakton strategjinë kombëtare për reduktimin e depozitimit në lendfill të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme dhe mbetjeve, veçanërisht mbetjeve bashkiake, të përshtatshme për riciklim apo për ndonjë lloj tjetër rikuperimi.		Përputhshmëria konkrete e objektivave duhet të analizohet me miratimin e strategjisë kombëtare. -Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve, parashikon si element detyrues të saj një kapitull të posaçëm ku përcaktohet strategjia kombëtare për reduktimin e depozitimit në lendfill të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme dhe mbetjeve, veçanërisht mbetjeve bashkiake, të përshtatshme për riciklim apo për ndonjë lloj tjetër rikuperimi, siç kërkohet nga neni 5 i Direktivës 1999/31/EC të referuar nga neni 28 (5) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Përputhshmëria konkrete e objektivave duhet të analizohet me miratimin e strategjisë kombëtare. -Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve nuk përmban parashikime në lidhje me masat për menaxhimin e ujërave detare siç kërkohet nga neni 13 i Direktivës 2008/56/EC. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore është parashikuar të jetë një strategji e posaçme e ndarë nga strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Sipas kërkimeve kjo strategji nuk është miratuar akoma. Me miratimin e saj duhet analizuar nëse masat e parashikuara tek kjo strategji janë në përputhje me kërkesat e nenit 13 të Direktivës 2008/56/EC i referuar nga neni 28 (5) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. -Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve nuk përmban parashikime në lidhje me menaxhimin e ujërave siç kërkohet nga neni 11 i Direktivës 2000/60/EC. Strategjia Kombëtare

				Këtu përfshihen, objektivat kombëtarë për reduktimin e depozitimit në lendfill të mbetjeve të sipërpërmendura dhe masat për përmbushjen e këtyre objektivave të tilla si riciklimi, kompostimi, prodhimi i biogazit apo rikuperimi i materialeve/energjisë.		për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore është parashikuar të jetë një strategji e posaçme e ndarë nga strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Sipas kërkimeve kjo strategji nuk është miratuar akoma. Me miratimin e saj duhet analizuar nëse masat e parashikuara tek kjo strategji janë në përputhje me kërkesat e nenit 11 të Direktivës 2000/60/EC EC i referuar nga neni 28 (5) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
Neni 29 ***Programet e parandalimit të mbetjeve*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare duhet të hartojnë programe për parandalimin e mbetjeve që përshkruajnë të paktën masat e parandalimit të mbetjeve të përcaktuara në Nenin 9(1) në përputhje me Nenet 1 dhe 4. Këto programe duhet të integrohen në planet e menaxhimit të mbetjeve të kërkuara sipas Nenit 28 ose në programe të tjera të politikave mjedisore, sipas rastit, ose të funksionojnë si programe të ndara. Nëse ky program është i integruar në planin e menaxhimit të mbetjeve ose në programe të tjera, objektivat dhe masat për parandalimin e mbetjeve duhet të jenë të identifikueshme qartë.	*Projektligji*	*10, 66*	Neni 10 **Parandalimi i mbetjeve** 1. Parandalimi i mbetjeve kryhet nëpërmjet masave të parashikuara në Programin Kombëtar të Parandalimit të mbetjeve që miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, në përputhje me parashikimet e nenit 66, të këtij ligji. 2. Masat për parandalimin e mbetjeve në nivel sektorial, zonal apo vendor parashikohen, sipas rastit, edhe në planet sektoriale, zonale apo vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve të parashikuar në nenet 63-65 të këtij ligji. Në çdo rast këto masa janë në përputhje me masat e parashikuara në Programin Kombëtar të parandalimit të mbetjeve dhe me parashikimet e këtij ligji. **Neni 66** **Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve**	E pjesshme	Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve e parashikon ekzistencën e një programi kombëtar për parandalimin e krijimit të mbetjeve, si pjesë përbërse e strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Projektligji i menaxhimit të integruar të mbetjeve nuk i parashikon masat e përmendura në nenin 9 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, si elemente që duhet të përfshihen tek programi kombëtar i parandalimit të krijimit të mbetjeve prandaj deri në miratimin e programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve që do të përfshijë të gjitha masat e përmendura nga direktiva, përputhshmëria është e pjesshme.

				1. Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve përcakton politikat kombëtare për parandalimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim garantimin që rritja ekonomike të mos shoqërohet me ndikime negative në mjedis nga mbetjet e krijuara. 2. Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve përmban objektivat e parandalimit të mbetjeve dhe masat për realizimin e tyre sipas Shtojcës 5 të këtij ligji. 3. Ministria harton Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe bashkitë, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit. 4. Programi Kombëtar i Parandalimit të Mbetjeve është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e integruar të mbetjeve, si shtojcë e saj, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit.		
29 (2)	2. Kur hartohen këto programe, Shtetet Anëtare duhet, aty ku është e nevojshme, të përshkruajnë kontributin e instrumenteve dhe masave të listuara në Shtojcën IVa për parandalimin e mbetjeve dhe të vlerësojnë dobinë e shembujve të masave të listuara në Shtojcën IV ose masave të tjera të përshtatshme. Programet duhet gjithashtu të përshkruajnë masat ekzistuese për parandalimin e mbetjeve dhe kontributin e tyre në parandalimin e mbetjeve. Qëllimi i këtyre objektivave dhe masave do të jetë prishja e lidhjes ndërmjet rritjes ekonomike dhe	*Projektligji*	*Shtojca 5*	**SHTOJCA 5** **SHEMBUJ TË MASAVE TË PARANDALIMIT TË KRIJIMIT TË MBETJEVE** Masa që mund të ndikojnë tek kushtet e përgjithshme që lidhen me krijimin e mbetjeve. 1. Përdorimi i masave të planifikimit ose instrumenteve të tjerë ekonomikë që nxisin përdorimin e burimeve në mënyrë efiçente.	E pjesshme	Aneksi IV i referuar nga neni 29 (2) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, përmban një sërë shembujsh për masat që mund të merren ose instrumentat që mund të përdoren nga shtetet anëtare për të nxitur prandalimin e mbetjeve. Këto masa nuk janë detyruese por orientuese. Shtojca 5 e projektligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve i përmban të gjitha masat orientuese të Aneksit IV të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

	ndikimeve mjedisore që lidhen me krijimin e mbetjeve.			2. Nxitja e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit me qëllim realizimin e produkteve dhe teknologjive më të pastra dhe që krijojnë me më pak mbetje dhe shpërndarjen dhe përdorimin e rezultateve të veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit. 3. Zhvillimi i indikatorëve kuptimplotë dhe efektivë të trysnive që ushtron krijimi i mbetjeve mbi mjedisin me qëllim dhënien e kontributit në parandalimin e krijimit të mbetjeve në të gjitha nivelet, duke filluar nga krahasimi i produkteve në nivel kombëtar tek veprimet e ndërmarra nga autoritetet e pushtetit vendor e deri te masat në nivel kombëtar. Masa që mund të ndikojnë tek fazat e projektimit, prodhimit dhe shpërndarjes. 4. Nxitja e ekoprojektimit (integrimi sistematik i aspekteve mjedisore në projektimin e produktit, me qëllim që të përmirësojë performancën e produktit në mjedis gjatë gjithë ciklit të jetës së tij). 5. Ofrimi i informacionit mbi teknikat për parandalimin e mbetjeve, që synon lehtësimin e zbatimit të teknikave më të mira të disponueshme për çdo industri. 6. Organizimi, për autoritetet përkatëse, i trajnimeve që instruktojnë se si të përfshihen kërkesat për parandalimin e mbetjeve në Lejet e Mjedisit të tipit A në bazë të ligjit për lejet e mjedisit. 7. Përfshirja e masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve në impiantet që kërkojnë		Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve, nuk e përcakton përmbajtjen minimale të programit kombëar të parandalimit të mbetjeve, në ndryshim nga rasti i strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve ku përcaktohen disa elemente detyruese. Kështu nuk parashikohet as detyrimi që programi i parandalimit të mbetjeve të përshkruajë masat ekzistuese të parandalimit të mbetjeve. Prandaj, vlerësimi i përputhshmërisë duhet të ribëhet pas miratimit të programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve.

				Leje Mjedisi të tipit A ose B në bazë të ligjit për lejet e mjedisit. Aty ku është e përshtatshme, masa të tilla mund të përfshijnë plane ose vlerësime për parandalimin e mbetjeve. 8. Përdorimi i fushatave ndërgjegjësuese apo dhënia e mbështetjes financiare, në vendimmarrje apo mbështetje të tjera për bizneset. Këto masa mund të jenë veçanërisht efektive kur ato kanë në fokus dhe përshtaten për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe funksionojnë përmes rrjeteve të ngritura/ekzistuese të biznesit. 9. Përdorimi i marrëveshjeve vullnetare, grupimeve/komiteteve të konsumatorëve dhe prodhuesve ose negociatave sektoriale me qëllim që bizneset apo sektorët industrialë përkatës të hartojnë planet ose objektivat e veta të parandalimit të mbetjeve ose të korrigjojnë produktet apo ambalazhet që krijojnë shumë mbetje. 10. Nxitja e sistemeve të besueshme të menaxhimit të mjedisit, përfshirë EMAS dhe ISO 14001. Masa që mund të prekin fazën e konsumit dhe të përdorimit. 11. Instrumentet ekonomike, si për shembull masa nxitëse për blerje të produkteve të pastra ose vendosja e një pagese të detyrueshme për tu paguar nga konsumatorët për një produkt apo element të caktuar të ambalazhit, që në rast të kundërt do të jepej falas.		

				12. Përdorimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe shpërndarja e informacionit për mbarë publikun ose për një kategori të veçantë konsumatorësh . 13. Promovimi i ekoetiketave të besueshme. 14. Marrëveshjet me industrinë, si përdorimi i grupimeve/komiteteve për produktet siç janë ato që mund të jenë ngritur në kuadër të Politikave të Integruara për Produktet ose me shitësit me pakicë mbi disponueshmërinë e informacionit për parandalimin e mbetjeve dhe produkteve me ndikim më të ulët në mjedis. 15. Në kontekstin e prokurimeve publike apo të lidhjes së kontratave të shoqërive tregtare, përfshirjen e kritereve mjedisore dhe atyre të parandalimit të mbetjeve si kritere të tenderit / prokurimit publik dhe të kushteve të lidhjes së kontratave . 16. Nxitja e ripërdorimit dhe/ose e riparimit të produkteve që janë hedhur apo pjesëve të tyre përbërëse që janë të përshtatshme për ripërdorim dhe/ose riparim, veçanërisht përmes përdorimit të masave edukative, ekonomike, logjistike apo masave të tjera, si mbështetja apo ngritja e rrjeteve dhe qendrave të akredituara për riparimin dhe ripërdorimin, sidomos në zonat me densitet të lartë të popullsisë		
29 (2a)	2a. Shtetet Anëtare duhet të miratojnë programe specifike për parandalimin e mbetjeve ushqimore brenda programeve të tyre për parandalimin e mbetjeve.	-	-	-	E papërputhur	Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve, nuk e përcakton përmbajtjen minimale të programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve, në ndryshim nga rasti i strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve ku përcaktohen disa elemente detyruese.

						Kështu nuk parashikohet as detyrimi për përfshirjen e programeve të posaçme për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet të ribëhet pas miratimit të programit kombëtar të parandalimit të mbetjeve.
29 (5)	5. Komisioni do të krijojë një sistem për ndarjen e informacionit mbi praktikat më të mira lidhur me parandalimin e mbetjeve dhe do të zhvillojë udhëzime për të ndihmuar Shtetet Anëtare në përgatitjen e Programeve.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 30 ***Vlerësimi dhe rishikimi i planeve dhe programeve*** *(1)*	1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që planet e menaxhimit të mbetjeve dhe programet e parandalimit të mbetjeve të vlerësohen të paktën çdo gjashtë vjet dhe të rishikohen siç është e nevojshme dhe, kur është e aplikueshme, në përputhje me Nenet 9 dhe 11.	*Projektligji*	*62 (3), (4)*	Neni 62 **Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve** 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton Strategjinë Kombëtare 4. Strategjia Kombëtare rishikohet dhe, në rast se është e nevojshme, përditësohet çdo pesë vjet.	E plotë	Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe program kombëtar i parandalimit të mbetjeve si pjesë përbërëse e tij, rishikohen çdo 5 vjet në përputhje me kërkesën e nenit 30 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
30 (2)	2. Agjencia Evropiane e Mjedisit do të publikojë çdo dy vjet një raport që përmban një rishikim të progresit të bërë në përfundimin dhe zbatimin e programeve për parandalimin e mbetjeve, duke përfshirë një vlerësim të progresit në lidhje me parandalimin e krijimit të mbetjeve për çdo Shtet Anëtar dhe për Bashkimin si një tërësi, dhe në lidhje me ndarjen e krijimit të mbetjeve nga rritja ekonomike dhe kalimin drejt një ekonomie qarkulluese.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 31 ***Pjesmarrja e publikut***	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që palët e interesuara dhe autoritetet përkatëse, si dhe publiku i përgjithshëm, të kenë mundësinë të marrin pjesë në hartimin e planeve për menaxhimin e mbetjeve dhe programeve për parandalimin e mbetjeve dhe të kenë akses në to pas hartimit, në përputhje me Direktivën 2003/35/KE ose, nëse është e aplikueshme, Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 27 Qershorit 2001 mbi vlerësimin e ndikimeve të disa planeve dhe programeve në	*Legjislacion sektorial*	-	-	E plotë	Projektligji nuk përmban një dispozitë të tillë sepse legjslacioni i posaçëm shqiptar ekzsitues është plotësisht në përputhje me këtë dispozitë të direktivës, siç shpjegohet në analizën më poshtë. *** Neni 31 i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve parashikon dy detyrime kryesore: pjesmarrjen e publikut gjatë hartimit të planeve dhe

	mjedis[9]. Ata do të publikojnë planet dhe programet në një faqe interneti të disponueshme për publikun.					programeve të menaxhimit të mbetjeve dhe aksesin e publikut në këto dokumenta pas hartimit të tyre. Parimet e së drejtës së informimit dhe pjesmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore janë të parashikuara që me ligjin kuadër për mbrojtjen e mjedisit (neni 13). Zbatimi i këtyre parimeve bëhet me legjislacionin e posaçëm. Konkretisht ligji për vlerësimin strategjik mjedisor (neni 7) parashikon pjesmarrjen e publikut gjatë hartimit të planeve dhe programeve me ndikim në mjedis, ku përfshihen ato që lidhen me menaxhimin e mbetjeve. Vlen për t'u përmendur se ky ligj është plotësisht i përafruar me Direktivën 2001/42/EC të përmendur këtu. Ndërsa ligji për konsultimit publik (nenet 6 dhe 7) mundëson pjesmarrjen e publikut pas hartimit të projektakteve dhe para miratimit të tyre si dhe publikimin e tyre në regjistrin elektronik të konsultimeve publike, që është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë.
Neni 32 **Bashkëpunimi**	Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë, sipas rastit, me Shtetet Anëtare të tjera të përfshira dhe me Komisionin për të hartuar planet e menaxhimit të mbetjeve dhe programet e parandalimit të mbetjeve në përputhje me Nenet 28 dhe 29.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 33 **Informacioni që duhet të paraqitet në Komision**	1. Shtetet Anëtare duhet të informojnë Komisionin për planet e menaxhimit të mbetjeve dhe programet e parandalimit të mbetjeve të përmendura në Nenet 28 dhe 29, pasi të jenë miratuar, dhe për çdo rishikim të rëndësishëm të planeve dhe programeve.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

[9] OJ L 197, 21.7.2001, p. 30.

33 (2)	2. Komisioni do të miratojë akte zbatimi për të përcaktuar formatin për njoftimin e informacionit mbi miratimin dhe rishikimet e rëndësishme të planeve të menaxhimit të mbetjeve dhe programeve të parandalimit të mbetjeve. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 39(2).	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 34 ***Inspektimet*** *(1)*	1. Subjektet ose ndërmarrjet që kryejnë operacione të trajtimit të mbetjeve, subjektet ose ndërmarrjet që grumbullojnë ose transportojnë mbetje në bazë profesionale, agjentët dhe tregtarët, subjektet dhe ndërmarrjet që krijojnë mbetje të rrezikshme do të jenë subjekt i inspektimeve të përshtatshme periodike nga autoritetet përkatëse.	*Projektligji*	*69 (1)*	Neni 69 **Inspektimi** 1. Subjektet të cilët kryejnë operacione të trajtimit të mbetjeve, përfshirë subjektet që grumbullojnë apo transportojnë mbetjet si veprimtari profesionale, agjentët apo tregtarët e mbetjeve si dhe subjektet që krijojnë mbetje, janë subjekt i inspektimeve periodike nga autoritetet kompetente	E plotë	Neni 69 (1) i projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve pasqyron nenin 34 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve duke parashikuar detyrimin e inspektimit për subjektet që krijojnë mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.
34 (2)	2. Inspektimet që lidhen me operacionet e grumbullimit dhe transportit do të mbulojnë origjinën, natyrën, sasinë dhe destinacionin e mbetjeve të grumbulluara dhe të transportuara.	*Projektligji*	*69 (2)*	Neni 69 **Inspektimi** 2. Inspektimi i subjekteve të pikës 1 përfshijnë inspektimin e origjinës, llojit, sasisë së mbetjeve dhe të operacioneve që janë kryer për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga këto subjekte.	E plotë	Neni 69 (2) i projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve pasqyron nenin 34 (2) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Megjithatë projektligji e zgjeron detyrimin e inspektimit me parashikimin se elementet specifike të inspektimit do të zbatohen kundrejt të gjithë subjekteve të paragrafit 1 dhe jo vetëm kundrejt subjekteve që grumbullojnë dhe transportojnë mbetjet, siç përcaktohen nga direktiva.
34 (3)	3. Shtetet Anëtare mund të marrin në konsideratë regjistrimet e marra në kuadër të Skemës së Eko-Menaxhimit dhe Auditimit të Komunitetit (*EMAS*), veçanërisht në lidhje me shpeshtësinë dhe intensitetin e inspektimeve.	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 35 ***Ruajtja e të dhënave*** *(1)*	1. Subjektet dhe ndërmarrjet e përmendura në Nenin 23(1), krijuesit e mbetjeve të rrezikshme, dhe subjektet dhe ndërmarrjet që grumbullojnë ose transportojnë mbetje të rrezikshme në bazë profesionale, ose veprojnë si tregtarë dhe agjentë të mbetjeve të rrezikshme, duhet të mbajnë një regjistër kronologjik të:	*Projektligji*	*70 (1)*	Neni 70 **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave** 1. Çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve si veprimtari profesionale, përfshirë krijuesit e mbetjeve të rrezikshme, subjektet që grumbullojnë ose transportojnë	E plotë	Neni 70 i projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve përputhet plotësisht me kërkesat e nenit 35 të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

	(a) sasisë, natyrës dhe origjinës së atyre mbetjeve dhe sasisë së produkteve dhe materialeve që rezultojnë nga përgatitja për ripërdorim, riciklimi ose operacione të tjera të rikuperimit; dhe (b) kur është e aplikueshme, destinacionit, shpeshtësisë së grumbullimit, mënyrës së transportit dhe metodës së trajtimit të parashikuar për mbetjet.			mbetje të rrezikshme, ose veprojnë si tregtarë dhe agjentë të mbetjeve të rrezikshme ruajnë në mënyrë kronologjike: a) të dhëna mbi sasinë, llojin dhe origjinën e mbetjeve, si dhe sasinë e produkteve dhe materialeve që rezultojnë nga përgatitja për ripërdorim, riciklim ose operacione të tjera të rikuperimit; b) sipas rastit, destinacionin, shpeshtësinë e grumbullimit, mënyrën e transportit dhe metodën e trajtimit të parashikuar sipas llojit të mbetjeve.		
35 (1) Paragrafi 2	Ata duhet ti bëjnë këto të dhëna të disponueshme për autoritetet përkatëse përmes regjistrit elektronik ose regjistrave që do të krijohen në përputhje me paragrafin 4 të këtij Neni	*Projektligji*	*70 (4)*	Neni 70 **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave** 4. AKM krijon regjistrin elektronik për të mbajtur të dhënat e mbetjeve sipas pikës 1 të këtij neni, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Personat e parashikuar në paragrafin 2 më sipër raportojnë çdo 6 muaj të dhënat e mbetjeve në regjistrin elektronik	E plotë	Detyrimi i raportimit të të dhënave çdo gjashtë muaj në regjistrin elektronik, është në përputhje me parashikimin e nenit 35 (1) paragrafi 2 i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.
35 (2)	2. Për mbetjet e rrezikshme, të dhënat duhet të ruhen për të paktën tre vjet përveç rasteve të subjekteve dhe ndërmarrjeve që transportojnë mbetje të rrezikshme, të cilat duhet ti mbajnë këto të dhëna për të paktën 12 muaj.	*Projektligji*	*70(3)*	Neni 70 **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave** 3. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni i ruajnë të dhënat për mbetjet e rrezikshme për të paktën 3 vjet dhe të dhënat për mbetjet jo të rrezikshme për të paktën 2 vite.	E plotë	Edhe projektligji parashikon detyrimin që të dhënat për mbetjet e rrezikshme të ruhen për të paktën 3 vjet.
35 (2) Paragrafi 2	Dokumentacioni që vërteton se operacionet e menaxhimit janë kryer duhet të dorëzohet me kërkesën e autoriteteve përkatëse ose të një zotëruesi të mëparshëm.	*Projektligji*	*70 (5)*	Neni 70 **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave**	E plotë	Neni 35 (2) paragrafi 2 i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve parashikon detyrimin që çdo subjekt që trajton mbetjet duhet t'i paraqesë autoriteteve kompetente ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjeve,

				5. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes, çdo 6 muaj, dokumentacionin që vërteton se operacionet e menaxhimit të mbetjeve janë kryer.		dokumentat që dëshmojnë se mbetjet janë trajtuar, kurdo që të kërkohen prej tyre. Neni 70 (5) i projektligjit e parashikon këtë detyrim si detyrim raportimi periodik.
35 (3)	3. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që krijuesit e mbetjeve jo të rrezikshme të plotësojnë kërkesat e paragrafit 1 dhe 2.	*Projektligji*	*70 (3), (5)*	Neni 70 **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave** 1. Çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve si veprimtari profesionale, përfshirë krijuesit e mbetjeve të rrezikshme, subjektet që grumbullojnë ose transportojnë mbetje të rrezikshme, ose veprojnë si tregtarë dhe agjentë të mbetjeve të rrezikshme ruajnë në mënyrë kronologjike: a) të dhëna mbi sasinë, llojin dhe origjinën e mbetjeve, si dhe sasinë e produkteve dhe materialeve që rezultojnë nga përgatitja për ripërdorim, riciklim ose operacione të tjera të rikuperimit; b) sipas rastit, destinacionin, shpeshtësinë e grumbullimit, mënyrën e transportit dhe metodën e trajtimit të parashikuar sipas llojit të mbetjeve. 3. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni i ruajnë të dhënat për mbetjet e rrezikshme për të paktën 3 vjet dhe të dhënat për mbetjet jo të rrezikshme për të paktën 2 vite. 5. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vënë në dispozicion	E pjesshme	Neni 70 paragrafi 1 dhe 4 i projektligjit është në përputhje me nenin 35 (1) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve. Për shkak të papërputhshmërisë së nenit 70 paragrafi 6 i projektligjit me neni 35 (2) të Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, përputhshmëria e kësaj dispozite është e pjesshme.

				të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes, çdo 6 muaj, dokumentacionin që vërteton se operacionet e menaxhimit të mbetjeve janë kryer.		
35 (4)	4. Shtetet Anëtare duhet të krijojnë një regjistër elektronik ose regjistra të koordinuar për të regjistruar të dhënat mbi mbetjet e rrezikshme të përmendura në paragrafin 1 që mbulojnë të gjithë territorin gjeografik të Shtetit Anëtar përkatës. Shtetet Anëtare mund të krijojnë regjistra të tillë për rryma të tjera mbetjesh, veçanërisht për ato rryma mbetjesh për të cilat janë vendosur objektiva në aktet legjislative të Bashkimit. Shtetet Anëtare do të përdorin të dhënat e raportuara mbi mbetjet nga operatorët industrialë në Regjistrin Evropian të Emetimeve dhe Transferimeve të Ndotësve të krijuar sipas Rregullores (KE) Nr. 166/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit[10].	*Projektligji*	70 (4), (6)	Neni 70 **Kërkesa për mbajtjen e të dhënave** 4. AKM krijon regjistrin elektronik për të mbajtur të dhënat e mbetjeve sipas pikës 1 të këtij neni, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Personat e parashikuar në paragrafin 2 më sipër raportojnë çdo 6 muaj të dhënat e mbetjeve në regjistrin elektronik. 6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kriteret minimale për operimin e regjistrave elektronikë, referuar në pikën 4 të këtij neni.	E pjesshme	Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve e parashikon krijimin e një regjistri të tillë me të dhënat e kërkuara nga neni 35 i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve, për të gjithë territorin e Shqipërisë. Megjithatë deri në miratimin e vendimit të këshillit të ministrave dhe ngritjen e sistemi, përputhshmëria mbetet e pjesshme.
35 (5)	5. Komisioni mund të miratojë akte zbatimi për të përcaktuar kushtet minimale për funksionimin e këtyre regjistrave. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 39(2).	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Neni 36 **Zbatimi dhe ndëshkimet** *(1)*	1. Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masat e nevojshme për të ndaluar braktisjen, hedhjen ose menaxhimin e pa kontrolluar të mbetjeve, përfshirë edhe ndotjen.	*Projektligji*	*76*	Neni 76 **Ndalime** Ndalohen: a) hedhja, braktisja, depozitimi apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike dhe jo publike ku nuk lejohet të hidhen, të depozitohen apo të groposen mbetjet nga individët; b) hedhja, braktisja, depozitimi apo groposja e të gjitha llojeve të	E plotë	Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve i parashikon ndalimet e përcaktuara nga neni 36 (1) i Direktivës 2008/98/KE të mbetjeve.

[10] Rregullorja (KE) Nr. 166/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 janarit 2006 lidhur me krijimin e një Regjistri Evropian të Shkëreleaseve dhe Transferimeve të Ndotësve dhe ndryshimi i Direktivave të Këshillit 91/689/KEE dhe 96/61/KE (OJ L 33, 4.2.2006, fq. 1).

				mbetjeve në vende publike dhe jo publike ku nuk lejohet të hidhen apo groposen mbetjet nga persona që kryejnë veprimtari tregtare dhe që nuk janë të pajisur me leje, licencë apo autorizim për kryerjen e kësaj veprimtarie; c) djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me këtë ligj dhe pa u pajisur me licencat, lejet apo autorizimet e nevojshme; ç) dërgimi dhe pranimi i mbetjeve në lendfill ose në impiantin e incinerimit dhe të bashkëincinerimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar të destinuara për përgatitje për ripërdorim dhe/ose riciklim, me përjashtim të mbetjeve të prodhuara nga trajtimi i mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, nëse incinerimi është zgjidhja më e përshtatshme (e vetme) në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.		
36 (2)	2. Shtetet Anëtare do të vendosin dispozita mbi ndëshkimet që aplikohen për shkeljet e dispozitave të kësaj Direktive dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato të zbatohen. Ndëshkimet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese.	*Projektligji*	*77, 78, 79*	Neni 77 **Kundërvajtjet administrative** Shkeljet e mëposhtme, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si vijon: 1. Çdo person, që përzien mbetje në kundërshtim me nenin 9 pika 4 dhe nenin 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 2. Çdo person, që përzien mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar në kundërshtim me nenin 12 pika 2 dhe nenin 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion)	E plotë	Projektligji parashikon një sërë kundërvajtjesh dhe masash administrative, që zbatohen për shkeljet e dispozitave të ligjit si dhe rregullat e ekzekutimit. Kundërvajtjet administrative janë efeketive, proporcionale dhe kanë efekt parandalues, sic kërkon direktiva.

				deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 3. Çdo person, që asgjëson mbetje në shkelje të nenit 14 të këtij ligji dhe në kundërshtim me normat teknike minimale sipas nenit 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 4. Çdo krijues apo zotërues mbetjesh, që sipas nenit 16 paragrafi 1 germa (a) të këtij ligji trajton vetë mbetjet në kundërshtim me normat teknike minimale sipas nenin 46 të këtij ligji dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milion) lekë. 5. Çdo krijues apo zotërues mbetjesh, që dorëzon apo transferon mbetjet te një person tjetër që nuk është i autorizuar të marrë dhe të trajtojë ato mbetje, në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milion) lekë. 6. Çdo person i licencuar, që grumbullon apo transporton mbetje dhe nuk e dërgon atë në një impiant trajtimi të përshtatshëm, në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë 7. Çdo krijues apo zotërues mbetjesh, që grumbullon mbetjet në kundërshtim me parashikimet e nenit 31 pika 4 të		

				këtij ligji dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 8. Ruajtja paraprake e mbetjeve para grumbullimit e kryer në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 9. Çdo person që ushtron veprimtarinë e stacionit të transferimit në kundërshtim me nenin 33 pika 4 të këtij ligji dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 10. Çdo person i licencuar, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme pa u pajisur me një dokument të vlefshëm transferimi mbetjesh që plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 11. Çdo person i licencuar, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e transferimit të mbetjes, në kundërshtim me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milion) deri në 4 000 000 (katër milion) lekë. 12. Çdo person që angazhohet në transferimin e		

				mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet, në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milion) lekë. 13. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse, në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milion) lekë. 14. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milion) lekë. 15. Moszbatimi i detyrimeve të bashkive përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e këtyre njësive, të cilët dënohen me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milion) lekë. 16. Moszbatimi pa arsye të ligjshme, i detyrimit të bashkive për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor të përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e bashkive të cilët dënohen me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milion) lekë.		

